



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 02/L-70**

**PËR SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (h) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001)

Me qëllim të përcaktimit të parimeve dhe kushteve me të cilat rregullohet sektori i sigurisë në rrugë të harmonizuar me përvojat më të mira ndërkombëtare.

Miraton:

**LIGJIN PËR SIGURINË NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR**

KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Qëllimi  
Neni 1

1.1. Me këtë ligj përcaktohen bazat kryesore të ndërsjella të marrëdhënieve dhe sjelljeve të pjesëmarrësve si dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor, kushtet bazë që duhen ti përmbushin rrugët shikuar në zhvillimin e komunikacionit rrugor, sistemi i shenjave të komunikacionit, dhe shenjat që japin personat e autorizuar zyrtar, detyrat në rast aksidentit në komunikacion rrugor, përgatitja e kandidatëve për shofer, dhënia e provimit për shofer, si dhe kushtet për të fituar të drejtën për drejtimin e mjetit; mjetin tërheqës, pajisjet dhe pajimet të cilat duhen ti kenë mjetet, dimensionet, masa e përgjithshme dhe ngarkesa boshtore e mjetit si edhe kushtet të cilat duhet ti plotësoj mjeti në komunikacion.

1.2. Me komunikacion në rrugë sipas këtij ligjit nënkuptojmë lëvizjen e mjeteve, këmbësorëve, si dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacionin në rrugë publike dhe të pa kategorizuar të cilat shfrytëzohen për komunikacion publik.

1.3. Në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji zbatohet ligji në fuqi për kundërvajtjet përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

## Neni 2

2.1. Mbikëqyrjen, administrimin dhe zbatimin e Ligjit mbi sigurinë në komunikacionin rrugor e bën Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, Shërbimi Policor i Kosovës dhe autoritetet tjera përgjegjëse, në përputhje me kompetencat e këtij Ligji.

2.2. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Shërbimi Policor i Kosovës janë autoritet për të mbikëqyrë administrimin e komunikacionit rrugor në rrugë publike, përveç rrugëve lokale në kuadër të kompetencave të tyre.

2.3. Kuvendet Komunale dhe Shërbimi Policor i Kosovës janë autoritet për të mbikëqyrë administrimin e komunikacionit rrugor në rrugët publike lokale në kuadër të kompetencave të tyre.

2.4. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Kuvendet Komunale, kanë të drejtë që të urdhërojnë ndryshimin e organizimit të komunikacionit, nëse është në interes të përgjithshëm të publikut ose kërkesave të komunikacionit transit në përputhje me kompetencat e këtij Ligji.

2.5. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, duke pasur parasysh nevojën për mbrojtje adekuate të rrugëve nga dëmtimi dhe rritjes të sigurisë brenda periudhës kur është komunikacioni i ngarkuar, mund të paraqet me anë të një akti nënligjor, kufizime periodike të lëvizjes në rrugë ose të ndaloj lëvizjen e kategorive të caktuara të mjeteve.

2.6. Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit bashkëpunon me Shërbimin Policor të Kosovës, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë:

- a) shtimin e sigurisë në rrugë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion,
- b) shfrytëzimin efikas të rrugëve publike dhe do të përkufizojnë me anë të një akti nënligjor, kushtet specifike të administrimit të komunikacionit rrugor dhe mbikëqyrjen e atij administrimi.

2.7. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Kuvendet Komunale në përputhje me rregullat e këtij ligji rregullojnë komunikacionin në kompetencat e tyre ashtu që përcaktojnë:

- a) rrugët me përparësi kalimi,
- b) komunikacionin me një përkatësisht në dy drejtime,
- c) sistemin teknik të rregullimit të komunikacionit,
- d) kufizimin e shpejtësisë së lëvizjes,
- e) komunikacionin e këmbësoreve, biçiklistëve, çiklomotorave, qerreve, kalërimi (ngitja) dhe udhëheqja e kafshëve,
- f) hapësirat e parkimit dhe mënyra e parkimit,
- g) zona e komunikacionit e qetë,
- h) bllokimi i autobusëve, mjeteve transportuese, mjeteve bashkangjitime dhe makinave të punës, në vende të cilat nuk janë destinuar për parkimin e llojit të tyre dhe mënyra e zhbllokimit të këtyre mjeteve,
- i) vendosja dhe mirëmbajtja e rrethojës mbrojtëse për këmbësor në vende të rrezikshme,
- j) zonat e këmbësoreve, drejtimet e sigurta për lëvizjen e fëmijëve shkollor, masat e veçanta teknike për sigurimin e këmbësorëve dhe biçiklistave në afërsi të enteve mësimore, shëndetësore dhe enteve tjera, fushave sportive, çerdheve të fëmijëve, kinema e të ngjashme,

- k) largimin, e mjeteve të vjetruara, dëmtuara ose të papërdorura ose të ngjashme,
- l) hapësirat në të cilën kryhet: testimet e ngasjes, krosi, ngasjet sportive dhe të ngjashme,
- m) kushtet e lëvizjes së mjeteve për furnizim në zonat e komunikacionit të qetë dhe zonave të këmbësorëve.

2.8. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni kur komunikacioni rregullohet në pjesët e rrugës rajonale, magjistrale, nevojitet edhe pëlqimi nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.

2.9. Punët e mbikëqyrjes dhe zhvendosja e mjeteve të cilat janë parkuar në kundërshtim me rregullat e parkimit të këtij ligjit, detyrat e drejtimit dhe kontrollimit të komunikacionit, kontrollimi i komunikacionit në zonat e qeta të komunikacionit dhe zonave të këmbësorëve, zbulimi i kundërvajtjeve të këmbësorëve dhe biciklistëve, matja e shpejtësisë së lëvizjes brenda zonave të banuara duke i vendosur në mënyrë fikse pajisjen matëse, si dhe mbikëqyrjen e traktorit, qerreve dhe mjeteve të cilat kyçen në komunikacion nga punishtet, përveç personave të autorizuar nga Shërbimi Policor i Kosovës mund ta kryejnë edhe personat e autorizuar nga Kuvendet Komunale ndërsa për rrugën magjistrale dhe rajonale kërkohet pëlqimi paraprak nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

2.10. Përfaqësuesit e Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe të Kuvendeve Komunale duhet nëse kërkohet nevoja në kërkesë të Shërbimit Policor të Kosovës të organizon njësit e komunikacionit të shkollave dhe njësit e komunikacionit për të rinjtë. Aftësimin e njësive mënyrën dhe kohën e përcakton Shërbimi Policor i Kosovës.

2.11. Rregullimin e komunikacionit në kryqëzim dhe në vendet tjera, mbikëqyrjen e parkimit të mjeteve dhe përcaktimin e detyrave tjera të mbikëqyrjes të mjeteve dhe shoferëve, mund ti kryejnë edhe përfaqësuesit e njësive shkollore të të rinjve të komunikacionit.

2.12. Në hapësirat edhe në afërsi të shkollave, sigurimin e fëmijëve gjatë kalimit nëpër rrugë dhe në vendkalimin e këmbësorëve mund ta kryejnë edhe përfaqësuesit e njësive shkollore të komunikacionit.

2.13. Gjatë kohës së kryerjes së detyrave nga paragrafi 11 dhe 12 të këtij neni, pjesëtarët e njësive shkollore dhe të rinjve të komunikacionit duhet të mbajnë rrobe - uniformen sipas rregullave të parapara. Programin dhe mënyrën e aftësimit dhe veprimet e njësive shkollore e të rinisë së komunikacionit si edhe uniformen dhe shenjat e njësive shkollore dhe të rinisë së komunikacionit i përcakton Shërbimi Policor i Kosovës.

2.14. Mbikëqyrjen e parkimit të mjeteve në të cilën parkimi është i kufizuar me kohëzgjatje e kryejnë përfaqësuesit e autoriteteve kompetente.

2.15. Zyrtarët e autorizuar nga Kuvendet Komunale duhet të jenë të aftësuar për kryerjen e detyrave nga paragrafi 9 i këtij neni, janë të autorizuar të kërkojnë patentë shoferin, lejen e komunikacionit, nga pjesëmarrësit tjerë lejen e njoftimit, duhen të mbajnë rrobe, uniformën dhe të prezantoj kartelën zyrtare të identifikimit gjatë kryerjes së detyrës. Programin e aftësimit, kushtet të cilat duhet plotësojnë, pamja e rrobave - uniformes, kartela zyrtare e identifikimit dhe kushtet për bartjen e punëve përcaktohen nga Kuvendet Komunale me pëlqimin e Shërbimit Policor të Kosovës.

## Neni 3

3.1. Përkufizimet e nocioneve të përdorura në këtë Ligj nënkuptojnë:

1)“**rrugë**” nënkupton çdo rrugë publike dhe rrugë e pa kategorizuar në të cilën zhvillohet komunikacioni;

2)“**rruga publike**” nënkupton një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;

3)“**autostradë**” nënkupton rrugën publike e ndërtuar posaçërisht dhe e destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila si autostradë është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacion që ka dy shirita rrugorë të ndarë fizikisht,(brezin e gjelbër, rrethojën mbrojtëse etj.) për lëvizje nga drejtime të kundërta me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit - nga një shirit për ndalje emergjente me gjerësi së paku 2,5 metra, pa u kryqëzuar me rrugët tërthore më vijat hekurudhore ose tramvajit në nivel, në të cilën mund të dilet vetëm me rrugët lidhëse publike përkatëse dhe të ndërtuar posaçërisht në shiritin përkatës të sipërfaqes rrugore të autostradës, dhe mundësohet rryma e sigurt e komunikacionit me shpejtësi prej së paku 80 km/h, dhe si e tillë është e shënuar me shenjë të komunikacionit;

4)“**Rrugë e shpejtë**” nënkupton rrugën publike e destinuar për komunikacion të mjeteve motorike, me një ose me dy shirita rrugor të ndara, të gjitha kryqëzimet i ka mbi dy ose më tepër nivel me rrugët tërthore dhe binaret e trenit ose të tramvajit, me rregull nuk ka shirit të ndaljes emergjente dhe si e tillë është e shënuar me shenjë të komunikacionit;

5)“**rruga e rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike**” nënkupton rrugën publike me së paku dy shirita komunikacioni të një gjerësie prej së paku 3,25 metra, ku mundësohet rryma e sigurt e komunikacionit të mjeteve me shpejtësi prej së paku 60 km/h nëpër të cilin mund të lëvizin vetëm mjetet motorike të cilat mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 60 km/h dhe si e tillë është e shënuar me shenjën e paraparë të komunikacionit;

6)“**rrugë ndërkombëtare**” nënkupton rrugën publike që, me akt ndërkombëtar, është klasifikuar në rrjetin e rrugëve ndërkombëtare;

7) “**rrugë magjistrale**” nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë magjistrale, që lidh dy e më tepër qytete të mëdha dhe të cilat mund të shërbejnë si lidhje me vendet jashtë Kosovës;

8)“**rruga regjionale**” nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë regjionale, që lidh dy e më tepër qytete të mëdha;

9)“**rrugë lokale**” nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;

10)“**rrugë e paklasifikuar**” nënkupton çdo rrugë që nuk është rrugë publike, pronari i së cilës është një qytetar apo grup banorësh, dhe nuk është nën përgjegjësin e Ministrisë, por e cila jo zyrtarisht e shfrytëzuar nga këmbësorët, automjetet dhe mjeteve tjera lëvizëse që lëvizin anash në hapësirën e pashënuar;

11)“**rrugë e pa shtruar**” nënkupton rrugën pa sipërfaqe të ndërtuar rrugore dhe pa shtresë rrugore madje edhe në pikën e lidhjes me rrugën publike ka sipërfaqe të ndërtuar rrugore;

- 12)“**Rrugë automobilistike (qarkulluese)**” nënkupton pjesën e sipërfaqes rrugore, e destinuar në rend të parë për lëvizjen e mjeteve rrugore;
- 13)“**shiriti rrugor**” nënkupton pjesën gjatësore të rrugës automobilistike, e destinuar për lëvizjen e mjeteve rrugore në një kahe, me një apo me më shumë shirita komunikacioni;
- 14)“**shirit i komunikacion**” nënkupton pjesën gjatësore të shënuar apo e pashënuar e rrugës automobilistike, gjerësia e së cilës është e mjaftueshme për zhvillimin e komunikacionit normal të një rend mjetesh rrugore;
- 15)“**shiriti i komunikacionit për mjetet e ngadalshme**” nënkupton pjesën gjatësore të shënuar e destinuar për mjete e rënda dhe mjetet tjera, të cilat me lëvizjen e ngadalshme zvogëlojnë rrjedhën( frekuencën) e komunikacion;
- 16) “**shiriti i komunikacionit për ndalje emergjente**” nënkupton pjesën gjatësore të shënuar e rrugës në autostrada dhe në vende të caktuara në rrugët e një rangu më të lartë si dhe në tunele, galeri apo të ngjashme;
- 17)“**shiriti i komunikacionit për nxitim**” nënkupton pjesën e rrugës automobilistike e destinuar për kyçje të mjeteve në rrjedhën e komunikacionit nga rruga dytësore, përkatësisht nga rrugët e tjera hyrëse nga objektet për gjatë rrugës (pompat e benzinës, vendet e caktuara për parkim, motelet etj.) pranë rrugës;
- 18) “**shiriti i komunikacionit për ngadalësim**” nënkupton pjesën e rrugës automobilistike e destinuar për shkyçje të mjeteve nga rrjedha e komunikacionit në rrugë;
- 19)“**shiriti i biçiklistëve**” nënkupton pjesën e rrugës, e destinuar për lëvizjen e biçikletave dhe çiklomotorve, që shtrihet përgjatë rrugës automobilistike dhe që është e shënuar me vijën gjatësore në rrugën automobilistike;
- 20)“**shtegu i biçiklistëve**” nënkupton sipërfaqjen e komunikacionit e ndërtuar dhe e destinuar për lëvizjen e biçikletave e çiklomotorve, që shtrihet përgjatë rrugës automobilistike dhe është e ndarë nga ajo dhe e shënuar me shenjën e caktuar të komunikacionit;
- 21)“**trotuari**” nënkupton sipërfaqen e rregulluar posaçërisht për lëvizjen e këmbësorëve, e cila nuk është në nivel me rrugën automobilistike ose është e ndarë në mënyrë tjetër nga rruga;
- 22)“**vendkalimi i shënuar i këmbësorëve**” nënkupton pjesën e sipërfaqes së rrugës automobilistike e destinuar për kalimin e këmbësorëve nëpër shtresën në fjalë e shënuar me shenja përkatëse;
- 23) “**ishulli i këmbësorëve**” nënkupton sipërfaqen e ngritur ose të shënuar në një mënyrë tjetër, e cila gjendet në rrugën automobilistike dhe e cila është caktuar për qëndrim të përkohshëm të këmbësorëve, të cilët kalojnë nëpër rrugën për hyrjen ose daljen nga mjete i cili kryen transportin publik;
- 24) “**Zonë e TMK-ës**” nënkupton një sipërfaqe apo gjatësi rruge afër kazermave të TMK-së, ku ndalohej ndalja e automjeteve me targa civile dhe automjeteve me targa tjera goftë të regjistruara në Kosovë apo edhe në ndonjë vend të huaj, pa leje speciale apo autorizim të veçantë;

- 25) “**zona e këmbësorëve**” nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të komunikacionit në rend të parë e destinuar për lëvizjen e këmbësorëve, në të cilin ju ndalohet lëvizja e mjeteve motorike, përveç atyre me leje të veçantë;
- 26) “**zonë e banuar (Vendbanim)**” nënkupton hapësirën në të cilën rreshtat ose bashkësitë e ndërtesave gjenden në një anë apo në të dy anët e rrugës, duke dhënë pamjen e një rruge dhe kufijtë e së cilës janë të shënuar me shenja të komunikacionit të shënimit të vendeve të banuara;
- 27) “**zona e komunikacionit të qetë**” nënkupton zonën e një qendre të banuar, e shënuar me shenjë të përkatëse të komunikacionit, në të cilën mjetet nuk duhet të lëvizin me shpejtësi më të madhe se sa lëvizja e këmbësorit dhe në të cilën lojërat për fëmijë janë të lejuara në tërë zonën;
- 28) “**kryqëzim**” nënkupton sipërfaqen në të cilën kryqëzohen ose lidhen (bashkohen) dy a më shumë rrugë si dhe sipërfaqja e gjerë e komunikacionit (sheshet etj), e cila krijohet në kryqëzimin, përkatësisht me lidhjen e rrugëve;
- 29) “**vendndalim i autobusit**” nënkupton pjesën e një sipërfaqeje të rrugës, e destinuar për ndaljen e tramvajeve, përkatësisht autobusëve për të hyrë dhe dal udhëtarët dhe që është e shënuar me shenjë përkatëse të komunikacionit;
- 30) “**mjet i zjarrfikëseve**” nënkupton mjetin motorik dhe bashkangjites i destinuar për fikjen e zjarrit;
- 31) “**mjet**” nënkupton çdo mjet transporti i destinuar për të lëvizur nëpër rrugë, përveç karrocave lëvizëse pa motor për persona me aftësi të kufizuara dhe të mjeteve transportuese të fëmijëve;
- 32) “**mjet special**” nënkupton mjetin me veprim motorik ose mjet bashkangjites i një destinimi të veçantë (transportimi i ngarkesave speciale apo bartja speciale e njerëzve që për nga veçoritë dhe karakteristikat, bën pjesë në njërin prej kategorive ose llojeve të mjeteve me lëvizje motorike të cilat përdoren për polici, siguri e zjarrfikësve, TMK e të ngjashme (kombinim i veturave ose bashkangjitesë);
- 33) “**makinë pune**” nënkupton mjetin me veprim motorik ose mjete bashkangjites në të cilën janë instaluar veglat dhe pajisjet për kryerjen e punimeve dhe me të cilën masa më e madhe e lejuar është e barabartë me masën e mjetit (p.sh. vinçi etj.), kurse për nga veçoritë dhe karakteristikat bën pjesë në njërin prej kategorive ose llojeve të mjeteve me lëvizje motorike ose mjeteve bashkangjitesë;
- 34) “**mjet me veprim motorik**” nënkupton çdo mjet që lëviz me fuqinë e motorit të vet, përveç mjeteve që lëvizin nëpër binarë dhe mjeteve për lëvizjen e të hendikepuarve;
- 35) “**mjet motorik (automjet)**” nënkupton mjetin me veprim motorik, destinim themelor i të cilit është bartja e personave dhe e sendeve rrugës ose tërheqja e mjeteve bashkangjitesë (tërheqësit), të destinuara për bartjen e personave dhe sendeve, përveç çiklomotorëve, traktorëve, motokultivatorëve dhe mjeteve të punës;
- 36) “**mjet pune**” nënkupton mjetin me veprim motorik (kombajna, cilindri, kositësja, buldozeri, pirunari, gërmuesja etj.), destinim themelor i të cilit është ushtrimi i punimeve të caktuara me veglëri dhe pajisje të veta;
- 37) “**motokultivatori**” nënkupton mjetin me veprim motorik i cili ka vetëm një bosht i konstruktuar për tërheqje, shtyrje, ose bartjen e veglave të ndërrueshme për punët e

ndryshme bujqësore, përkatësisht të shërbej për vënien në lëvizje të atyre veglave apo tërheqjen e rimorkios;

38)“**traktori**” nënkupton mjetin me veprim motorik, i konstruktuar për tërheqje, shtyrje apo bartje veglash të ndryshme, përkatësisht për të shërbyer për lëvizje të atyre veglave ose për tërheqje e rimorkiove;

39)“**shtojcë traktori**” nënkupton një veglëri e zëvendësueshme për ushtrimin e punëve bujqësore e të tjera që tërheq, shtyn ose bartë traktori;

40) “**çiklomotori** ” nënkupton mjetin me veprim motorik, me dy a tri rrotë, kapaciteti i punës së motorit i të cilit nuk është më i madh se 50 cm<sup>3</sup> dhe që në rrugë të rrafshët, nuk mund të zhvillojë shpejtësi më të madhe se 50 km/h;

41)“**motoçikleta**” nënkupton mjetin motorik me dy rrotë, me ose pa rimorkio anësore si dhe automjet me tri rrotë – në qoftë se masa e tij nuk është më e madhe se 400 kg;

42)“**vetura**” nënkupton mjetin motorik, i destinuar për bartjen e njerëzve që, përveç ulëses së shoferit, ka më së shumti tetë ulëse;

43) “**autobusi**” nënkupton mjetin motorik i destinuar për bartjen e personave që përveç ulëses së shoferit, ka më shumë se tetë ulëse;

44) “**trolejbusi**” nënkupton mjetin e destinuar për mbartjen e personave që përveç ulëses së shoferit, ka më shumë se tetë ulëse dhe që për t’i dhënë motorit energji elektrike është i lidhur me përçuesin elektrik;

45) “**tramvaji**” nënkupton mjetin me binar me lëvizje elektrike, i destinuar për transport publik që për t’i dhënë motorit energji elektrike është i lidhur me përçuesin elektrik;

46) “**mjet transporti**” nënkupton çdo mjet motorik që është i destinuar për transportimin e ngarkesës (mallit);

47) “**mjet i kombinuar**” nënkupton mjetin motorik i destinuar për mbartjen e personave dhe sendeve, masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk i kalon 3.500 kg;

48)“**biçikleta**” nënkupton mjetin rrugor që ka së paku dy rrotë dhe që lëviz vetëm me fuqinë e shoferit;

49) “**mjet bashkangjitës**” nënkupton mjetin rrugor i destinuar që të tërhiqet nga mjeti me veprim motorik i konstruktuar si rimorkio apo gjysmë-rimorkio;

50)“**rimorkio**” nënkupton mjetin rrugor bashkangjitës i konstruktuar në atë mënyrë që masën e tërësishme nëpërmjet akseve të veta, ta mbartë mbi rrugën automobilistike;

51)“**gjysmë-rimorkio**” nënkupton mjetin bashkangjitës pa boshtin e përparmë, i konstruktuar në atë mënyrë që pjesën e masës së tërësishme që bartet në mjetin tërheqës, nëpërmjet pjesës së vet të përparme me të cilën mbështetet në mjetin me veprim motorik tërheqës;

52)“**rimorkio e lehtë**” nënkupton mjetin bashkangjitës masa më e madhe e lejuar e të cilit nuk është më e madhe se 750 kg;

53)“**bashkësia e mjeteve**” përbëhet prej mjeteve me veprim motorik dhe mjetet e bashkangjitura të cilat në komunikacion rrugor marrin pjesë si tërësi;

- 54)“**qerre**” nënkupton mjetin rrugor i destinuar për tërheqje me kafshë;
- 55)“**bartja**” nënkupton masën e lejuar deri në të cilin mjeti rrugor lejohet të ngarkohet sipas deklaratës së prodhuesit të mjetit rrugor;
- 56)“**masa e mjetit**”-nënkupton masën e mjetit të zbrazët me rezervar të plotë të karburantit si dhe me vegla e pajimet e obliguara për mjetin;
- 57)“**masa e përgjithshme**” nënkupton masën e mjetit rrugor së bashku me masën e ngarkesës që transportohet me mjet, duke përfshirë edhe masën e personave që gjenden në mjet, si dhe masën e mjetit të bashkangjitur me ngarkesë, në qoftë se ai i është shtuar mjetit tërheqës;
- 58)“**masa me e madhe e lejuar**”, nënkupton masën e mjetit së bashku me bartjen e mjetit;
- 59)“**ngarkim boshtor**” nënkupton pjesën e masës së përgjithshme me të cilin boshti i mjetit e ngarkon sipërfaqen e rrugës kur mjeti rrugor ndodhet në gjendje të palëvizshme;
- 60) “**pjesëmarrës në komunikacion**” nënkupton personin që në çfarëdo mënyre merr pjesë në komunikacionin rrugor;
- 61)“**shofer**” nënkupton pjesëmarrësin në komunikacion i cili në rrugë drejton mjetin rrugor;
- 62)“**këmbësor**” nënkupton pjesëmarrësin në komunikacion, që nuk drejton mjetin rrugor e as që bartet në mjetin rrugor apo mbi mjet, personi i cili me fuqinë e vetë shtyn apo tërheq karrocë dore, qerre kafshësh apo mjetin me lëvizje me veprim motorik, mjetin transportues të fëmijëve, çikletën apo karrocën lëvizëse për njerëz të paaftë, personi me karrige lëvizëse, i cili e lëviz atë me fuqinë e vet ose me fuqinë e motorit, po qe se më atë rast lëviz me shpejtësinë e njeriut që ecë, dhe personi i cili rrëshqet me patina, me ski ose me saje apo udhëton me rrotëza, etj;
- 63)“**përball kalim**” nënkupton kalimin me mjetin rrugor pranë mjetit tjetër i cili nëpër të njëjtën rrugë lëvizë nga kahu i kundërt;
- 64) “**tejkalimi**” nënkupton kalimin me mjet pranë mjetit tjetër rrugor, që lëviz në të njëjtin kah;
- 65)“**anashkalim**” nënkupton kalimin me mjetin pranë një mjeti të ndalur ose të parkuar apo pranë një objekti tjetër që gjendet në shiritin e komunikacionit nëpër të cilën lëviz mjeti rrugor;
- 66)“**Kolonë e këmbësorëve**” nënkupton grupin e organizuar të këmbësorëve të udhëhequr nga udhëheqësi ose komanduesi i tyre;
- 67)“**rrjedhë e komunikacionit**” nënkupton kolonën e shumë mjeteve të cilat nëpër rrugë lëvizin në të njëjtën kahe;
- 68) “**ndërrimi i shiritit të komunikacionit**” nënkupton kalimin me mjet prej një shiritit në shirit tjetër të komunikacionit për komunikacion në të njëjtin drejtim për shkak rreshtimit ose lëvizjes më të shpejtë;
- 69) “**pengimi i komunikacionit**” nënkupton veprimin në komunikacion me të cilin dikush në kundërshtim të rregullave të komunikacionit e detyron ta ndërroj mënyrën e deritanishme të pjesëmarrjes në komunikacion;



- 70) “**rrezikim i komunikacionit**“ nënkupton mënyrën e tillë e sjelljes në komunikacion për shkak të cilës ka ardhur deri rreziku i drejtpërdrejt për të shkaktuar aksidenti të komunikacionit;
- 71) “**dukshmëri e kufizuar**“ nënkuptohet dukshmëria e kufizuar (zvogëluar) në përgjithësi prej muzgut deri në agim si dhe gjatë kushteve të vështira atmosferike nga agimi deri në muzg;
- 72) “**Kujdes i veçantë**”(shtuar) - nënkupton kujdesin e shtuar dhe përshtatjen e sjelljes së pjesëmarrësit në komunikacion rrugor sipas kushteve dhe situatave në rrugë;
- 73) “**Mjet që lëvizë ngadalë**” - nënkupton mjetin e pajisur me motor, dizajni i të cilit kufizon shpejtësinë maksimale të saj deri në 25 km/orë. Kjo nuk përfshin traktorin;
- 74) “**mjet i përdorur për qëllime speciale**” - nënkupton mjetin e dizajnuar në mënyrë të veçantë për transportimin (lëvizjen) e njerëzve dhe mallrave, që përdoren Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, brigadat e zjarrfikëse, policia e burgut dhe të ngjashme;
- 75) “**gjysmë rimorkiatori**”- nënkupton mjetin transportues i destinuar për tërheqjen e gjysmë-rimorkion;
- 76) “**mjet i vjetër**” - bazuar në rregullore të veçantë, nënkupton mjetin i cili është i regjistruar si objekt muzeu ose është përfshirë në regjistrin qendror të materialeve kombëtare trashëgimore;
- 77) “**Autobus i shkollës**” - nënkupton autobusin e dizajnuar për transportimin e fëmijëve vajtje-ardhje në shkollë, duhet të jetë i ngjyrosur në të portokalltë dhe i shënuar para dhe prapa me anë të tabelave drejtkëndore me tekst “autobus i shkollës”sipas rregullave të parapara;
- 78) “**Ndalje**” - nënkupton çdo ndërprerje e lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje deri tre minuta ,pos ndërprerjes e cila bëhet për të vepruar sipas shenjës apo rregullës më të cilat rregullohet komunikacioni;
- 79) “**Parkimi**” - nënkupton çdo ndërprerje të lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje më shumë se tre minuta, pos ndërprerjes e cila bëhet për të vepruar sipas shenjës apo rregullës më të cilat rregullohet komunikacioni;
- 80) “**Ndalja emergjente**”- nënkupton ndërprerjen e lëvizjes kur mjete është i papërdorshëm për shkak avarisë ose duhet të ndalet për ndonjë arsye tjetër;
- 81) “**Kthimi gjysmë-rrethor**” – nënkupton kthimin e mjetit për 180 shkallë nga kahja e deritashme e lëvizjes për arsye të futjes në drejtim të kundërt të lëvizjes;
- 82) “**Lëshimi i mjetit**” - nënkupton veprimin të cilin në kushtet e caktuara shoferi është i obliguar që të bëjë me ndaljen e mjetit, me zvogëlimin e shpejtësisë së lëvizjes, ose me ndërprerjen e veprimit të cilin e kryen me mjet, dhe atë në atë mënyrë që nuk e detyron shoferin e mjetit tjetër që me vrull ta ndërrojë drejtimin;
- 83) “**Kolona**” - nënkupton rendin e së paku tri mjeteve që janë të ndaluara në rrugë apo që lëvizin në shiritin e njëjtë të komunikacion në të njëjtin kah, gjatë së cilës shpejtësia e lëvizjes së mjeteve dhe veprimin i shoferëve janë të kushtëzuar në mes vete dhe në mes nuk mundet të hyjë në mënyrë të papenguar mjete tjetër;

84) “**Aksident i komunikacionit**” - nënkupton aksidentin në rrugë në të cilin ka marrë pjesë më së paku një mjet në lëvizje në të cilin një apo më shumë persona kanë vdekur ose janë lënduar ose është shkaktuar dëm material. Nuk është aksident i komunikacionit ku makina e punës, motokulivatori, traktori ose qerrja të cilat lëvizin nëpër rrugët e pa kategorizuara ose gjatë kryerjes së punëve në lëvizje ka rrëshqitur nga rruga e pa kategorizuar, ose është rrokullisur ose është ndeshur me ndonjë pengesë natyrore, gjatë kësaj nuk merr pjesë ndonjë mjet tjetër ose këmbësori dhe në këtë ngjarje personit tjetër nuk i është shkaktuar dëm material;

85) “**Dëm materiale i vogël në aksidentin të komunikacion**” - nënkupton dëmin e shkaktuar në objektet dhe në mjet, përveç pjesëve vitale për drejtim ose frenim pa të cilat mjete nuk mund të lëviz në rrugë;

86) “**Patentë shoferi**” - nënkupton dokumentin publik të cilin e lëshon organi kompetent dhe i cili dëshmon të drejtën për ta drejtuar kategorinë e caktuar të mjeteve;

87) “**Patentë shoferi ndërkombëtar**”- nënkupton patentë shoferi ndërkombëtar të cilin e lëshon organi kompetent;

88) “**patentë shoferi i huaj**”- nënkupton patentë shoferi dhe patentë shoferi ndërkombëtar të cilin e kë lëshuar organi kompetent te atij shtetit;

89) “**Leja e komunikacionit**” - nënkupton dokumentin publik të cilin e lëshon organi kompetent dhe e cila dëshmon të drejtën e një mjetit që përcakton tabelat e regjistrimit dhe pronësinë e atyre tabelave, vetitë teknike, vetit dhe karakteristikat tjera, gjendja teknike e rregullt për të marrë pjesë në mënyrë të sigurt në komunikacion si dhe vlefshmërinë e tyre;

90) “**Libreza e mjetit**” - nënkupton dokumentin publik të cilin e lëshon organi kompetent me të cilën dëshmohet pronësia e një mjetit të caktuar, vetit teknike, vetit dhe karakteristikat tjera;

91) “**Mjet i bujqësor**”- nënkupton mjetin që përdoret për nevojat e bujqësisë;

92) “**Licenca e shofer-instruktorit**” - nënkupton dokumentin publik të cilën e lëshon MTPT dhe i cili dëshmon të drejtën për të aftësuar kandidatin për dhënien e provimit për shofer nga lënda mësimore të drejtuarit e mjetit motorik (pjesa praktike);

93) “**Muzgu**” - përfshin periudhën e kohës prej gjysmë ore para përdimit të diellit;

94) “**Agimi**” - përfshin periudhën e kohës gjysmë ore mbas lindjes së diellit;

95) “**tahografi**” nënkupton pajisjen e cila së paku siguron regjistrimin e shpejtësisë dhe rrugën e kaluar të mjetit;

96) “**euro- tahografi**” nënkupton pajisjen e cila siguron dhe regjistron kohën e ngasjes së ekuipazhit të mjetit, kohën e kaluar në kryerjen e aktiviteteve profesionale të cilat nuk bëjnë pjesë në drejtim të mjetit, kohën e pushimit, shpejtësinë e lëvizjes dhe rrugën e kaluar;

97) “**Fletëza e regjistrimit**” nënkupton pjesën e tahografit ose euro - tahografit i cili duhet ti ketë lejen e tipit në të cilën treguesi i tahografit ose euro - tahografit pa ndërprerë shkruan të dhënat të cilat duhen të mbeshin të shkruar përherë;

98) “**Personi juridik ose fizik për mirëmbajtjen e rrugëve**” nënkupton Kompaninë e cila ka hyrë në marrëdhënie kontraktore për mirëmbajtjen e rrugëve me Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ose Kuvendet Komunale;

99)“**Person**” nënkupton personin fizik dhe juridik;

100)“**Organizatë afariste**” nënkupton të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/6 për Shoqëritë Tregtare.

3.2. Përkufizimet nocioneve të cilat shfrytëzohen në këtë ligj dhe nuk janë të definuar tek nocionet, kanë definim në ligjet tjera.

## KAPITULLI II

### AUTORIZIMET PËR MBIKËQYRJEN DHE RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT

#### Neni 4

4.1. Mbikëqyrjen dhe rregullimin e komunikacionit, të mjeteve, shoferëve dhe pjesëmarrësve tjerë në komunikacionin rrugor e kryejnë pjesëtarët e policisë të autorizuar nga Shërbimi Policor i Kosovës.

4.2. Mbikëqyrjen mbi kohëzgjatjen e përgjithshme të drejtuarit e mjeteve, pushimin e shofereve, tahografat, të pajisjeve, mjeteve në pikëpamje të masës më të madhe të lejuar, dimensionet dhe ngarkesat boshtore, mjetet të cilat kryejnë transportin publik të udhëtarëve dhe mallit, mjeteve të cilat bartin materiet e rrezikshme, taksi veturat e të ngjashme, përveç personave të autorizuar nga Shërbimi Policor i Kosovës e kryejnë edhe inspektorët e komunikacionit rrugor dhe ata të rrugës në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj.

4.3. Në vendet ku janë të vendosura forcat e KFOR-it dhe TMK-ja , mbikëqyrja gjatë qarkullimit të këtyre njësive duhet gjithashtu të kryhet nga personeli i autorizuar i këtyre njësive në trafikun publik.

4.4. Mbikëqyrësi ose mësimdhënësi i cili udhëheq nxënësit në mënyrë të organizuar mund me shenjë e paraparë të dorës, të ndal komunikacionin e mjeteve, për shkak të kalimit të sigurt të fëmijëve nëpër rrugë.

4.5. Në kalim të rrugës nëpër vijën hekurudhore në të njëjtin nivel gjatë kohës së ardhjes së trenit, ndaljen e komunikacionit sipas rregullave të parapara e bëjnë punëtorët e hekurudhës.

#### Neni 5

Qeveria, themelon Këshillin për siguri në komunikacionin rrugor me propozimin e Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 6

Përbërja, funksionimi, mënyra e organizimit dhe financimi i Këshillit për siguri në komunikacionin rrugor rregullohet me një akt të veçantë juridik i cili propozohet nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, ndërsa miratohet nga Qeveria.

## KAPITULLI III

## RRUGËT Rregullat e Përgjithshme

### Neni 7

7.1. Rrugët, si bazë mbi të cilën zhvillohet komunikacioni, duhet të projektohen, ndërtohen, pajisen, mbahen dhe të mbrohen në mënyrë që t'i përgjigjen destinimit të vet dhe kërkesave të sigurisë së komunikacionit, në përputhje me rregullat e Ligjit mbi Rrugët dhe rregullave të nxjerra mbi bazë të këtij ligji.

7.2. Rrugët publike, pjesët e tyre të caktuara dhe objektet në to, mund të lëshohen për komunikacion vetëm pasi, në mënyrën e caktuar me legjislacionin në fuqi, të konstatohet se në pikëpamje të sigurisë së komunikacionit rrugor i plotësojnë kushtet e caktuara teknike.

### Neni 8

8.1. Rrugët publike duhet të kenë dy shirita komunikacioni dhe dy shirita skajore, që ndërtohen pa ndërprerje përgjatë rrugës publike në gjerësi të njëjtë, varësisht nga lloji i rrugës, përkatësisht në gjerësi e shiritit të komunikacionit, me skaje të ngritura në objekte (ura, viadukte, tunele, galeri etj.).

8.2. Përjashtimisht nga rregullat e paragrafit 1 të këtij neni, rruga lokale mund të ketë vetëm një shirit të komunikacionit, me kusht që, varësisht nga dukshmëria e rrugës, në një largësi prej më së shumti 500 m, të ketë zgjerime përkatëse për përball-kalimin e mjeteve.

8.3. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, përkatësisht Kuvendet Komunale i përcaktojnë kushtet dhe mënyrat e vendosjes së sinjalizimeve dhe të drejtuarit e komunikacionit rrugor në rrugët publike me rastin e ndërtimit, rekonstruktimit, dhe mirëmbajtjes së rrugëve.

8.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, personi që është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit dhe i cili vepron në kundërshtim me rregullat që përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e vendosjes si dhe të mirëmbajtjes së sinjalizimit me rastin e konstruktimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve publike.

### Neni 9

9.1. Rrugët publike, përveç rrugëve lokale, duhet të jenë në gjendje të përballojnë ngarkesën boshtore prej së paku 11.500 kg.

9.2. Rrugët lokale, si dhe rrugët e pa kategorizuara, duhet të jenë në gjendje të përballojnë ngarkesën boshtore prej së paku 6.000 kg.

### Neni 10

10.1. Mbi tërë gjerësinë e rrugës, rrugët publike duhet ta kenë hapësirën e lirë në lartësi prej së paku 4,5 metra.

10.2. Përjashtimisht në ura, tunele, në galeri ose objekte të ngjashme në rrugë publike, gjerësia e rrugës mundet të mos jetë e njëjtë sikurse gjerësia e rrugës publike.

10.3. Vendndalimet e Autobusëve për hyrje dhe dalje të udhëtarëve, në rrugë publike jashtë dhe brenda zonës së banuar në rrugët magjistrale dhe rajonale duhen të jenë jashtë shiritit të komunikacionit.

## 2. SHËNIMI I PUNIMEVE DHE PENGESAVE NË RRUGE

### Neni 11

11.1. Pjesa e rrugës në të cilën janë krijuar pengesa të cilat nuk mund të mënjanojnë menjëherë ose në të cilën kryhen punimet duhet të shënohet në mënyrë të dukshme përmes materialeve retra-reflektuese dhe në te duhet të sigurohen pjesëmarrësit në komunikacion. Megjithatë nëse largimi i tyre nga rruga është i pamundshëm ato duhet të shënohen në mënyrë të tillë që ato të jenë të dukshme ditën dhe natën.

11.2. Shënimi i rrugës nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet nga kryerësi i punëve duke vendosur shenjat përkatëse të komunikacionit, kurse sigurimi i pjesëmarrësve në komunikacion, duke vendosur barrierat.

11.3. Barrierat duhet të jenë të ngjyrosura sipas standardeve evropiane, ndërsa në rast të pashmërisë së kufizuar duhet të vendoset edhe drita vezulluese ngjyrë portokalli.

11.4. Personi i cili kryen punë në rrugë duhet të përdor elemente retra-reflektuese të cilat janë të dukshme për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

11.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 € dënohet, personi që kryen punë në rrugë, në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 12

12.1. Personi që për shkak të punimeve në rrugë ose rrethanave tjera (ortekët e bores, shembje, rrëshqitje ose të ngjashme) është i detyruar të organizoj lëshimin alternativ të mjeteve nga kahja e kundërt, rregullimin mund ta bëjë duke i vendosur shenjat ndriçuese të komunikacionit të cilat vendosen përkohësisht.

12.2. Para fillimit të punëve të parapara në paragrafin 1 të nenit aktual ( përveç rasteve emergjente ) një personi duhet t'i jepet leja nga organet kompetente varësisht nga lloji i rrugës dhe të informohet policia lidhur me këtë.

12.3. Lëshimin alternativ të mjeteve nga kahja e kundërt të parapara nga paragrafi 1 i këtij neni, përjashtimisht mund të bëjnë përfaqësuesit e punë kryerësit të cilët i kryejnë punimet në rrugë deri sa nuk i vendosin përkohësisht shenjat ndriçuese të komunikacionit.

12.4. Në rast se rregullohet komunikacioni sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfaqësuesit e punë kryerësit, duhet të përdorin elemente retro-reflektuese të cilat janë të dukshme për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

12.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 530 deri 2.000 € personi që gjatë kryerjes së punimeve në rrugë ose kur ekzistojnë rrethana të tjera, nuk e organizon lëshimin alternativ në pajtim me dispozitat e këtij neni ose nuk e ka lejen sipas paragrafit 2 të këtij neni.

12.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi fizik që vepron në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni.

## KAPITULLI IV SHENJAT E KOMUNIKACIONIT

### 1. Rregullat e përgjithshme

#### Neni 13

13.1. Rrugët publike duhet të shënohen me sinjale të parapara të komunikacionit, me të cilat pjesëmarrësit në komunikacion paralajmërohen për rrezikun që u kanoset në rrugën e caktuar publike ose në një pjesë të saj, njoftohen për kufizimet, për ndalimet dhe për obligimet të cilave duhet ti përmbahen pjesëmarrësit në komunikacion dhe japin njoftime të nevojshme për zhvillimin e sigurt dhe të papenguar të komunikacionit.

13.2. Shenjat e komunikacionit duhet të shënojnë edhe rrezikun me karakter të përkohshëm, sidomos atyre të cilat dalin si rezultat i dëmtimit ose pa aftësimin të rrugës, kufizimet, ndalimet dhe obligimet e përkohshme, dhe këto shenja duhet të largohen pasi të kalojnë arsyet e vendosjes së tyre.

13.3. Shenjat e komunikacionit janë: shenjat e rrezikut, shenjat e urdhrave të prera dhe shenjat e lajmërimit me ose pa tabelë plotësuese e cila përcakton më hollësisht domethënien e shenjës së komunikacionit, sinjalet me dritë, shenjat në sipërfaqen e rrugës, në trotuar dhe shenjat e tjera në rrugë.

13.4. Pjesëmarrësit në komunikacion janë të obliguar t'iu përmbahen kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shprehura përmes shenjave të komunikacionit.

13.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 € personi që është përgjegjës për vendosjen e shenjave të komunikacionit në rrugë dhe i cili vendosjen e shenjave e bënë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.

13.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € pjesëmarrësi në komunikacion, që nuk i përmbahet kufizimeve, ndalimeve dhe obligimeve të shprehura përmes shenjave të komunikacionit sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni.

#### Neni 14

14.1. Shenjat e komunikacionit vendosen dhe mirëmbahen ashtu që pjesëmarrësit në komunikacion mundën me kohë dhe lehtë ti vërejnë ditën dhe natën dhe duke vepruar me kohë, sipas domethënies së tyre.

14.2. Shenjat e komunikacionit duhet të largohen, plotësohen ose ndërrohen nëse domethënia nuk i përgjigjet ndërrimeve të komunikacionit në rrugë ose kërkesave të sigurisë nëse janë të dëmtuara ose të shkatërruara.

14.3. Shenjat e komunikacionit, pajisjet dhe sinjalizimi në rrugë vendosen në bazë të projektit të komunikacionit.

14.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 €, personi që është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit në rrugë dhe i cili nuk e bënë këtë ashtu që shenjat e komunikacionit të vërehen me lehtë si ditën ashtu edhe natën, si dhe nëse nuk i largon ose zëvendëson shenjat e komunikacionit të cilat nuk iu përgjigjen ndryshimeve të kushteve të komunikacionit ose kërkesave të sigurisë në komunikacion.

## Neni 15

15.1. Në shenjen e komunikacionit ose në shtyllën e saj në të cilën është e vendosur shenja e komunikacionit ndalohet vendosja çdo gjëje që nuk ka të bëjë me shenjen e komunikacionit.

15.2. Ndalohet personave të pa autorizuar të vendosin, largojnë, ndërrojnë ose dëmtojnë shenjat e komunikacionit, pajisjeve të rrugëve ose ndërrimin e domethënies së shenjës së komunikacionit.

15.3. Për kundërvajtje dënohet me gjobë prej 65 deri 170 €, personi fizik i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

15.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 530 deri 5.500 € personi nëse bënë vendosjen, largimin, ndryshimin dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit pa autorizim ose ndërrimin e domethënies së shenjës.

## Neni 16

16.1. Në rrugë nuk lejohet të vendosen tabelat, shenjat, dritat, shtylla ose sende të ngjashme me të cilat mbulohet dukshmëria e shenjave të komunikacionit, kur me formën, ngjyrën, pamjen ose vendin ku janë të vendosura shihen si shenja të komunikacionit, janë të ngjashme me ndonjë shenjë të komunikacionit, i verbon pjesëmarrësit në komunikacion dhe ua tërheq vëmendjen deri në atë masë e cila mund të jetë e rrezikshme për sigurinë e komunikacionit.

16.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 deri 170 € personi fizik që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

16.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 530 deri 5.500 € edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

## 2. SHENJAT E PARALAJMËRIMIT (RREZIKUT), URDHRAVE TË PRERA DHE TË LAJMËRIMIT (TREGUESE)

## Neni 17

17.1. Shenjat paralajmëruese (rrezikut) shërbejnë që pjesëmarrësit në komunikacion rrugor të paralajmërohen për rrezikun që kanoset në ndonjë vend të caktuar, përkatësisht në një pjesë të rrugës dhe njoftohen për natyrën e këtij rreziku.

17.2. Shenjat e urdhrave të prera ua vejnë në dijeni pjesëmarrësve në komunikacion rrugor: ndalimet, kufizimet dhe obligimet të cilave duhet ti përmbahen.

17.3. Shenjat lajmërimit (treguese) iu japin pjesëmarrësve në komunikacion njoftime të nevojshme për rrugën nëpër të cilën lëvizin dhe njoftimet të tjera të cilat mund të jenë të dobishme.

17.4. Shenjat e lajmërimit për orientimin e komunikacionit i lajmërojnë pjesëmarrësit në komunikacion mbi shtrirjen e drejtimeve në rrugë, radhitja e caqeve dhe orientimi i komunikacionit në drejtim të atyre caqeve dhe atë në kryqëzim, nyje ose nga pushimoret në vende të caktuara të rrugës.

## Neni 18

Shenjat e rrezikut dhe urdhrave të prera duhet të jenë të mbuluara me materie retro-reflektuese ose me burim të vetin ndriçues, ndërsa në autostradë, rrugë të shpejta, rrugë të rezervuar vetëm për komunikacion të mjeteve motorike këtë veti duhet ta kenë edhe shenjat e lajmërimit.

### 3. SHENJAT NDRIÇUESE TE KOMUNIKACIONIT (SEMAFORËT)

## Neni 19

19.1. Për rregullimin e komunikacionit përdoren shenjat ndriçuese të komunikacionit (ne tekstin e tutje semaforët) me tri ngjyra të vendosura vertikalisht njëra mbi tjetrën si vijon: drita e kuqe lartë, drita e verdhë në mes, kurse drita gjelbër poshtë.

19.2. Nëse semafori është i vendosur mbi shiritin e komunikacionit, drita mund të vendoset horizontalisht, njëra pranë tjetrit si vijon: drita e kuqe majtas, e verdha në mes, gjelbër në të djathtë. Këto drita kanë formë rrethi, kurse drita e gjelbër mund të jetë në formë shigjete ose disa shigjetave të vendosura në një rreth me ngjyrë të zezë.

19.3. Në semafor drita me ngjyrë të kuqe dhe gjelbër nuk mund të ndezën në të njëjtën kohë, ndërsa drita e verdhë e vetme pa ndërprerje prej kalimit të dritës së gjelbër në atë të kuqe ose në të njëjtën kohë me të kuqe para se të paraqitet drita e gjelbër.

19.4. Semaforit me drita tri ngjyra mund t'i shtohet një shenjë plotësuese me drita në formë shigjete ose disa shenja të këtilla ,të cilat vendosen në anën përkatëse të semaforit në lartësinë në të cilën ndodhet drita e gjelbër.

19.5. Përbashimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, shenja plotësuese-ndriçuese e komunikacionit në formë shigjete me ngjyrë të gjelbër për kthim majtas mund të jetë e vendosur si dritë e komunikacionit e veçantë për dalje nga kryqëzimi.

19.6. Drita me ngjyrë të gjelbër vezulluese paralajmëron ndërprerjen e shpejtë të kalimit të lirë, përkatësisht paraqitjen e ngjyrës së verdhë pastaj të kuqe, ndërsa drita me ngjyrë të verdhë vezulluese shërben për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit në komunikacion të lëvizin me kujdes të shtuar.

## Neni 20

20.1. Në semafor në rrugë me më tepër se dy shirita të komunikacionit të shënuar për së gjati me shënime në rrugë, ku komunikacioni drejtohet për çdo shirit veçmas dhe të cilat janë të vendosura mbi shirita të komunikacionit, drita e kuqe ndalon komunikacionin përgjatë shiritit të komunikacionit mbi të cilin është e vendosur; drita e gjelbër kalimin e lirë nëpër shiritin e komunikacionit mbi të cilin është vendosur drita.

20.2. Drita e kuqe nga paragrafi 1 i këtij neni e ka formën e “x”, ndërsa drita ngjyrë të gjelbër formën e shigjetës me maje të kthyer poshtë.

20.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 deri 130 € pjesëmarrësi në komunikacion që nuk i respekton shenjat e përcaktuara në këtë nen dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të drejtuarit të mjetit motorik për dy deri në gjashtë muaj si dhe i shqiptohen dy pikë negative.



## Neni 21

Për rregullimin e komunikacionit të këmbësorëve mund të përdoret semafori me drita dy ngjyra dhe pajisjet zanore. Semafori me drita dy ngjyrësh të kuqe dhe gjelbër vendoset vertikalisht njëra nën tjetrën si vijon: drita e kuqe lartë, kurse drita e gjelbër poshtë dhe në to është e vendosur figura e këmbësorit, te drita me ngjyrë të kuqe në pozitë të ndalur, ndërsa të ngjyra e gjelbër në pozitë të lëvizjes. Këto dy ngjyra nuk duhet të ndizen në të njëjtën kohë.

## Neni 22

22.1. Skajet e rrugës shënohen me sinjale drite dhe materie retro-reflektuese, ndërsa treguesit e kaheve shënohen me elemente metalike të pajisura me materie reflektuese, shtyllat ndriçuese etj.

22.2. Kahet e treguesve të cilët janë të vendosura në rrugë, nga ana e djathtë në drejtim të lëvizjes janë me ngjyrë të kuqe, ndërsa në anë e majtë me ngjyrë të bardhë.

22.3. Nëse kulmet e ishujve të këmbësorëve, ishujt për orientimin e komunikacionit dhe objektet tjera në rrugë, nuk janë të dukshme natën sa duhet, ato duhet të shënohen me drita, me materie retro-reflektuese ose materie reflektuese me ngjyrë të verdhë.

22.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 530 deri 5.300 € personi që është përgjegjës për vendosjen ose mirëmbajtjen e kulmeve të ishujve të këmbësorëve, të ishujve për orientimin e komunikacionit ose të objekteve tjera në rrugë të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.

## 4. SINJALIZIMI HORIZONTAL I KOMUNIKACIONIT (SHENJAT NË RRUGË)

### Neni 23

23.1. Shenjat në rrugë shërbejnë për orientimin, lajmërimin dhe për drejtimin e pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor.

23.2. Shenjat në rrugë mund të vendosen vetëm ose së bashku me shenjat tjera të komunikacionit nëse është e nevojshme që kuptimi i këtyre shenjave të theksohet më tepër, përkatësisht të përcaktohet ose të sqarohet në mënyrë më të plotë.

23.3. Shenjat në rrugë janë vijat, shigjetat, mbishkrimet dhe shenjat tjera .

23.4. Shenjat në rrugë mund të kenë edhe veti pasqyruese.

### Neni 24

24.1. Shenjat vendosen në rrugë me sipërfaqe bashkëkohore.

24.2. Në rrugë publike jashtë zonave të banuara, në rrugë me shtresë bashkëkohore për komunikacion në dy drejtime ku ekzistojnë vetëm dy shirita të komunikacionit, këto shirita duhet të jenë të ndarë me vijën përkatëse gjatësore në rrugë, kurse në rrugët rajonale dhe magjistrale, të shënuara edhe me vija anësore.

24.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 € personi që është përgjegjës për vendosjen e shenjave në rrugë, nëse nuk i vendos shenjat në pajtim me rregullat e përcaktuara në këtë nen.

## 5. SHËNIMI I KALIMIT TE RRUGËS NËPËR VIJËN HEKURUDHORE

### Neni 25

25.1. Në pjesën e rrugës para vendkalimit të rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore duhet të vendosen shenjat përkatëse të komunikacionit.

25.2. Përgjashtimisht nga rregullat e paragrafit 1 të këtij neni, shenjat nga ky paragraf nuk është e domosdoshme të vendosen në vendin ku shtigjet e këmbësoreve kryqëzohen rrafsh në nivel me vijën hekurudhore.

25.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 € personi që është përgjegjës për vendosjen e shenjave të komunikacionit dhe të sinjaleve ndriçuese akustike para vendkalimit mbi hekurudhë, nëse nuk e bën këtë sipas dispozitave të këtij neni.

### Neni 26

26.1. Në vendkalimet e rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore përveç shenjave të komunikacionit nga neni 25 i këtij ligji vihen edhe barrierat dhe gjysmë-barrierat, përkatësisht pajisjet për dhënien e shenjave me të cilat paralajmërohet afrimi i trenit në qoftë se këtë e kërkojnë dendësia e komunikacionit ose rrethanat e tjera në vendkalimin e rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore.

26.2. Kushtet në të cilat duhet të vendosen pajisjet nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen nga Ministria e Transportit dhe e Post-Telekomunikacionit me akt nënligjor.

### Neni 27

Shenjat me drita me të cilat paralajmërohet afrimi i trenit në vendkalimin e rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore jepen duke u ndezur në mënyrë alternative dy drita të kuqe vezulluese në formë rrethore.

### Neni 28

28.1. Në vendkalimet e rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore në të cilën ekzistojnë pajisjet për dhënien e shenjave me drita, të cilat paralajmërojnë afrimin e trenit përkatësisht lëshimi i barrierave dhe gjysmë-barrierave, kësaj pajisje mund ti bashkëngjitet edhe pajisja për dhënien e shenjave akustike (zanore).

28.2. Në vendkalimin e rrugës së pashtuar me komunikacion të dobët dhe të shtegut të këmbësoreve rrafsh në nivel me vijën hekurudhore, sigurimi i pjesëmarrësve në komunikacion mund të bëhet edhe vetëm me pajisjen për dhënien e shenjave akustike.

## Neni 29

29.1. Në vendkalimet e rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore barrierat dhe gjysmë-barrierat duhet të jenë të ngjyrosura në mënyrë alternative më ngjyrë të kuqe dhe të bardhë.

29.2. Barrierat dhe gjysmë-barrierat si dhe shenjat e komunikacionit të vendosura në pjesën e rrugës para vendkalimit të rrugës rrafsh në nivel me vijën hekurudhore, duhet të jenë të pajisura me qelq pasqyrues ose të veshura më lëndë pasqyruese me ngjyrë përkatëse.

29.3. Barrierat dhe gjysmë-barrierat duhet të jenë të pajisura me drita të kuqe vezulluese.

## Neni 30

30.1. Në vendkalimet e rrugës, rrafsh në nivel me vijën hekurudhore ku me rastin e ardhjes së trenit barrierat dhe gjysmë-barrierat lëshohen automatikisht si dhe në vendkalimin rrafsh në nivel me vijën hekurudhore ku barrierat dhe gjysmë-barrierat aktivizohen nga vendi i cili ato nuk shihen, duhet të vendosen pajisje për dhënien e shenjave me drita ose pajisje për dhënien e shenjave akustike me të cilat pjesëmarrësit në komunikacion njoftohen për lëshimin e barrierave dhe gjysmë-barrierave.

30.2. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me një akt nënligjor cakton rregullat mbi shenjat e komunikacionit dhe sinjalizimit në rrugë, rregullat bazë të cilat rrugët dhe elementet e tyre duhet ti plotësojnë nga aspekti i sigurisë në rrugë, rregullat për ndaljen e komunikacionit në vendkalimin e rrugës në nivel me vijën hekurudhore si dhe rregullat për lëshimin alternativ gjatë punimeve në rrugë.

30.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 € dënohet, personi që është përgjegjës për vendosjen e shenjave ndriçuese të komunikacionit ose të sinjaleve ndriçuese akustike, nëse nuk i vendos këto në pajtim me dispozitat e këtij neni.

## 6. SHENJAT QË JAPIN PËRSONAT E AUTORIZUAR

### Neni 31

31.1. Urdhrat dhe shenjat e pjesëmarrësve në komunikacion mund t'u jepen nga:

- a) polici;
- b) personat e autorizuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal në kuadër të kompetencave të tyre ligjore;
- c) ushtarët e KFOR-it dhe pjesëtarët e TMK-së mbajnë përgjegjësi për rend, me qëllim të sigurimit të qarkullimit të automjeteve ose këmbësorëve, ose të garantojnë aksione shpëtimi të dedikuara për shpëtimin e jetës apo pasurisë së personit;
- d) personeli i Rojeve (Policisë) Kufitare brenda kufijve të zonës kufitare;
- e) personeli i hekurudhave në kryqëzimet hekurudhore;
- f) punëtori i autoritetit rrugor, ose personi tjetër që punon në rrugë nëse, është lejuar apo është punësuar nga autoriteti rrugor;
- g) personi që mbikëqyrë kalimin e sigurt të rrugës nga fëmijët, në vendin e rregulluar dhe shënuar për kalimin e tillë.

31.2. Personat e lartpërmendur në paragrafin 1 duhet të jenë të dukshëm në një distancë të mjaftueshme ditën edhe natën.

## Neni 32

32.1. Pjesëmarrësit në komunikacion duhet të veprojnë sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrimit të personit të autorizuar i cili kryen kontrollin dhe rregullimin e komunikacionit në rrugë.

32.2. Personi i autorizuar me rastin e dhënies së shenjave, duhet të qëndroj në rrugë që pjesëmarrësit në komunikacion për të cilët jepet shenja të mund ta shohin atë lehtë edhe nga largësia e duhur.

32.3. Shenjat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jepen edhe nga mjete.

32.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi i mjeteve motorike që nuk vepron sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrimit të personit të autorizuar i cili kryen kontrollin dhe rregullimin e komunikacionit në rrugë dhe i shqiptohet një pikë negative.

32.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, pjesëmarrësi në komunikacion, me përjashtim të shoferit të mjeteve motorike, që nuk vepron sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrimit të personit të autorizuar i cili kryen kontrollin dhe rregullimin e komunikacionit në rrugë.

## Neni 33

33.1. Shenjat që personi i autorizuar i jep pjesëmarrësve në komunikacion janë shenjat që jepen me duar, me pozitë të trupit, shenjat zanore dhe me dritë.

33.2. Shenjat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jepen në atë mënyrë që domethënia e tyre për pjesëmarrësit në komunikacion të jetë e çartë dhe e pa dyshimtë.

## KAPITULLI V RREGULLAT E KOMUNIKACIONIT

### 1. Rregullat e përgjithshme

## Neni 34

34.1. Pjesëmarrësit në komunikacion janë të obliguar t'u përmbahen rregullave të komunikacionit, shenjave të komunikacionit të vendosura në rrugë si dhe shenjave dhe urdhrave të personit të autorizuar.

34.2. Pjesëmarrësit në komunikacion janë të obliguar të veprojnë në përputhje me shenjat e komunikacionit të vendosura në rrugë edhe kur me këtë shmangen nga rregullat e përgjithshme të komunikacionit.

34.3. Pjesëmarrësit në komunikacion janë të obliguar të veprojnë në përputhje me shenjat ndriçuese të komunikacionit edhe kur kjo dallon nga rregullat e komunikacionit për përparësinë e kalimit të shprehur në të njëjtin vend me shenjë tjetër të komunikacionit.

34.4. Pjesëmarrësit në komunikacion janë të obliguar të veprojnë edhe sipas kërkesave të shprehura me ndihmën e shenjave ose sipas urdhrave që i japin personat e autorizuar edhe kur me këtë shmangen nga rregullat e caktuara të komunikacionit ose nga domethënia e shenjave të komunikacionit të vendosura në rrugë ose shenjat ndriçuese të komunikacionit.

## Neni 35

35.1. Në rrugë, trotuar dhe në brezin mbrojtës të rrugës nuk lejohet lënia e mjeteve të dëmtuara, të papërdorura, të paregjistruara, të sendeve, materialit ose të gjërave të ngjashme si dhe hedhja e mbeturinave që mund të pengojnë ose rrezikojnë komunikacionin.

35.2. Shoferi i mjetit është i detyruar ti heqë nga sipërfaqja e rrugës sendet që bien në rrugë nga mjeti i tij dhe sendet që i ka lënë në rrugë, kur e ka ndalur mjetin.

35.3. Nëse shoferi, pronari i mjetit ose personi tjetër përgjegjës nuk vepron në përputhje me rregullat e paragrafit 2 të këtij neni, shpenzimet e tyre do ti mbulojë personi të cilit iu është besuar kryerja e mirëmbajtjes së rrugëve, nga ana e organit kompetent.

35.4. Shoferi do ti largoj sendet të cilat i has gjatë ngasjes nëse nuk pengohet siguria në komunikacion, ose në të kundërtën për këtë do të lajmëroj Shërbimin Policor të Kosovës.

35.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 € personi që urdhëron ose lejon që në rrugë, trotuar ose në brezin mbrojtës të rrugës të vendoset mjeti i dëmtuar, i pa përdorur, i pa regjistruar, të hidhen në rrugë ose trotuar mbeturinat ose sendet të cilat mund të rrezikojnë sigurinë në komunikacion, ose të cilat mund të ndotin ambientin si dhe nëse nuk i largon nga rruga dhe nga trotuari mjetet, mbeturinat, sendet dhe të ngjashme.

35.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, pjesëmarrësi në komunikacion që vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

## Neni 36

36.1. Rruga publike dhe brezi i saj mbrojtës, përkatësisht rruga dhe trotuari, nuk lejohen të dëmtohen ose të shfrytëzohen për qëllime të tjera (material ndërtimor, sendet, ose të ngjashme), përveç në rast rrezikut ose në raste tjera të parapara me ligj ose të autorizuara nga organi kompetent.

36.2. Kuvendet Komunale mund të lejojnë shfrytëzimin e pjesës së trotuarit (rrethoja, tavolina, ulëse, kioska ose të ngjashme) me kusht që nuk zvogëlohet dukshmëria e rrugës dhe që lëvizja e këmbësorëve të jetë e papenguar dhe e sigurt duke ju lënë hapësirë të trotuarit me gjerësi prej së paku 1,5 metra. Për rrugët magjistrale dhe regjionale, leja në fjalë mund të jepet vetëm me pëlqimin paraprak të Ministrisë së Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit.

36.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 70 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

36.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

## Neni 37

Personat e verbër, kur marrin vetë pjesë në komunikacion, si shenjë identifikimi duhet të mbajnë shkopin e bardhë.

## Neni 38

Shoferi detyrohet të ketë kujdes të veçantë ndaj personave të verbër nga neni 37 i këtij ligji.

## Neni 39

39.1. Mjeti i cili është i përshtatur për t'u drejtuar nga personi me aftësi të kufizuara, me kërkesën e këtij personi, mund të shënohet me shenjë të posaçme.

39.2. Të drejtat të cilat dalin nga shenja e qasjes nuk mund t'i përdor personi i cili nuk është me aftësi të kufizuara.

39.3. Shenja e qasjes lëshohet në emër të personit me aftësi të kufizuara, gjegjësisht për mjetet e shoqatës së personave me aftësi të kufizuara në emër të shoqatës, kurse pamja e shenjës, kushtet për marrjen e saj, mënyrën e shënimit të vendeve për parking dhe të drejtat të cilat merren në bazë të tij, i rregullon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në marrëveshje me Ministrin e Shëndetësisë.

39.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 270 deri 1.700 €, personi zyrtar që ia jep shenjën e qasjes personit i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë nen.

39.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi që përdor shenjën e qasjes por që nuk është person me aftësi të kufizuara në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni.

## Neni 40

40.1. Shoferi i mjetit i cili lëviz pranë mjetit të transportit publik të udhëtarëve ose pranë autobusit me të cilin kryhet transporti për nevoja personale i ndalur në vendndalim, duhet të lëviz me shpejtësi të zvogëluar dhe kujdes të shtuar ashtu që mos ti rrezikoj personat të cilët hyjnë ose dalin nga mjeti.

40.2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni, për shkak të hyrjes ose daljes nga mjeti duhet të kalojnë nëpër rrugë me kujdes të shtuar.

40.3. Shoferi duhet ta ndal mjetin e vet mbrapa mjetit nga paragrafi 1 i këtij neni, kur personat gjatë hyrjes ose daljes nga mjeti duhet të kalojnë nëpër shiritin e komunikacionit, shtegun (shiritin) e biçikletave ose shiritin në të cilin mjeti lëviz.

40.4. Shoferi i mjetit i cili lëviz prapa mjetit në të cilin transportohen fëmijët (autobusi – shkollor) dhe shoferi i mjetit i cili i vjen përballë në rrugë me një shirit të komunikacionit të destinuar për komunikacion në një drejtim, duhet të ndalen kur mjeti me të cilin transportohen fëmijët është ndalur në rrugë derisa fëmijët hyjnë ose dalin nga ai mjet.

40.5. Nëse me mjet transportohen fëmijët në mënyrë të organizuar mjeti duhet ti plotësojë kushtet e veçanta dhe të jetë i shënuar me shenje të veçantë, ndërsa gjatë kohës së hyrjes dhe daljes së fëmijëve nga mjeti shoferi duhet ti ndezë të gjithë treguesit e drejtimit të mjetit.

40.6. Ndalohet të shënohet mjeti me anë të shenjës së veçantë nga paragrafi 5 i këtij neni nëse, nuk transportohen fëmijët në mënyrë të organizuar dhe atëherë shenja e veçantë duhet mbështjell ose hequr.

40.7. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe kriteret për transportin e organizuar të fëmijëve si dhe shenjën e veçantë me të cilën duhet të shënohen këto mjete.

40.8. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që lëviz pranë mjetit të transportit publik të udhëtarëve ose pranë autobusit me të cilin kryhet transporti për nevoja personale, i cili është ndalur në vendndalim, nëse nuk ka lëvizur me shpejtësi të

zvogëluar dhe më kujdes të shtuar duke i rrezikuar me këtë personat të cilët hyjnë ose dalin nga mjete.

40.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që nuk e ndal mjetin e vet në kushtet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni.

40.10. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 4 të këtij neni. Të njëjtit i shqiptohet masa e ndalimit, të drejtuarit e mjetit motorik, në kohëzgjatje deri në tre muaj dhe 1 pikë negative.

40.11. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 € personi që është përgjegjës për transportin e grupeve të organizuara të fëmijëve dhe i cili urdhëron ose lejon që mjete me të cilin bëhet transporti në fjalë, nuk është i shënuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

40.12. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që transporton grupe të organizuar fëmijësh nëse mjete nuk është i shënuar në mënyrën e përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni ose shoferi i cili nuk i ka të ndezur të gjithë treguesit e drejtimit siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.

#### Neni 41

41.1. Ndalohet që mjetet në pjesën e përparme të kenë shenja-dhënës me drita ose lëndë që japin drita me ngjyrë të kuqe kurse në anën e prapme, shenjëdhënës ose lëndë që japin drita me ngjyrë të bardhë.

41.2. Rregullat e paragrafit 1 të këtij neni lidhur me dritat me ngjyrë të bardhë nuk kanë të bëjnë me dritën për ndriçimin e rrugës gjatë lëvizjes mbrapa, me dritën e lëvizshme për gjurmim (reflektori), me dritën për ndriçimin e targës dhe me targën e veshur me ngjyrë të bardhë pasqyruese dhe në mjetet e Shërbimit Policor të Kosovës, Ndihmës së shpejt, zjarrfikëseve dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

41.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 2. VEPRIMET NË KOMUNIKACION

#### Neni 42

42.1. Shoferi i cili në rrugë synon të bëjë ndonjë veprim me mjetin (lëvizjen e mjetit në anën e djathtë ose të majtë, të ndërrojë shiritin e komunikacionit, të tejkaloj ,anashkaloj,të ndal mjetin, kthimin në anën e djathtë ose në të majtë,kthimin gjysmë-rrethore,drejtimin e mjetit prapa e të ngjashme) i lejohe të fillojë një manovrim të tillë, vetëm nëse më parë është i bindur se mund të bëjë një gjë të tillë duke mos rrezikuar apo penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion ose pasurin, duke u kujdesur me këtë rast për pozitën e mjetit dhe për drejtimin dhe shpejtësinë e lëvizjes.

42.2. Shoferi i mjetit duhet të veproj sipas paragrafit 1 të këtij neni edhe kur kyçet në komunikacion.

42.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 43

43.1. Para se të ndërmerr ndonjë veprim në komunikacion, shoferi i mjetit duhet qartë dhe me kohë të duhur t'i para-lajmërojë pjesëmarrësit tjerë në komunikacion për qëllimin e tij, duke dhënë sinjal me anë të treguesve të drejtimit gjatë gjithë kohës së kryerjes së manovrimit dhe të ndërpret sinjalizimin menjëherë pas përfundimit të veprimit ose nëse nuk ekzistojnë treguesit e drejtimit duhet paralajmëruar veprimin duke dhënë shenjën përkatëse me dorë.

43.2. Shoferi i mjetit duhet gjithashtu pasi ta ketë kryer tejkalimin e mjetit tjetër, të japë sinjalin kur synon të kthehet në shiritin e komunikacionit në të cilin ka lëvizur para se ta bëjë tejkalimin.

43.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 3. KYQJA NË KOMUNIKACION

### Neni 44

Kyçja në komunikacion ndodh atëherë kur mjete fillon të lëviz nga ndalja apo parkingu i cili nuk ka rezultuar nga rrethanat ose rregullat e komunikacionit dhe kur hyn:

- a) në rrugë nga prona, rruga e dheut, nga objektet anësore të rrugës ose rruga që dërgon tek to, nga rruga e cila nuk është rrugë publike si dhe nga zona e qetë e komunikacionit;
- b) në rrugë nga toka bujqësore dhe nga rruga në të cilën nuk zhvillohet komunikacioni publik;
- c) në rrugë prej bankinës, trotuarit, shiritit të komunikacionit të përcaktuar për lëvizjen e mjeteve që lëvizin ngadalë;
- d) në rrugë nga shtegu i biçikletave;
- e) në rrugë nga depoja apo nga një vendnisje/ndalje e destinuar për mjete të cilat lëvizin nëpër binarë.

### Neni 45

45.1. Shoferi i cili me mjet kyçet nga rruga e dheut në rrugë me shtresë bashkëkohore (asfalt) duhet ta ndal mjetin dhe ta heq baltin nga rrotat.

45.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 46

46.1. Shoferi gjatë kyçjes në komunikacion, duhet të ushtroj kujdes të posaçëm dhe t'i jap përparësi çdo mjeti tjetër apo pjesëmarrësi tjetër të komunikacionit.

46.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 47

47.1. Shoferi gjatë afrimit të vend-ndaljes së autobusit të shënuar, brenda zonës së banuar, obligohet që të zvogëloj shpejtësinë dhe nëse është e nevojshme të ndalet, në mënyrë që t'i mundësoj shoferit të autobusit apo ndonjë mjeti tjetër i cili kryen transportin publik të udhëtarëve, që të kyçet në komunikacion, nëse shoferi i mjetit të tillë



sinjalizon me treguesin e drejtimit tendencën e tij që të ndërroj shiritin e komunikacionit ose të lëviz nga vend-ndalja e autobusit në rrugë.

47.2. Shoferi i autobusit të përmendur në paragrafin 1, mund të hyj në shiritin e afërt të komunikacionit ose të lëviz në rrugë vetëm pasi që të sigurohet që veprimi i tillë, nuk do të shkaktoj kurrfarë pengimi apo rreziku në komunikacion.

47.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

47.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i autobusit që vepron në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni.

#### Neni 48

48.1. Shoferi i mjetit gjatë afrimit, vendit të ndaljes së “autobusit shkollor“ duhet të ndal mjetin nëse shoferi i autobusit ka dhënë shenjë për ndalje të autobusit.

48.2. Shoferi i mjetit duhet zvogëloj shpejtësinë dhe nëse është e nevojshme që të ndal mjetin në mënyrë që t’i mundësoj shoferit të “autobusit shkollor“ të lëviz në rrugë ose shiritin më të afërt të komunikacionit, nëse shoferi i autobusit sinjalizon tendencën, që të bëjë një manovrim të tillë.

48.3. Shoferi i “autobusit shkollor“ nën rrethanat e përmendura në paragrafin 1, mund të lëviz në shiritin e afërt të komunikacionit ose në rrugë vetëm nëse është siguruar që manovrimi nuk do të shkaktoj pengim ose rrezikim në komunikacion.

48.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni.

48.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni.

48.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i autobusit shkollor që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni dhe me këtë i pengon ose i rrezikon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

### 4. LËVIZJA E MJETEVE

#### Neni 49

49.1. Shoferi obligohet të ngas mjetin në anën e djathtë të rrugës në kahe të lëvizjes.

49.2. Shoferi për lëvizjen e mjetit të vetë duhet të shfrytëzoj vetëm rrugën përkatësisht shiritin e komunikacionit dhe shtegun e destinuar për lëvizjen e atij lloji të mjeteve të cilit i takon mjeti, përveç në rast të rrezikut.

49.3. Shoferi obligohet të ngas sa më afër që është e mundur skajit të djathtë të rrugës. Nëse shiritat janë të shënuar, shoferi duhet të ngas mjetin nëpër mesin e shiritit të komunikacionit.

49.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni nëse me veprimin e tij ka shkaktuar pengesë ose rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

## Neni 50

50.1. Në rrugë në zonën e banuar me sipërfaqe rrugore në të cilin për lëvizjen e mjeteve në të njëjtën kahe ekzistojnë të paktën dy shirita të komunikacionit, shoferi për lëvizjen e vet mund ta shfrytëzoj edhe shiritin e komunikacionit që nuk ndodhet pranë skajit të djathtë të rrugës, ne qoftë se me këtë nuk i pengon mjetet tjera që lëvizin pas mjetit të tij.

50.2. Rregullat e paragrafit 1 nuk kanë të bëjnë me shoferin e mjetit të transportit me masën maksimale të lejuar mbi 3500kg, me shoferin e mjetit që në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 40 km/h, shoferin e çiklomotorit, traktorit, makinës së punës dhe motokultivatorit si dhe me shoferin e mjetit që nuk konsiderohet mjet motorik, përveç në pjesën e rrugës para kryqëzimit ose vendit tjetër ku mjete kthehet në të majtë.

50.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni nëse me veprimin e tij ka shkaktuar pengesë ose rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

## Neni 51

51.1. Në rrugën për lëvizjen e mjeteve në të dy kahet e cila ka të paktën katër shirita të komunikacionit, shoferit nuk i lejohet të kalojë me mjetin e vet në shiritin rrugor të destinuar për lëvizjen e mjeteve nga kahja e kundërt.

51.2. Në rrugën për lëvizjen e mjeteve në dy kahe ekzistojnë tre shirita të komunikacionit, ku shiriti i mesëm shfrytëzohet varësisht prej sinjalizimit. Shoferit të mjetit nuk i lejohet të lëvizë me mjetin e vetë nëpër shiritin e komunikacionit që ndodhet pranë skajit të majtë të rrugës në kahe të lëvizjes së mjetit.

51.3. Në rrugë në të cilën shiritat rrugor janë të ndarë fizikisht njëri prej tjetrit, shoferit nuk i lejohet të lëvizë mjetin e vetë nëpër shiritin rrugor të destinuar për lëvizjen e mjeteve nga kahja e kundërt.

51.4. Në rrugë për lëvizjen e mjeteve në një kahe, shoferit të mjetit nuk i lejohet lëvizja me mjetin e vetë në kahun e kundërt.

51.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1, 2, 3 ose 4 të këtij neni. Të njëjtit i shqiptohen dy pikë negative.

## Neni 52

Në rrugët në nivel me binarët e tramvajit, mjete mund të lëvizë mbi binarë në qoftë se nuk pengon lëvizjen e tramvajit, përveç nëse me shenja të komunikacionit nuk është përcaktuar ndryshe.

## Neni 53

53.1. Shoferi i mjetit i cili tenton të lëviz mbrapa me mjetin e vet këtë mund ta bëjë në pjesën e shkurtër të rrugës nëse nuk i pengon ose rrezikon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

53.2. Gjatë kohës së lëvizjes mbrapa, në mjet duhet të jenë të ndezur të gjithë treguesit e drejtimit.

53.3. Kur shoferi lëviz mbrapa me mjet duhet të lëviz në atë anë të rrugës në të cilën ka lëvizur deri atëherë.

53.4. Kur shoferi i mjetit lëviz prapa, duhet ti jap përparësi mjeteve të cilat vijnë prapa mjetit të tij.

53.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 5. SHPEJTËSIA

### Neni 54

54.1. Shoferi duhet të ngasë mjetin, me shpejtësi adekuate dhe sjellje e cila i lejon shoferit që të kontrolloj mjetin, në kushte ekzistuese të komunikacionit, posaçërisht duke pasur parasysh pamjen, kushtet dhe dukshmërinë e rrugës, kushtet dhe ngarkesën e mjetit, kushtet atmosferike dhe dendësinë e komunikacionit në mënyrë që mjetin e vet ta ndal para çdo pengese.

54.2. Shoferit nuk i lejohet që pa shkaqe të arsyeshme të lëvizë aq ngadalë me mjet duke shkaktuar me këtë pengesë ose rrezik për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

54.3. Kur shpejtësia e lëvizjes nga paragrafi 2 i këtij neni për gjysmë është më e vogël se sa e lejuar për atë rrugë ose pjesën e saj, shoferi i atij mjeti duhet ti ndez të gjithë treguesit e drejtimit, përveç nëse e shfrytëzon dritën vezulluese rrotulluese.

54.4. Shpejtësia e lëvizjes së mjetit në rrugë publike gjatë kushteve normale të komunikacionit nuk lejohet të kufizohet nën 40 km/h nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

54.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 55

55.1. Shoferi detyrohet:

- a) të ngas mjetin me shpejtësi që nuk pengon lëvizjen e mjeteve të tjera;
- b) të mbaj distancë të nevojshme në mes mjetit përpara që është e nevojshme për t'iu shmangur goditjes së mjetit nëse frenon apo ndalet;
- c) që mos të rrisë vrullshëm shpejtësinë, përkatësisht të niset nga vendi, duke arritur me te kufirin e lejueshëm të numrit të rrotullimit të motorit ose në mënyrë të tillë që vjen deri te rrëshqitja e rrotave;
- d) të mos bëjë gara shpejtësie;
- e) të mos frenoj vrullshëm përveç në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe atë duke i paralajmëruar me sinjalizimin e dritave të frenimit dhe me gjithë treguesit e drejtimit ose duke dhënë shenjën përkatëse me dorë.

55.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me pikat a), b) dhe e) të paragrafit 1 të këtij neni.

55.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me pikën c) të paragrafit 1 të këtij neni dhe i shqiptohet një pikë negative.

55.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 deri 400 € shoferi që vepron në kundërshtim me pikën d) të paragrafit 1 të këtij neni si dhe i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit e mjetit motorik prej gjashtë muaj deri një vit dhe tri pikë negative.

## Neni 56

56.1. Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonave të banuara është 50 km/h, në qoftë se me shenja të komunikacionit nuk është e përcaktuar ndryshe.

56.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 €, shoferi që me mjet brenda zonave të banuara lëvizë me shpejtësi dy fish më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit. Nëse në këtë rast tejkalohet shpejtësia prej 100 km/h, të njëjtit, përveç gjobës, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të drejtuarit të mjetit me veprim motorik prej tre muaj deri në një vit dhe i shqiptohen tri (3) pikë negative.

56.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 270 €, shoferi që me mjet brenda zonave të banuara lëvizë me shpejtësi mbi 50 km/h më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri gjashtë muaj dhe i shqiptohen dy (2) pikë negative.

56.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 € shoferi që me mjet lëvizë brenda zonave të banuara me shpejtësi prej 30 deri 50 km/h më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit dhe i shqiptohet një (1) pikë negative.

56.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i cili me mjet lëvizë brenda vendbanimit me shpejtësi prej 10 deri 30 km/h më e madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit.

56.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që me mjet lëvizë brenda vendbanimit me shpejtësi deri 10 km/h më e madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit.

## Neni 57

57.1. Në rrugë jashtë zonave të banuara shoferit nuk i lejohet me mjet të lëvizë me shpejtësi më të madhe se është e caktuar me shenjë të komunikacionit, e më së shumti:

- a) në autostradë - 130 km/orë;
- b) në rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike - 110 km/orë;
- c) në rrugë të shpejtë - 100 km/orë;
- d) në rrugë të tjera - 80 km/orë.

57.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi që me mjet jashtë zonave të banuara lëvizë me shpejtësi mbi 50 km/h më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit dhe i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe dy (2) pikë negative.

57.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi që me mjet jashtë zonave të banimit lëvizë me shpejtësi prej 30 deri 50 km/h më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit dhe i shqiptohen një (1) pikë negative.

57.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që me mjet lëvizë jashtë vendbanimit me shpejtësi prej 10 deri 30 km/h më të madhe se sa është e lejuar ose e përcaktuar me shenjë të komunikacionit.

## Neni 58

58.1. Shpejtësia e lëvizjes së mjeteve në rrugë kufizohet:

- a) në 80 km/h, për mjetet e transportit me masën më të madhe të lejuar deri 7500 kg, për autobusë, për autobusë me rimorkio të lehtë dhe për mjetet motorike të cilat tërheqin rimorkio për banim (kamp - shtëpizën);
- b) në 70 km/h për autobusë kur kryhet transportimi i organizuar i fëmijëve, për autobusët nyjor, pa vend qëndrim në këmbë, për mjetet e transportit me masën maksimale të lejuar mbi 7500 kg, për mjete e transportit me mjete bashkangjitime dhe për mjetet të cilat transportojnë materie të rrezikshme;
- c) në 50 km/h për autobus me rimorkio për transportimin e njerëzve, për autobusë urban, për autobusë të cilët përpos ulëseve të montuara, ka vende për qëndrim në këmbë dhe mjetet e transportit të cilat kryejnë transportin grupor të njerëzve;
- d) në 40 /h, për mjetin i cili e tërheq mjetin tjetër të prishur, traktori dhe motoçikletë (përfshirë edhe rimorkion anësore) dhe çiklomotor që përdoret për transportim të fëmijëve deri në moshën 7 vjeçare;
- e) në 30 km/h për mjetet më mekanizma të qitura përpara më shumë se 1.5 m, e matur prej ulëses së shoferit (në 30 km/orë brenda zonave të banuara, përkatësisht në 60 km/orë jashtë zonave të banuara).

58.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në autostradë, rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike dhe rrugë të shpejtë shpejtësia për këto mjete kufizohet:

- a) në 100 km /h për autobusë me masën më të madhe të lejuar mbi 12000 kg, përveç autobusëve të cilët transportojnë grupe të organizuar fëmijësh,
- b) në 85 km /h për mjetet e transportit me masën më të madhe të lejuar mbi 12000 kg, përveç mjeteve të cilat transportojnë materie të rrezikshme,
- c) në 80 km/h për mjetet e transportit me mjetet bashkangjitime.

58.3. Kur drejtohet mjeti nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni shoferët detyrohen t'iu përmbahen shpejtësisë së lëvizjes sipas rregullave 1 dhe 2 edhe në rrugë në të cilën me këtë ligj ose me shenjë të komunikacionit është lejuar shpejtësia më e madhe.

58.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që me mjet lëvizë jashtë zonave të banuara me shpejtësi prej 10 km/h më të madhe se sa limitin e kategorisë së shpejtësisë së mjetit ose të përcaktuar me shenjë të komunikacionit.

58.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 € shoferi që me mjet lëvizë jashtë zonave të banuara me shpejtësi deri në 10km/h më të madhe se sa limitin e kategorisë së shpejtësisë së mjetit ose të përcaktuar me shenjë të komunikacionit.

## Neni 59

59.1. Në përjashtim nga paragrafi 1 i neni 56 të këtij ligji, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ose Kuvendet Komunale, mund të zvogëlojë ose rrisë shpejtësinë e kufizuar brenda zonave të banuar me anë të shenjave përkatëse të komunikacionit.

59.2. Shpejtësia më e madhe e lejuar e përmendur në paragrafin 1 mund të:

- a) zvogëlohet, nëse kushtet e sigurisë mungojnë në rrugën e caktuar ose në një segment të saj;
- b) rritet, nëse kushtet e komunikacionit në rrugën e caktuar ose në një segment të saj shtojnë sigurinë në komunikacion, por vetëm deri në 80 km/h;

59.3. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ose Kuvendet Komunale, me anë të shenjave përkatëse të komunikacionit mund të zvogëloj shpejtësinë e kufizuar jashtë zonave të banuara, nëse kushtet e komunikacionit në rrugë ose në një segment të saj e arsyetojnë këtë.

## 6. KTHIMI

### Neni 60

60.1. Shoferi i mjetit që kthehet djathtas duhet të bëjë kthimin duke lëvizur nëpër shiritin e skajshëm të komunikacionit që shtrihet përgjatë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës përveç në qoftë se më shenjën e komunikacionit në rrugë nuk është caktuar ndryshe.

60.2. Shoferi i mjetit që kthehet majtas duhet të bëjë kthimin nëpër shiritin e majtë të skajshëm të komunikacionit që shtrihet pranë vijës së mesit dhe nëpër harkun e paramenduar ose të shënuar që lidhë dy vijat e mesit të sipërfaqeve anësore të rrugës, përkatësisht nëpër shiritin e komunikacionit që shtrihet përgjatë skajit të majtë të rrugës në komunikacion me rrugë një kahe, përveç në qoftë se më shenjën e komunikacionit në rrugë nuk është caktuar ndryshe.

60.3. Rregulla në paragrafin 1 dhe 2 nuk zbatohet, nëse dimensionet e mjetit nuk lejojnë kthimin sipas kësaj rregulle.

60.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 7. LËSHIMI I MJETEVE DHE PËRPARËSIA E KALIMIT

### Neni 61

61.1. Shoferi i mjetit gjatë afrimit të një kryqëzimi, me rëndësi të njëjtë kur nuk është i rregulluar me shenja të komunikacionit duhet të ketë kujdes të veçantë dhe t'i japë përparësi mjetit që vjen nga krahu i tij i djathtë.

61.2. Shoferi i mjetit i cili në kryqëzim kthehet në të majtë është i obliguar ti jep përparësi mjetit, i cili duke duke ardhur nga krahu i kundërt në kryqëzim, lëvizë drejtë ose kthehet në të djathtë, përveç në qoftë se me shenjat e komunikacionit nuk është përcaktuar ndryshe.

61.3. Rregulla e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohet ndaj mjetit i cili lëvizë nëpër binarë, që ka përparësi në kryqëzim ose kur takohen me mjetet tjera, pa marrë para sysh nga cila anë vijnë ato, përveç në rastet kur me shenja nuk është caktuar ndryshe.

61.4. Në kryqëzim të parregulluar me shenja të komunikacionit, e që nuk është në të njëjtin nivel, të drejtën e kalimit e ka automjeti i cili lëviz nëpër rrugën në nivel më të ulët.

61.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 62

62.1. Ngasësi i automjetit që kthehet në rrugën e dedikuar si rrugë me përparësi kalimi është i obliguar t'i jep përparësi kalimi të gjitha automjeteve të cilat qarkullojnë në këtë rrugë .

62.2. Shoferi i mjetit i cili kyçet në rrugë nga sipërfaqet ku nuk zhvillohet komunikacioni publik (rrugë e dheut, oborr, depo, fabrikë, e të ngjashme), duhet ti jap përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin nëpër rrugën ku ai kyçet edhe atëherë kur kjo rrugë nuk është e sinjalizuar si rrugë me përparësi kalimi.

62.3. I ndalohet shoferit të mjetit të hyj në kryqëzim, nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme në anën tjetër pas kryqëzimit, për të vazhduar me lëvizjen e mjetit.

62.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 shoferi që me mjet vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

62.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

## Neni 63

63.1. Shoferi i mjetit i cili i afrohet vendkalimit të caktuar për çiklistë, duhet të ketë kujdes të veçantë dhe ti jap përparësi çiklistit i cili gjendet në vendkalim.

63.2. Shoferi i mjetit i cili me rastin e kthimit të mjetit e pret shtegun ose shiritin për biçikleta, duhet t'iu jap përparësi kalimi mjeteve që lëvizin nëpër shiritin ose shtegun për biçikleta.

63.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € dënohet shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 8. KOMUNIKACIONI NË KRYQËZIM

### Neni 64

64.1. Shoferi i mjetit kur i ofrohet kryqëzimit duhet të lëvizë me një kujdes të shtuar që tu përshtatet kushteve të komunikacionit në kryqëzim.

64.2. Shoferi i mjetit kur i ofrohet kryqëzimit është i obliguar të lëvizë me një shpejtësi të tillë që të mund të ndalët dhe ti lëshoj pjesëmarrësit e komunikacionit të cilat kanë përparësi kalimi në kryqëzim.

64.3. Shoferi i mjetit në largësi të mjaftueshme para kryqëzimit është i obliguar të marrë drejtimin me mjet, në atë shirit të komunikacionit nëpër të cilin duhet ta lëshoj kryqëzimin.

64.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që në mjet vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 65

65.1. Në kryqëzim ose në ndonjë vend tjetër ku rregullohet komunikacioni me shenja ndriçuese të komunikacionit (në tekstin e tutje semaforët) dritat e komunikacionit për pjesëmarrësit në komunikacion kanë këtë kuptim:

- a) drita e kuqe, ndalim kalimi;
- b) drita e gjelbër, kalimin e lirë;
- c) drita e verdhë, e ndezur vetëm pa ndërprerje, do të thotë që mjeteve nuk i lejohet ta kalojnë vijën e ndaljes edhe të hyjnë në kryqëzim, nëse në momentin e ndezjes së dritës së verdhë, gjendet në atë largësi nga shenja ndriçuese e komunikacionit që mundet në mënyrë të sigurt të ndalet;
- d) në semafor drita me ngjyrë të kuqe dhe gjelbër nuk mund të ndizen në të njëjtën kohë, ndërsa drita e verdhë e vetme pa ndërprerje prej kalimit të dritës së gjelbër në atë të kuqe mund të ndizen së bashku, para se të paraqitet drita e gjelbër;
- e) drita me ngjyrë gjelbër vezulluese paralajmëron ndërprerjen e shpejtë të kalimit të lirë, përkatësisht paraqitjen e ngjyrës së verdhë pastaj të kuqe;
- f) drita me ngjyrë të verdhë vezulluese shërben për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit në komunikacion të lëvizin me kujdes të shtuar.

65.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që me mjet në vendin ku komunikacioni rregullohet me semaforë nuk ndalet në shenjën e dritës së kuqe dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohë zgjatje prej dy deri gjashtë muaj si dhe dy pikë negative.

#### Neni 66

66.1. Nëse semaforit në kryqëzim i është shtuar një dritë plotësuese ose disa drita plotësuese në formë shigjete, gjatë kohës derisa ato drita janë të ndezura, shoferi mundet me mjet të kaloj në drejtim të shigjetave edhe gjatë kohës derisa është e ndezur drita e kuqe ose e verdhë, por duhet ti lëshoj mjetet të cilat lëvizin në rrugë ku ai është duke hyrë dhe këmbësorët të cilët e kalojnë atë rrugë.

66.2. Nëse drita e gjelbër në semafor e ka formën e shigjetave, shoferit me mjet i lejohet lëvizja vetëm në drejtime të shigjetave.

66.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohë zgjatje prej dy deri gjashtë muaj dhe i shqiptohen dy pikë negative.

#### Neni 67

67.1. Shoferit me mjet nuk i lejohet hyrja në kryqëzim nëse dendësia e komunikacionit është e tillë që ai me mjet nëse do të ndalet në kryqëzim ose në vendkalimin e këmbësorëve do ta pengoj ose pa mundësoj komunikacionin e mjeteve të cilat vijnë nga anët anësore të rrugës ose komunikacionin e këmbësorëve.

67.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që me mjet vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### 9. PËRBALLKALIMI

#### Neni 68

Shoferi obligohet gjatë përball-kalimit, të mbaj distancë të sigurt anësore në mes mjetit të tij dhe mjetit ose pjesëmarrësit tjetër në komunikacion, që është duke përball-kaluar dhe



nëse është e nevojshme të shmanget në anën e djathtë të rrugës ose të ndalet për të mundësuar përball-kalimin e sigurt.

#### Neni 69

69.1. Kur përball-kalimi i mjeteve është i pamundur si pasojë e punimeve në rrugë, mjetit të ndaluar ose ndonjë pengese tjetër në rrugë, shoferi i mjetit i cili pengesën e ka në kahun e tij të lëvizjes, duhet ndalet për ti dhënë përparësi kalimi mjetit që vjen nga kahu e kundërt e rrugës.

69.2. Kur në kryqëzim mjetet vijnë nga kahet e kundërta dhe kthehen majtas, ato përball-kalohen në atë mënyrë që lëshohen me përparësi kalimi mjetet që vijnë nga ana e vet e djathtë.

69.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 70

70.1. Në rrugë me pjerrtësi të madhe gjatësore ku përball-kalimi me mjetet tjera është i vështirë ose i pamundur, shoferi i mjetit që lëvizë teposhtëze duhet të ndalet dhe të pozicionohet sa më afër skajit të rrugës dhe ti mundësojë përballë-kalimin mjetit i cili lëvizë në përprjetëze.

70.2. Shoferi i mjetit i cili lëvizë në përprjetës duhet ta ndal mjetin e vet në rast se para vetes ka vend të përshatshëm për ndalim, për ta mundësuar përball kalimin e sigurt.

70.3. Në rrugë me pjerrtësi gjatësore, në të cilën përball-kalimi është i vështirësuar ose i pamundur e njeri nga mjetet duhet të lëvizë mbrapa, këtë do ta bëjë:

- a) çdo mjet i cili takohet me mjetin që tërheq mjetin bashkangjites;
- b) mjeti i lehtë i cili takohet me mjetin e kategorisë më të lartë;
- c) mjeti transportues i cili takohet me autobusin;
- d) në qoftë se mjetet janë të një kategorie, mjeti i cili lëvizë në teposhtëze.

70.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 10. TEJKALIMI DHE ANASHKALIMI

#### Neni 71

71.1. Shoferi, para fillimit të tejkalimit obligohet të sigurohet se:

- a) ekziston dukshmëri adekuate dhe hapësirë e mjaftueshme që të bëjë veprimin e tejkalimit pa penguar dhe rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor;
- b) shoferi i mjetit që lëviz mbrapa tij, nuk e ka filluar veprimin e vetë të tejkalimit;
- c) shoferi përpara në të njëjtin shirit të komunikacionit nuk ka sinjalizuar tendencën që të tejkaloj ndonjë mjet tjetër, të ndryshoj drejtimin e lëvizjes apo shiritin e komunikacionit;
- d) që rruga të ketë hapësirë të mjaftueshme për realizimin e plotë të tejkalimit, duke pasur parasysh diferencën ndërmjet shpejtësisë së tij dhe të mjetit që do të tejkalohej si dhe distancën dhe shpejtësinë ndaj mjeteve që vijnë nga krahu i kundërt;
- e) vetit teknike të mjetit me të cilin bën tejkalimin janë në gjendje të rregullt;

- f) pas tejkalimit ti shmanget manovrimeve të rrezikshme dhe të kthehet në shiritin e komunikacionit që ka lëvizur para se ta filloj tejkalimin sa më parë që të jetë e mundur pa e penguar ose rrezikuar mjetin të cilin e tejkalon;
- g) pas tejkalimit të dy mjeteve që pa i penguar ose rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, të zërë pozitën në shiritin e komunikacionit nëpër të cilin ka lëvizur para tejkalimit përkatësisht anashkalimit.

71.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 72

72.1. Shoferi i mjetit gjatë tejkalimit ose anashkalimit duhet të ushtroj kujdes të veçantë dhe të mbaj distancë të sigurt anësore posaçërisht ndaj mjetit që e tejkalon ose ndaj një pjesëmarrësi tjetër në komunikacion.

72.2. Në rast të tejkalimit të mjetit dy-rrotash ose kolone të këmbësorëve, distanca anësore e sigurisë nuk duhet të jetë më e vogël se 1 m.

72.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 73

73.1 Tejkalimi dhe anashkalimi bëhet në anën e majtë, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj ose me shenjat e komunikacionit.

73.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe dy pikë negative.

#### Neni 74

74.1. Tejkalimi duhet të bëhet në anën e djathtë po që se mjete në rrugë ka zënë një pozitë të tillë dhe që shoferi i tij jep sinjalin për kthim në anën e majtë.

74.2. Mjeti i cili lëvizë nëpër binarët e vendosur në mes të rrugës nuk lejohet të tejkalohej nga ana e majtë, mjeti mund të tejkalohej nga ana e djathtë në qoftë se midis këtij mjeti dhe skajit të djathtë të rrugës ekziston shiriti i komunikacionit.

74.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri tre muaj dhe dy pikë negative.

#### Neni 75

75.1. Në qoftë se në mesin e rrugës ndodhet ishulli për këmbësor, është e shënuar hapësira për parkimin e mjeteve, ndonjë sipërfaqe tjetër që nuk është e destinuar për komunikacionin e mjeteve, ndonjë objekt ose mekanizëm tjetër, shoferi i mjetit duhet të anashkalojë nga ana e djathtë.

75.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një (1) pikë negative.

## Neni 76

76.1. Në qoftë se sipërfaqet, objektet dhe mekanizmat nga paragrafi 1 i nenit 75, ndodhen në mes të rrugës njëkahëshe, shoferi i mjetit mund të anashkaloj nga ana e djathtë ose e majtë, në qoftë se me shenja të komunikacionit nuk është përcaktuar ndryshe.

76.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 77

77.1. Shoferit të cilit i është dhënë sinjali për tejkalim nga krahu i tij i majtë duhet të largojë mjetin e tij kah skaji i djathtë i rrugës dhe nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë gjatë kohës gjersa tejkalohe.

77.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një (1) pikë negative.

## Neni 78

78.1. Shoferi i mjetit që lëvizë ngadalë duhet të tërhiqet në maksimum në anën e djathtë dhe nëse është e nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur, të ndalet në qoftë se prapa tij formohet kolona më tepër se 5 mjete, në mënyrë që të lehtësoj lëvizjen e mjeteve të shpejta, kur për një gjë të tillë ka mundësi.

78.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 79

79.1. Shoferi i mjetit që tejkalon mjetin në të cilin bëhet aftësimi i kandidatëve për shofer apo lëvizë pas tij, duhet të ketë kujdes të shtuar.

79.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 80

80.1. Ndalohet tejkalimi:

- a) kur me shenja të komunikacionit (sinjalizimi vertikal dhe horizontal) është në mënyrë të prerë i ndaluar;
- b) drejtpërdrejt para ose në kryqëzim i cili nuk është me rreth - rrotullim të komunikacionit, përveç biçikletës, çiklomotorit dhe motoçikletës pa rimorkio anësore;
- c) drejtpërdrejt para dhe në vendkalim të rrugës mbi binar hekurudhor ose binar të tramvajit në nivel.

80.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit e mjetit me veprim motorik prej tre deri në gjashtë muaj si dhe dy pikë negative.

## Neni 81

81.1. Ndalohet tejkalimi:

- a) drejtpërdrejt para dhe në vendkalimin e këmbësorëve, me përjashtim në vendkalimin e këmbësorëve ku komunikacioni rregullohet nga semaforët apo personat e autorizuar;
- b) i mjetit i cili është duke lëvizur në drejtimin e njëjtë por ndalet në mënyrë që ti jap përparësi këmbësorit;
- c) drejtpërdrejtë para dhe në vendkalimin e çiklistëve;
- d) më shumë se dy mjete, të cilat nuk përbëjnë një kolonë në kuptimin e këtij ligji;
- e) kolonës së mjeteve;
- f) në shiritin për nxitim, ngadalësim dhe ndalje emergjente.

81.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit të mjetit me veprim motorik prej tre deri gjashtë muaj dhe dy pikë negative.

## Neni 82

82.1. Ndalohet tejkalimi i mjetit që sinjalizon tendencën e tij që të kthehet djathtas, nëse gjatë tejkalimit kalon në shiritin për mjetet e kahes së kundërt.

82.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit për drejtimin e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një pikë negative.

## Neni 83

83.1. Në rrugë me dy shirita të komunikacionit shoferit nuk i lejohet të tejkaloj mjetin tjetër:

- a) ku dukshmëria e rrugës është e kufizuar;
- b) përpara fillimit të vijës së bardhë të plotë të shënuar me sinjalizim horizontal;
- c) në kthesë të rrugës ku dukshmëria është e kufizuar.

83.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit e të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe dy pikë negative.

## Neni 84

Përjashtimisht nga neni 83 i këtij ligji, lejohet tejkalimi në rrugë nëse ekzistojnë dy ose më tepër shirita të komunikacionit të shënuar me sinjalizim horizontal, dedikuar posaçërisht për lëvizjen e mjeteve në kahe të lëvizjes së mjetit i cili bën tejkalimin.

## Neni 85

85.1. Drejtpërdrejtë para dhe në kryqëzim shoferit i lejohet të tejkaloj mjetin:

- a) i cili lëvizë në rrugë me përparësi kalimi;
- b) në kryqëzim i cili rregullohet me semafor ose nga personi i autorizuar.

85.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe i shqiptohet masa e ndalimit për drejtimin e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një (1) pikë negative.

## Neni 86

86.1. Në rrugë me vijë të bardhë të plotë gjatësore lejohet tejkalimi nëse nuk kalohet vija e plotë dhe nuk rrezikohet mjete i cili tejkalohe.

86.2. Ndalohet tejkalimi i mjeteve me përparësi kalimi dhe nën përcjellje kur janë në kryerjen e detyrës.

86.3. Lejohet tejkalimi i mjeteve të cilat nuk mund të zhvillojnë shpejtësi me të madhe se 30 km/h në rrugë të rrafshet dhe të mjeteve të cilat nuk konsiderohen mjete motorike në vije të plotë gjatësore edhe në rastet e ndaluara me shenjë të komunikacionit me kusht që nuk rrezikon dhe pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

86.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit për drejtimin e mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një (1) pikë negative.

## Neni 87

87.1. Në rrugë, në të cilën ekzistojnë të paktën dy shirita të komunikacionit të destinuar për komunikacionin e mjeteve në kahe të njëjtë dhe në të cilën ndodhet kolona e mjeteve, shoferit nuk i lejohet me mjet të kalojë nga një shirit në një shirit tjetër, kurse shoferi mund ta lëshojë shiritin në të cilin ndodhet vetëm për tu kthyer në anën e majtë ose në të djathtë apo për parkimin e mjetit.

87.2. Në rrugët brenda zonës së banuar sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni, lëvizja më e shpejtë e mjetit në një shirit se sa në shiritin tjetër si dhe kalimi pranë mjetit që lëviz ngadalë e që nuk e shfrytëzon shiritin e djathtë të skajshëm të komunikacionit, nuk konsiderohet tejkalim.

87.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 11. SINJALET PARALAJMRUESE TË DRITES DHE ZËRIT

### Neni 88

Shoferi i mjetit duhet të jap sinjale zëri apo drite kur është e domosdoshme për të paralajmëruar pjesëmarrësit tjerë mbi rrezikun në rrugë.

### Neni 89

Ndalohet:

- a) të keqpërdoren sinjalet e zërit dhe dritës;
- b) të jepen sinjale zëri brenda zonës së banuar, përveç në rast rreziku të drejtpërdrejt;
- c) të paralajmërosh pjesëmarrësit e tjerë të komunikacionit nën kushtet kur shoferët tjerë do të ekspozohen dritës verbuese.

## Neni 90

Shoferi obligohet që të përdorë shenjat paralajmëruese të zërit kur kërkon nevoja e sigurisë së komunikacionit sidomos:

- a) në rrugë jashtë zonave të banuara për të paralajmëruar pjesëmarrësin tjetër në komunikacion, që dëshiron të tejkaloi ose anashkaloi, kur mosdhënia e këtij sinjali do të rrezikonte shkaktimin e aksidentit në komunikacion;
- b) në qoftë se pranë rrugës gjenden fëmijët të cilët nuk i kushtojnë vëmendjen komunikacionit të mjeteve;
- c) në rrugë jashtë zonave të banuara, para hyrjes në kthesa të padukshme dhe të ngushtuara ose para arritjes në kurriz, në të cilat është vështirësuar përball-kalimi.

## Neni 91

91.1. Prej muzgut të parë deri në agimin e plotë, shoferi i mjetit si rregull përdor në vend të sinjalit të zërit për paralajmërim, sinjalin e paralajmërimit me dritë. Këtë sinjal shoferi i mjetit mund ta përdorë edhe në zonën e banuar gjatë tejkalimit të mjetit tjetër.

91.2. Sinjalin e paralajmërimit me drita shoferi i mjetit mund ta përdor edhe ditën në qoftë se mënyra e tillë e paralajmërimit i përshtatet më mirë rrethanave në rrugë.

91.3. Sinjali i paralajmërimit me dritë jepet duke ndezur në intervale të shkurtra të njëpasnjëshme dritat e gjata, duke ndezur në mënyrë të njëpasnjëshme dritat e shkurtra për ndriçimin e rrugës ose duke ndezur në mënyrë alternative, në intervale të shkurtra dritat e gjata dhe dritat e shkurtra.

91.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 88 deri te neni 91 të këtij ligji.

## 12. NDALJA DHE PARKIMI

### Neni 92

92.1. Ndalja dhe parkimi i mjetit lejohet vetëm në vendet ku mjete është i dukshëm nga një distancë e mjaftueshme për shoferët e tjerë dhe nuk pengon apo rrezikon komunikacionin rrugor.

92.2. Shoferi i mjetit i cili ndal ose parkon mjetin në rrugën publike është i detyruar ta ndalë, përkatësisht ta parkojë atë më pranë cepit të djathtë të sipërfaqes së rrugës.

92.3. Në rrugë, në vende, përkatësisht në hapësira të destinuara për ndalje dhe parkim, edhe në sipërfaqet e ndërtuara të komunikacionit të parapara për lëvizjen e këmbësoreve, nuk lejohet lënia e mjeteve të cilat nuk përdoren në komunikacion (të papërdorura, të pa regjistruara ose të ngjashme) ose mjetet bashkangjitëse të cilat shfrytëzohen vetëm përkohësisht (rimorkio e lehtë ose kamp-shtëpiza ose të ngjashme), sendet, materialet e të ngjashme të cilat pengojnë rrjedhën normale të komunikacionit apo e ndotin ambientin.

92.4. Shoferi i mjetit duhet të përdor mënyrën e ndaljes së mjetit, siç tregohet me sinjalizim horizontal dhe vertikal.

92.5. Shoferi i mjetit kur e ndal mjetin duhet të siguroj atë në mënyrë që të mos ketë mundësi të keqpërdoret nga personat e pa autorizuar dhe të merr të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të shmang ndonjë aksident.

92.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1, 2, 4 dhe 5 të këtij neni.

92.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

#### Neni 93

93.1. Me rastin e ndaljes ose parkimit të mjetit në rrugë jashtë zonave të banuara, mjete duhet të ndalet ose parkohet jashtë rrugës.

93.2. Shoferi i cili për shkak të defektit në mjet, aksidentit të komunikacionit ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm ka qenë i detyruar ta ndal mjetin në rrugë, detyrohet ti marr të gjitha masat që mjeti i ndalur në rrugë mos të pengon ose rrezikon komunikacionin dhe menjëherë ta largon nga rruga.

93.3. Shoferi i cili për shkak të defektit në mjet, aksidentit në komunikacion ose për ndonjë arsye tjetër ka qenë i detyruar ta ndal mjetin mbi binar, detyrohet menjëherë ta largon atë nga binaret, nëse një gjë e tillë nuk është e mundshme, atëherë duhet ti marrë të gjitha masat që personi i cili drejton mjetin mbi binar të lajmërohet me kohë.

93.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që ndal ose parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 94

94.1. Para fillimit të ngasjes, shoferi duhet ti mbyll dhe ti përforcon të gjitha pjesët lëvizëse të mjetit si dhe dyert, të vërteton që pajisjet për kyçje dhe shkyçje të mjetit bashkangjitime janë në mënyrë të rregullt të vendosura.

94.2. Në mjetin e ndalur ose të parkuar nuk lejohet hapja e dyerve, nëse me këtë do të pengohej lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion ose do të rrezikohet siguria në komunikacion.

94.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 95

95.1. Lejohet ndalja ose parkimi i mjetit në trotuar, me dy rrotat anësore apo me rrotat e një boshti të mjeteve me masë të përgjithshme deri 3.5 tona, me kusht që:

- a) në segmentin e caktuar rrugor ndalja apo parkimi nuk ndalohet;
- b) gjerësia e trotuarit që mbetet në dispozicion të këmbësorëve është e tillë që nuk e pengon lëvizjen e këmbësorëve dhe nuk është më e vogël se 1.5 metra;
- c) mjeti të cilit boshti i përpamë vendoset në trotuar dhe nuk pengon komunikacionin rrugor.

95.2. Sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndalja dhe parkimi lejohet në trotuar afër skajit të rrugës e komplet veturës, motoçikletës, çiklomotorit, biçikletës apo mjetit me masë më të madhe të lejuar që nuk tejkalon 3500 kg, por vetëm në vendin e shënuar me sinjalizim horizontal.

95.3. Shoferi mundë ta parkoj mjetin e vetë në vendet që ndodhen në mes të sipërfaqes së rrugës, vetëm kur këto vende janë të shënuara me sinjalizim vertikal ose horizontal.

95.4. Nëse pran skajit të djathtë gjinden binaret e tramvajit ose binaret e trenit, shoferi mund ta ndal ose parkon mjetin në anën e majtë të rrugës.

95.5. Në rrugë një kahëshe shoferi mund ta parkojë mjetin në dy anët e rrugës, nëse me rregullat ose me shenjat e komunikacionit nuk përcaktohet ndryshe.

95.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që e ndalë ose parkon mjetin në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 96

96.1. Ndalohet ndalja ose parkimi i mjetit:

- a) në kthesa të padukshme, në afërsi kurrizi dhe në rrugët kryesore jashtë vendbanimit;
- b) në tunel, në nënkalime, në mbi kalime, nën urë dhe mbi urë dhe në distancë më të vogël se 15 metra nga tuneli, nënkalime dhe në mbi kalime, nën urë dhe mbi urë;
- c) mbi binarët e tramvajit ose të hekurudhës, në të njëjtin nivel me rrugë dhe në afërsi nëse pengohet lëvizja e mjetit mbi binar;
- d) në kryqëzim dhe në largësi më të vogël se pesë metra nga skaji më i afërt i rrugës tërthore;
- e) në shtegun për biçikleta;
- f) shiritin për biçikleta;
- g) në vendkalimin e këmbësorëve, në vendkalimin e biçikletave dhe brenda distancës më të vogël se pesë metra para vendkalimit të tillë;
- h) në rrugë, përgjatë vijës së bardhë të plotë dhe në afërsi të pikave të përfundimit të tyre, nëse kjo do të detyronte shoferët tjerë që ngasin mjetin ose bashkësinë e mjeteve mbi atë vijë;
- i) në distancë më të vogël se 10 metra nga ana e përparme e shenjës apo sinjalit të komunikacionit, nëse këto do të mbuloheshin nga mjeti;
- j) në skajin e anës së majtë të rrugës me përjashtim të ndaljes apo parkimit brenda një zone të banuar, në rrugë një kahore dhe nenit 95 paragrafit 4 të këtij Ligji;
- k) në brezin ndarës ndërmjet shiritave rrugor;
- l) në vendet e rezervuara për parkim të mjetit për personin me invaliditet;
- m) në trotuar;
- n) përjashtimisht nga paragrafi 1 pika m) të këtij neni, lejohet ndalja nëse për lëvizjen e këmbësorëve, është lënë sipërfaqe së paku 1,5 metra dhe e njëjta nuk mund të jetë pran skajit të djathtë. Në këtë rast mjeti mund të parkohet nëse është e lejuar me shenjë të komunikacionit;
- o) në pjesën e rrugës ku gjerësia e kalimit të lirë prej mjetit të ndalur ose të parkuar deri te vija e plotë gjatësore e mesit e shënuar në rrugë do të ishte më e vogël se tre metra përkatësisht deri te skaji tjetër i rrugës më e vogël se katër metra.



96.2. Në zonën e TMK-së ndalohet ndalja dhe parkimi i automjeteve pa autorizim të veçantë nga TMK-ja.

96.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që ndal ose parkon mjetin në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

#### Neni 97

97.1. Ndalohet parkimi i mjeteve:

- a) në vendin ku ekziston hyrja apo dalja nga garazhi, porta, parkingu dhe ku mund të pengoj komunikacionin;
- b) në vendin ku qasja e mjetit tjetër të parkuar apo dalja e këtij mjeti do të mund të pengohet;
- c) në pjesën e rrugës para kalimit të rrugës në nivel me vijën hekurudhore ose me vijën e tramvajit në një largësi më të vogël se 15 m nga këto kalime;
- d) brenda zonës së banuar, mjeti apo bashkësia e mjeteve me masë të përgjithshme më shumë se 7,5 tona apo me gjatësi që tejkalon 12 metra, jashtë vendit të shënuar për parking të destinuar për këto mjete;
- e) brenda distancës më të vogël se 15 metra para ose mbrapa shenjës së komunikacionit “vend ndalja e autobusit”;
- f) në vend ndalje ose sipërfaqe të zgjeruar jashtë shiritit të komunikacionit të mjeteve të cilat kryejnë transportin publik të udhëtarëve të cilat janë të shënuar me shenja përkatëse të komunikacionit.

97.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që parkon mjetin në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

#### Neni 98

Ndalimi i ndaljes ose parkimit të mjetit motorik nuk zbatohet në situatën ku ndalja e mjetit bëhet si rrjedhojë e rregullave të komunikacionit.

#### Neni 99

99.1. Pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës ose personat e tjerë të autorizuar me ligj urdhërojnë që mjeti të zhvendoset në ndonjë vend tjetër nëse është i ndalur ose i parkuar në rrugë, ku rrezikohet siguria e komunikacionit ose pengohet rrjedha normale e komunikacionit, si:

- a) në kthesa të padukshme, në afërsi kurrizi dhe në rrugët kryesore jashtë vendbanimit;
- b) në tunel, në nënkalime dhe në mbi kalime, nën urë dhe mbi urë dhe në distancë më të vogël se 15 metra nga tuneli, nënkalime dhe në mbi kalime, nën urë dhe mbi urë;
- c) mbi binarët e tramvajit ose të hekurudhës, në të njëjtin nivel me rrugë dhe në afërsi nëse pengohet lëvizja e mjetit mbi binar;
- d) në kryqëzim dhe në largësi më të vogël se pesë metra nga skaji më i afërt i rrugës tërthore;
- e) në shtegun për biçikleta;
- f) shiritin për biçikleta;
- g) në vendkalimin e këmbësorëve, në vendkalimin e biçikletave dhe brenda distancës më të vogël se pesë metra para vendkalimit të tillë;

- h) në rrugë, përgjatë vijës së bardhë të plotë dhe në afërsi të pikave të përfundimit të tyre, nëse kjo do të detyronte shoferët e tjerë që ngasin mjetin ose bashkësinë e mjeteve mbi atë vijë;
- i) në distancë më të vogël se 10 metra nga ana e përparme e shenjës apo sinjalit të komunikacionit, nëse këto do të mbuloheshin nga mjete;
- j) në skajin e anës së majtë të rrugës me përjashtim të ndaljes apo parkimit brenda zonës së banuar sipas nenit 95 paragrafit 4 të këtij Ligji;
- k) në brezin ndarës ndërmjet shiritave rrugor;
- l) në vendet e rezervuara për parkim të mjetit për personin me invaliditet;
- m) në trotuar nëse nuk lehet sipërfaqja e lirë për lëvizjen e këmbësorëve së paku 1,5 metra;
- n) në pjesën e rrugës ku gjerësia e kalimit të lirë prej mjetit të ndalur ose të parkuar deri te vija e plotë gjatësore e mesit e shënuar në rrugë ose ndonjë pengesë tjetër do të ishte më e vogël se tre metra përkatësisht deri te skaji i tjetër i rrugës, më e vogël se katër metra.

99.2. Mjetet të cilat janë ndalur ose parkuar kundër rregullave në vendin nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të bllokohen por duhen të largohen nga vendi.

99.3. Para se të jep urdhëresën për zhvendosjen e mjetit sipas paragrafit 1 të këtij neni, pozita e mjetit të ndalur ose parkuar në mënyrë jo të rregullt dëshmohet me fotografi ose me skicë.

#### Neni 100

100.1. Zbatimin e urdhëresës për zhvendosjen e mjetit nga neni 99, paragrafi 1 i këtij ligji e bënë Shërbimi Policor i Kosovës.

100.2. Shërbimi Policor i Kosovës e bënë zhvendosjen e mjeteve të cilat janë ndalur ose parkuar në kundërshtim me rregullat e nenit 99 të këtij ligji, përmes mjeteve të veta ose përmes organizatave afariste të licencuara nga Komuna për zhvendosjen e mjeteve.

100.3. Shërbimi Policor i Kosovës me një akt nënligjor përcakton mënyrën e zhvendosjes së mjeteve të cilat ndalen ose parkohen kundër rregullave të nenit 99 të këtij ligji, ndërsa Kuvendet Komunale përcaktojnë vendin ku do të qëndrojnë përkohësisht mjetet e zhvendosura.

#### Neni 101

101.1. Në çiftë se mjete të zhvendosur nuk kërkohet nga pronari brenda gjashtë muajve, mjete do të shitet me ankand publik dhe të hollat do të derdhen në Buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

101.2. Nëse mjete pas tri ankandëve publike nuk mund të shitet, i njëjti duhet të asgjësohet në bazë të një vendimi të cilin e nxjerr një komision i veçantë, i cili formohet nga Kuvendi Komunal përkatës, Shërbimi Policor i Kosovës dhe Shërbimi Doganor i Kosovës.

#### Neni 102

102.1. Shpenzimet e zhvendosjes së mjetit dhe qëndrimit të mjetit në vendin e caktuar nga neni 99 i këtij ligji i bart shoferi përkatësisht pronari i mjetit.

102.2. Për të siguruar pagimin e shpenzimeve të zhvendosjes së mjetit nga personi i cili nuk është banor i Kosovës, personi i cili bënë zhvendosjen e mjetit mund të kërkojë garanci. Në qoftë se pronari nuk jep garanci mjeti mund të mbahet.

102.3. Shumën e shpenzimeve të zhvendosjes së mjeteve e përcakton Shërbimi Policor i Kosovës në bashkëpunim me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.

### Neni 103

103.1. Shoferi i mjetit duhet që mjetin ose mjetin bashkangjites përveç çiklomotorit, motoçikletës pa rimorkio anësore, kur janë të ndalura në rrugë të shënojnë me shenjën me të cilën shënohet ndalja e mjetit në rrugë (trekëndëshi i sigurisë) për shkak të prishjes, aksidentit ose ndonjë arsye tjetër dhe atë:

- a) në autostradë, në rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike dhe rrugë të shpejta;
- b) në rrugë jashtë zonës së banuar, me rastin e ndaljes në rrugë në vendin ku kjo ndalohet, nëse mjeti nuk mund të shihet nga një distancë e mjaftueshme;
- c) në rrugë brenda zonës së banuar, me rastin e ndaljes në rrugë në vendin ku ndalja ndalohet.

103.2. Ndalja e mjetit nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të shënohet si në vijim:

- a) në autostradë ose rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike me anë të: shenjës me të cilin shënohet mjeti i ndalur në rrugë (trekëndëshi i sigurisë), ndezja e gjithë treguesve të drejtimit, dhe nëse mjeti nuk është i pajisur me gjithë treguesit e drejtimit duhet ti ndez dritat e pozicionit;
- b) duke vendosur trekëndëshin e sigurisë në distancë prej 100 metra pas mjetit trekëndëshi i tillë duhet të vendoset në rrugë, varësisht se ku mjeti është i ndalur;
- c) në rrugë të tjera: jashtë zonës së banuar me anë të vendosjes të trekëndëshit të sigurisë, në distancë prej 30-50 metra pas mjetit dhe duhet ndezur të gjithë treguesit e drejtimit, nëse treguesit nuk janë në dispozicion, duke i ndezur dritat e pozicionit;
- d) brenda zonës së banuar, me anë të ndezjes së të gjithë treguesve të drejtimit dhe nëse treguesit nuk janë në dispozicion, duke i ndezur dritat e pozicionit dhe duke vendosur trekëndëshin e sigurisë pas mjetit në distancë të sigurt që mundet lehtë të vërehet ose në lartësi jo më shumë se 1 metër.

103.3. Shënimi i mjetit i përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni është i obligueshëm gjatë tërë kohës së ndalimit të mjetit.

103.4. Në të njëjtën mënyrë sikurse në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni shënohen edhe kolona e mjeteve, bashkësia e mjeteve dhe mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme vetëm se në vend të një trekëndëshit të sigurisë vendosen dy trekëndësha të sigurisë.

103.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që nuk e shënon mjetin e ndalur ose e shënon në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 104

104.1. Para se të largohet nga mjete, shoferi i cili e lenë mjetin në rrugë detyrohet ti marr të gjitha masat e duhura që mjete mos të lëviz vetë nga vendi ose që personat e pa autorizuar të vejnë në lëvizje (të fiket motori, të mbyllen dritaret dhe dyert dhe çelësat ti marr me veti ose të ngjashme).

104.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### 13. NDËRPRERJA E KOLONES SË KËMBËSORËVE

#### Neni 105

105.1. Shoferit nuk i lejohet me mjet ta ndërprerje kolonën e fëmijëve, ushtarëve, funeraleve ose çdo kolone tjetër të organizuar të këmbësorëve që lëvizin rrugës.

105.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### 14. TËRHEQJA E MJETEVE BASHKANGJITËSE DHE QERREVE

#### Neni 106

106.1. Në komunikacionin rrugor publik me përjashtim në autostradë, mjetit mund ti bashkëngjiten më së shumti:

- a) dy mjete bashkangjitëse për transport të ngarkesës;
- b) një mjet bashkangjitës për transportin e personave.

106.2. Mjete motorik i lejohet te tërheq mjetin bashkangjitës i cili nuk e zvogëlon stabilitetin e tij.

106.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

106.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 107

107.1. Në autostradë dhe në rrugë të rezervuar vetëm për mjete motorike, mjeteve motorike mund ti bashkëngjitet vetëm një mjet bashkangjitës.

107.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

107.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 1.500 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

## Neni 108

108.1. Lëvizja e mjeteve apo e bashkësive të mjeteve tek të cilat masa, ngarkesa në boshte apo dimensionet me apo pa ngarkesë janë më të mëdha se sa lejohen me rregullat e këtyre mjeteve dhe përkufizohen në nenin 178 të këtij ligji lejohet me kusht që të merret leja e veçantë.

108.2. Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet:

- a) në afat të pacaktuar;
- b) për një periudhë të caktuar e shënuar në leje;
- c) për një kalim në periudhë të caktuar kohore dhe në itinerar të caktuar.

108.3. Lejet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni lëshohen nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës.

108.4. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës do të përkufizoj me anë të një akti nënligjor, kriteret dhe procedurat në detaje për lëshimin e lejeve të përmendura në paragrafin 1, lidhur me mjetet dhe itineraret.

108.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

108.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

## Neni 109

109.1. Në komunikacionin rrugor traktori mund të tërheq mjetin e qerres e cila është e rregulluar për tu tërhequr nga traktori.

109.2. Qerrja e cila tërhiqet nga traktori në komunikacionin rrugor duhet ti ketë gomat e fryra.

109.3. Qerrja e cila tërhiqet nga traktori në komunikacionin rrugor duhet jetë e lidhur me ndihmën e lidhjes nyjore ashtu që gjatë ngasjes siguron stabilitetin e dy mjeteve dhe pa mundëson shkëputjen e tyre.

109.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 110

110.1. Në komunikacionin rrugor makinat e punës lejohet të tërheqin edhe mjete bashkangjitime dhe veglat të cilat shërbejnë për qëllimin e tyre.

110.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

110.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

## Neni 111

111.1. Në komunikacionin rrugor me biçikletë dhe çiklomotor lejohet të tërhiqet mjete bashkangjites me dy rrota i përforcuar në atë mënyrë që nuk e zvogëlon stabilitetin e mjetit. Mjeti bashkangjites nuk lejohet të jetë më i gjerë se 80 cm, ndërsa masa e përgjithshëm nuk lejohet të jetë mbi 50 kg. Në pjesën e pasme duhet ti ketë dy katadiopter të paraparë për mjetin bashkangjites.

111.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 15. TËRHEQJA E MJETIT TE PRISHUR (DEFEKT)

### Neni 112

112.1. Shoferi i mjetit mund të tërheq mjetin tjetër përveç mjeteve bashkangjitesë, vetëm nëse ato nuk mund të lëvizin vet, për shkak të prishjes apo në mungesë të ndonjë pjese.

112.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 113

113.1. Në mjetin e tërhequr si rezultat i prishjes ndalohet transporti i personave.

113.2. Me mjet nuk lejohet tërheqja e motoçikletës pa rimorkio anësore ose mjeteve të ngjashme me dy rrota.

113.3. Mjeti që tërhiqet duhet të jetë i ngjitur për mjetin që tërheq, në atë mënyrë që përjashtohet mundësia e shkëputjes së tyre gjatë lëvizjes.

113.4. Gjatë kohë së tërheqës së mjetit nga neni 112 i këtij ligji te dy mjetet duhet të jenë të shënuara me shenje me të cilën shënohet ndalja e mjetit ne rrugë (trekëndëshi i sigurisë). Në mjetin i cili tërheqë trekëndëshi vendoset në pjesën e përparme, ndërsa në mjetin e tërhequr në anën e prapme.

113.5. Në të dy mjetet gjatë tërheqjes duhet të jenë të ndezur të gjithë treguesit e drejtimit nëse janë të instaluar në mjet.

113.6. Distanca në mes dy mjeteve nuk duhet të jetë më e vogël se 3 m kur përdoret lidhja e ngurtë (me bigë) dhe nga 4 deri në 6 m, në rast të lidhjes fleksibile, të shënuar me shirita të bardhë dhe të kuq.

113.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 114

114.1. Mjeti me veprim motorik në rrugë mund të tërhiqet me ndihmën e lidhjes fleksibile, lidhjes së ngurtë dhe duke e mbështetur ose varur në mjetin tërheqës.

114.2. Ndalohet tërheqja:

- a) e mjetit, me lidhe fleksibile nëse, sistemi i tij i frenimit dhe drejtimit është jashtë funksionit, si dhe mjeteve transportuese dhe autobusëve;
- b) e mjetit me anë të lidhjes fleksibile nëse, për funksionimin e sistemit të frenimit të mjetit që terhiçët, nevojitet që motori të punon, ndërsa motori është jashtë funksionit;
- c) me lidhje të fortë, e mjetit i cili sistemin e drejtimit e ka jashtë funksionit dhe as e mjetit i cili është më i rënd se mjeti që e tërheq nëse nuk e ka në rregull frenin punues;
- d) e më shumë se një mjeti, me përjashtim të bashkësisë së mjeteve;
- e) në autostradë, më përjashtim të tërheqjes nëse prishja ka ndodhur gjatë ngasjes nëpër autostradë deri në daljen më të afërt nga autostrada.

114.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 115

115.1. Nëse mjeti motorik tërhiqet me ndihmën e lidhjes fleksibile ose të fortë shoferi i cili drejton mjetin të cilin e tërheq duhet ta ketë patentë shoferin për drejtimin e asaj kategorie ose lloj të mjetit të cilit i takon mjeti i cili tërhiqet.

115.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 116

116.1. Natë dhe ditën kur dukshmëria është e zvogëluar lejohet tërheqja e mjetit, vetëm nëse i ka të ndezura prapa dritat e kuqe për shënimin e mjetit ose e tërheqjen e bën mjeti i cili e ka dhe gjatë tërheqjes e përdor dritën e verdhë vezulluese rrotulluese.

116.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 117

117.1. Tërheqja e mjetit të transportit ose bashkësia e mjeteve të ngarkuara lejohet deri te vendi i parë i përshtatshëm për ngarkim- shkarkim, ndërsa në raste të jashtëzakonshme deri te vendi i parë ku mund të mënjanohet defekti i mjetit.

117.2. Në rast të tërheqjes së një mjeti në mënyrë të tillë që nuk ka nevojë për ta drejtuar ose që të përdoren frenat, masa e përgjithshme e mjetit të tërhequr nuk mund të jetë më e madhe se masa e përgjithshme e mjetit që tërheq.

117.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 16. PËRDORIMI I DRITAVE NË KOMUNIKACION

#### Neni 118

1. Në mjet me veprim motorik i cili merr pjesë në komunikacionin rrugor duhet të jenë të ndezura dritat si vijon:

- a) automjetet motorike përveç biçikletave me motor dhe motoçikletave pa rimorkio anësore duhet të kenë së paku dy drita të bardha në pjesën e përparme dhe dy të kuqe në pjesën e pasme;
- b) çiklomotori dhe motoçikleta pa rimorkio anësore – të paktën një dritë të bardhë në pjesën e përparme dhe të paktën një dritë kuqe në pjesën e pasme;
- c) kur mjeti motorik tërheq një ose dy mjete bashkangjitime në pjesën e pasme të mjetit bashkangjites të fundit duhet të jenë të ndezura të paktën dy drita të kuqe, e në qoftë se gjerësia e mjetit bashkangjites është ma e madhe se 1,60 metra, në pjesën e përparme të mjetit bashkangjites së parë duhet të jenë të ndezura dy drita të bardha .

#### Neni 119

1. Përrjashtimisht nga rregullat e nenit 118 të këtij ligji, nuk duhet të ketë drita të ndezura:

- a) mjeti i ndalur ose i parkuar në pjesën e ndriçuar të rrugës që shihet qartë nga një largësi e mjaftueshme;
- b) mjeti i ndalur ose i parkuar në vende të caktuara në rrugë ose jashtë rrugës ose në rrugë me intensitet të dobët të komunikacionit;
- c) biçikleta, çiklomotori dhe motoçikleta pa rimorkio anësore e cila nuk ka bateri, kur janë të ndalura ose parkuara në zona të banuara pranë skajit të djathtë të rrugës.

#### Neni 120

Mjetet motorike të cilat gjatësia nuk kalon 8m dhe gjerësia 2m, dhe të cilave nuk iu është bashkangjitur mjeti bashkangjites, kur është i ndalur ose i parkuar në rrugë brenda zonës së banuar, në vend të dritave të parapara në nenin 118 të këtij ligji, duhet të ketë të ndezur një dritë e cila nga ana e përparme shihet si e bardhë dhe një dritë nga ana e pasme si e kuqe dhe të vendosura në anën e kundërt nga skaji i rrugës në të cilën mjeti është i ndaluar ose i parkuar.

#### Neni 121

121.1. Për ndriçimin e rrugës shoferi i mjetit me fuqi motorike si rregull përdor dritat e gjata.

121.2. Përrjashtimisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shoferi ka për detyrë të përdor dritat e shkurta në rastet vijuese:

- a) kur ekziston mjeti tjetër që vjen përballë dhe kur njëri nga shoferët e mjetit i ndal dritat e gjata dhe i ndez dritat e shkurta;
- b) kur ekziston mundësia që të pengoj nga prapa shoferin e mjetit përpara;
- c) kur ekziston aty afër mjeti i cili i lëvizë nëpër binarë, apo kur i vjen përballë mjeti i lundrimit, po që se ndonjëri prej tyre lëviz brenda një distance të tillë që ekziston mundësia që të pengoj shoferin;



d) gjatë kohës derisa kalon pranë kolonës të organizuar të këmbësoreve.

121.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që i përdor dritat për ndriçimin e rrugës në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 122

122.1. Shoferi i mjetit motorik gjatë ngasjes ditën, duhet t'i ketë të ndezura dritat e ditës ose dritat e shkurtra.

122.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që nuk i përdor dritat sipas dispozitave të këtij neni.

#### Neni 123

123.1. Kur ka mjegull shoferi i mjetit me veprim motorik duhet ti ketë të ndezura në mjet dritat e shkurtra ose ato për mjegull ose dy llojet e dritave në të njëjtën kohë.

123.2. Dritat për mjegull lejohet të përdoren vetëm kur ka mjegull ose në rast të zvogëlimit të dukshmërisë.

123.3. Dritat për mjegull të cilat gjinden në pjesën e përparme mund të jenë të bardha ose të verdha, ndërsa në pjesën e pasme, ngjyrë të kuqe.

123.4. Shoferi i mjetit mund të përdor dritat e mjegullës, kur kufizimi i dukshmërisë është 50 metra. Kur dukshmëria të përmirësohet, shoferi i mjetit duhet që menjëherë ti ndal këto drita.

123.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që i përdor dritat për mjegull në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 124

124.1. Mjetet motorike gjatë gjithë kohës së lëvizjes kur i kanë të ndezura cilat do drita për ndriçimin e rrugës ose ato të veçanta për mjegull duhet t'i kenë të ndezura edhe dritat e pozicionit.

124.2. Në rastet e radhitura në nenin 118 të këtij ligji, në vend të këtyre dritave shoferi i mjetit duhet të përdor dritat e tjera me të cilat mjete është i pajisur.

124.3. Rregullat nga neni 118 të këtij ligji nuk zbatohen, gjatë ndaljes së mjetit e cila vjen si shkak i rregullave të komunikacionit rrugor. Nëse ndalja zgjat më shumë se 1 minutë, lejohet të ndalen dritat e shkurtra të mjetit, nëse para dhe pas tij, në të njëjtin shirit të komunikacionit ekzistojnë të ndalura mjete tjera.

124.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që nuk i përdor dritat e pozicionit sipas dispozitave të këtij neni.

## Neni 125

125.1. Dritat e pozicionit në mjet mund të ndezën vetëm gjatë qëndrimit ndalur apo në parking, me kusht që nuk pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion. Ky kufizim nuk zbatohet në mjetet me përparësi kalimi dhe nën përcjellje.

125.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që i përdor dritat në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 17. DISTANCA NË MES TË MJETEVE

### Neni 126

126.1. Shoferi i mjetit detyrohet të mbajë distancën e nevojshme (distanca e sigurisë) kur lëviz pas mjetit tjetër, në mënyrë që të mos e rrezikojë sigurinë e komunikacionit.

126.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që nuk e mban distancën e nevojshme.

### Neni 127

127.1. Kur në rrugë publike jashtë zonave të banuara, e cila ka vetëm një shirit të komunikacionit të destinuar për komunikacion të mjeteve në një drejtim, lëvizin njëra pas tjetrës mjetet me fuqi motorike me masën maksimale të lejuar mbi 3500 kg, ose me gjatësi më të madhe se 7m, shoferet e mjeteve janë të detyruar të mbajnë një largësi prej të paktën 100 metra ndërmjet këtyre mjeteve, nëse në atë pjesë të rrugës lejohet tejkalimi.

127.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që nuk e mban distancën e sigurisë sipas dispozitave të këtij neni.

## 18. KOMUNIKACIONI I BICIKLETAVE, CIKLOMOTORVE DHE MOTOCIKLETAVE

### Neni 128

128.1. Shoferi i biçikletës, duhet të shfrytëzoj shiritin për biçiklistë ose shtegun e përcaktuar dhe të ndërtuar për biçikleta dhe këmbësorë personi që nget biçikletën, gjatë shfrytëzimit të shtegut për biçikleta dhe këmbësorë duhet të ushtroj kujdes të shtuar dhe tu jap përparësi këmbësorëve.

128.2. Kur nuk ekziston shtegu për biçikleta ose shtegu për biçikleta dhe këmbësorë, shoferi i biçikletës duhet të shfrytëzoj bankinën, dhe nëse kjo nuk është e mundshme, të shfrytëzoj rrugën.

128.3. Fëmija deri në moshën 7 vjeçare, mund të bartet në biçikletë, me kusht që biçikleta është e pajisur me një mbështetëse speciale që të ofroj siguri.

128.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i biçikletës që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 129

129.1. Shoferit të biçikletës, çiklomotorit dhe motoçikletës i ndalohe:

- a) të ngas pa e mbajtur timonin së paku me një dorë dhe pa i mbajtur këmbët në pedale ose mbështetëse të këmbëve;
- b) të mbahet ose të tërhiqet nga mjetet tjera;
- c) të lëviz njëri pran tjetrit.

129.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 130

130.1. Në vendkalimin për biçiklistë, i ndalohe shoferit të biçikletës të hyj ashpër para mjetit që vjen, ose të ngadalësoj apo ndaloj, pa shkak të arsyeshëm.

130.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i biçikletës që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 131

131.1. Shfrytëzimi i trotuarit ose shtegut për këmbësorë, shoferit të biçikletës i lejohet në raste të jashtëzakonshme kur personi kujdeset për fëmijën deri në moshën 10 vjeçare, që është duke drejtuar biçikletën.

131.2. Shoferi i biçikletës, duke shfrytëzuar trotuarin ose shtegun e këmbësorëve, obligohet të nget ngadalë, të ushtroj kujdes të veçantë dhe t'u jap përparësi këmbësorëve.

131.3. Biçikleta duhet të ketë të ndezur një dritë ngjyrë të bardhë në pjesën e përparme dhe një dritë ngjyrë të kuqe, katadiopter me materie retro-reflektuese në pjesën e pasme gjatë ngasjes natën ose ditën kur pashmëria është e kufizuar.

131.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i biçikletës që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 132

132.1. Shoferi i cili drejton çiklomotorin dhe motoçikletën dhe personat të cilët barten në këto mjete, duhet të mbajnë helmetën mbrojtëse gjatë ngasjes në rrugë. Helmetën mbrojtëse gjatë drejtimit në rrugë duhet ta mbaj edhe shoferi i biçikletës nëse është më i ri se 16 vjet.

132.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i çiklomotorit, motoçikletës dhe personat të cilët barten në këto mjete nëse gjatë ngasjes në rrugë nuk e bartin helmetën mbrojtëse si dhe shoferi i biçikletës nëse është më i ri se 16 vjeç.

## 19. KOMUNIKACIONI I QERREVE DHE LËVIZJA E BAGËTIVE

### Neni 133

133.1. Shoferi i qerres i cili nget bagëtisë, gjatë lëvizjes duhet të kujdeset që mjetin ta mbaj nën kontroll dhe sa më afër skajit të djathtë të rrugës.

133.2. Distanca në mes qerreve që lëvizin nuk duhet të jetë më e vogël se 100 m.

133.3. Shoferi i qerres me rastin e hyrjes në rrugë publike në një vend ku dukshmëria është e kufizuar ose në vendet e rrezikshme (kalimi nëpër rrugë rajonale ose magjistrale, vendkalimit hekurudhor ose të ngjashme) obligohet të mbaj njëren kafshë për frena.

133.4. Nuk lejohet që qerrja në rrugë të jetë pa mbikëqyrje.

133.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i qerres që nget bagëtinë i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 134

134.1. Ndalohet për shoferin e qerres:

- a) të mbingarkoj kafshën;
- b) të lejoj qerren në vetë lëvizje;
- c) të drejtoi qerren pa zile ose vinç për frenim;
- d) qerrja duhet të ketë të ndezur një dritë me ngjyrë të bardhë në pjesën e përparme dhe një dritë me ngjyrë të kuqe në pjesën e pasme gjatë lëvizjes natën ose ditën kur dukshmëria është e kufizuar.

Dritat duhet të jenë në anën e majtë të qerres.

134.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i qerres që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 135

135.1. Ndalohet të drejtohet qerrja nga personi nën moshën 14 vjeçare.

135.2. Ndalohet të drejtohet qerrja, të kalërohet kafsha apo ngiten kafshët nga personi që nuk është i aftë, është në gjendje që tregon konsumim alkooli, narkotikë apo substanca me efekt të njëjtë.

135.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 136

136.1. Kalërimi i një kafshe dhe drejtimi i kafshëve do të duhej të bëhej në parim në rrugët e përcaktuara për lëvizje të kafshëve. Në rast se nuk ekziston rrugë e tillë, mund të kalërohen dhe ngiten kafshët në trotuar dhe, nëse nuk ekziston trotuari nëpër bankinë.

136.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, personi i cili kalërimin, përkatësisht drejtimin e kafshëve e bën në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 137

137.1. Ndalohet drejtimi (kalërimi) i kafshës:

- a) pa fre;
- b) në rrugën e shënuar me shenja që bartin numrin e një rrugë ndërkombëtare dhe në rrugën ku lëvizja e qerreve ndalohet;
- c) në rrugë publike gjatë kohës me pashmëri të kufizuar;

- d) kalorësi lejohet të shpie vetëm një kafshë në anën e djathtë të tij;
- e) në rrugët rajonale dhe lokale nga personi i cili nuk i ka mbushur 10 vjet.

137.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, personi që i drejton kafshët në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 138

138.1. Kafshët në kope mund të lëvizin në rrugë vetëm nën kontrollin e personit.

138.2. Personi që nget kafshët duhet:

- a) të ecë në anën e majtë të kafshës që nget;
- b) që gjatë periudhës së dukshmërisë së kufizuar të bart një dritë të bardhë që shihet prej një distance së paku 150 metra.

138.3. Më shumë se dy kafshë nuk mund të ngiten të ngjitura për anën e djathtë të qerres.

139.4. Gjatësia e kopesë së kafshëve nuk lejohet të jetë më e madhe se 50 metra, ndërsa në mes tyre duhet të ekzistoj distanca së paku prej 50 metra.

138.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 139

139.1. Ndalohet:

- a) ngitja e kafshëve në rrugën e shënuar ndërkombëtare dhe në rrugë të tjera publike nga muzgu deri në agim;
- b) të nget kafshët përtej rrugës në një vend që nuk është e dukshme nga një distancë e mjaftueshme;
- c) të ndal kafshët në rrugë;
- d) të zë me një kafshë më shumë hapësirë nga ana e djathtë e rrugës së shtegut të këmbësorëve apo biçiklistëve.

139.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 140

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Kuvendet Komunale, nxjerrin akte nënligjore mbi ndalimin e drejtimit të kafshëve në rrugë të caktuara apo në zona të caktuara brenda një kohe specifike.

## 20. LËVIZJA E KËMBËSORËVE

#### Neni 141

141.1. Si rregull këmbësorit nuk i lejohet, të lëvizë ose të ndalet në rrugë.

141.2. Këmbësori obligohet që të përdorë trotuarin ose sipërfaqen tjetër të caktuar për lëvizjen e këmbësorëve (shtegu për këmbësor). Nëse nuk ka trotuar ose shteg të këmbësorëve ose përkohësisht nuk mund të përdoret, këmbësori mund të përdorë rrugën

automobilistike (në tekstin e tutje rrugë), me kusht që të lëvizë sa më afër skajit të rrugës dhe ia lëshon rrugën mjeteve që afrohen.

141.3. Këmbësori që ecë në rrugë obligohet që të shfrytëzoj anën e majtë të rrugës në kahe të lëvizjes.

141.4. Këmbësorët duke ecur në rrugë janë të obliguar të lëvizin njëri pas tjetrit. Në rrugë, me intensitet të vogël të komunikacionit dhe në kushte të mira të pashmërisë, dy këmbësorë mund të ecin pranë njëri tjetrit.

141.5. Shfrytëzimi i shtegut të përcaktuar për lëvizje të biçikletave, nga ana e një këmbësori, lejohet vetëm nëse nuk ekziston trotuari, bankina dhe shfrytëzimi i tyre nuk është i mundshëm. Këmbësori që shfrytëzon shtegun e biçikletës, me përjashtim të personave me aftësi të kufizuar, është i obliguar që t'ia lëshoj rrugën biçiklistit.

141.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 142

142.1. Rregullat e nenit 141 të këtij ligji, nuk vlejnë për zonat e banuara. Në zonat e parapara vetëm për këmbësori, këmbësori mund të shfrytëzoj tërë rrugën dhe gëzon të drejtën e përparësisë para mjetit.

142.2. Fëmija deri në moshën 7 vjeçare, lejohet të shfrytëzoj rrugën vetëm nën mbikëqyrjen e personit që është së paku i moshës 10 vjeçare dhe të bartë elemente retro-reflektuese me përjashtim brenda zonave të banuara.

#### Neni 143

143.1. Kolona e këmbësorëve, me përjashtim të këmbësorëve deri në moshën 10 vjeçare, iu lejohet të lëvizin vetëm në anën e djathtë të rrugës.

143.2. Numri i këmbësorëve të cilët ecin krah për krah në grup, nuk duhet ta tejkalojnë numrin prej 4 vetash ashtu që grupi mos ta zë më shumë se gjysmën e rrugës” .

143.3. Kolona e këmbësorëve e moshës deri 10 vjeçare mund të ecin në rrugë vetëm në çift dhe nën mbikëqyrjen e së paku një personi mbi 18 vjeç.

143.4. Gjatësia e kolonës së këmbësorëve nuk mund të tejkaloj 50 metër-shin. Distanca ndërmjet kolonave nuk mund të jetë më e vogël se 100 metra.

143.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 144

144.1. Nëse kolona e këmbësorëve ecën nën kushte të kufizuara të pashmërisë:

- a) personi i parë dhe i fundit, në anën e majtë të kolonës, duhet të bartin nga një dritë, personi i parë dritë të bardhë me përballje përpara ndërsa personi i fundit, dritë të kuqe më përballje prapa;

- b) në kolonën prej 20 metra e më gjatë, personat e përmendur në pikën 1 obligohen që të veshin ose bartin elemente reflektuese me parametra standarde dhe përveç kësaj, personat që ecin në anën e majtë të kolonës obligohen që të bartin dritë të bardhë në mënyrë të tillë, që distanca në mes tyre nuk është më shumë se 10 metra;
- c) drita, llambat dhe dritat reflektuese, duhet të jetë e dukshme nga një distancë jo më e vogël se 150 metra.

144.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 145

145.1. Ndalohet:

- a) për këmbësorët që ecin në kolonë, të cilët lëvizin në kushtet me dukshmëri të kufizuar. Kjo nuk zbatohet për KFOR-in, Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe Shërbimin Policor të Kosovës;
- b) për këmbësorët deri në moshën 10 vjeçare, që të lëvizin nën kushte të një dukshmërie të kufizuar;
- c) për personin e moshës më të re se 18 vjet që të udhëheq kolonën e këmbësorëve.

145.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve i cili lejon lëvizjen e kolonës gjatë kohës me pashmëri të zvogëluar në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

145.3. Për kundërvajtje nga pika c) e paragrafit 1 të këtij neni, dënohet me gjobë prej 25 €, udhëheqësi i kolonës së këmbësorëve i cili është më i ri se 18 vjet.

#### Neni 146

146.1. Këmbësori gjatë kalimit të rrugës obligohet që të ketë kujdes të posaçëm dhe gjithherë, të shfrytëzojnë vendkalimin e këmbësorëve ku ekzistojnë. Këmbësori në atë vendkalim ka përparësi para mjeteve.

146.2. Kalimi i rrugës jashtë vendkalimit të këmbësorëve lejohet nëse, distanca nga vendi ku dëshiron të kaloj rrugën nga vendkalimi i shënuar i këmbësorëve është më i madh se 100 metra. Megjithatë, nëse ekziston ndonjë kryqëzim ose rrugë bashkangjitime brenda distancës prej 100 metrave, këmbësori mund të kaloj rrugën gjithashtu edhe në kryqëzimin e tillë.

146.3. Kalimi i rrugës jashtë vendkalimit të këmbësorëve të përmendur në paragrafin 2, lejohet me kusht që nuk pengon dhe rrezikon sigurinë e komunikacionit. Këmbësori obligohet që t'u jap përparësi mjeteve dhe të kaloj rrugën duke shfrytëzuar rrugë më të shkurtër, tërthorazi me vijën qendrore të rrugës.

146.4. Nëse ekziston urë apo tunel në rrugë, këmbësori detyrohet të lëvizë me kujdes të shtuar.

146.5. Brenda zonës së banuar, në rrugën me dy shirita rrugor të ndarë në mes veti fizikisht, këmbësori obligohet që të shfrytëzoj vetëm vendkalimin e paraparë për këmbësorë.

146.6. Nëse vendkalimi i këmbësorëve është shënuar në rrugë më dy shirita rrugor, kalimi i secilit shirit rrugor konsiderohet si vendkalim i ndarë. Kjo aplikohet gjithashtu edhe në vendkalimet e këmbësorëve, në vendet ku komunikacioni i mjeteve është i ndarë me anë të një pjese të ngritur, ose ndonjë pajisje tjetër teknike.

146.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 147

147.1. I ndalohet këmbësorit:

- a) hyrja në rrugë drejtpërdrejt para mjetit në lëvizje, përfshirë vendkalimin e këmbësorëve dhe mbrapa mjetit ose pengese tjetër që kufizon dukshmërinë e rrugës;
- b) kalimi i rrugës në vendin ku dukshmëria e rrugës është e kufizuar;
- c) ngadalësimi i shpejtësisë së të ecurit ose ndalja pa arsye gjatë kalimit të rrugës apo binarëve hekurudhorë;
- d) lëvizja ose qëndrimi në rrugë;
- e) vrapimi i paarsyeshëm;
- f) ecja përgjatë vijës hekurudhore;
- g) hyrja brenda vijës së hekurudhës kur gjysmë-barrierat ose barrierat janë të lëshuara poshtë ose ulja e tyre veç ka filluar
- h) kalimi i rrugës në vendin ku mekanizmat ose pengesat për siguri ndajnë shtegun e këmbësorëve ose trotuarin nga rruga, pa marr parasysh në cilën anë janë ato të vendosura.

147.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 148

148.1. Në vendkalimin e shënuar të këmbësoreve në të cilin komunikacioni i këmbësoreve rregullohet me shenja ndriçuese të komunikacionit për këmbësor përkatësisht në kryqëzim, këmbësori obligohet të veproj sipas atyre shenjave.

148.2. Në vendkalimin e shënuar të këmbësoreve në të cilin komunikacioni i këmbësoreve rregullohet me shenja ndriçuese të komunikacionit për këmbësor ose me shenjat e personit të autorizuar, këmbësori mund të kalojë rrugën vetëm kur me shenjen e dhënë i lejohet kalimi nëpër rrugë.

148.3. Në vendkalimin e shënuar të këmbësoreve në të cilin komunikacioni i këmbësoreve nuk rregullohet me shenja ndriçuese të komunikacionit për këmbësor, as me shenjat e personit të autorizuar, këmbësori edhe pse ka përparësi kalimi duhet t'i kushtoj kujdes largësisë dhe shpejtësisë së mjetit që i afrohet.

148.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.



## Neni 149

149.1. Këmbësoni i cili e shtyn karrocën, biçikletën, çiklomotorin, motoçikletën, personat të cilët lëvizin me ndihmën e karrigeve për personat me aftësi të kufizuar duhet të lëvizin pran skajit të djathtë të rrugës në drejtim të lëvizjes.

149.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësoni që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 21. OBLIGIMET E SHOFERËVE NDAJ KËMBËSORËVE

### Neni 150

150.1. Shoferi i mjetit gjatë afrimit të vendkalimit për këmbësonë, duhet të ushtroj kujdes të veçantë dhe ti jap përparësi këmbësorit i cili është ose hynë në vendkalim.

150.2. Në qoftë se komunikacioni në vendkalimin e shënuar të këmbësorëve është i rregulluar me shenjat e komunikacionit me drita, ose me shenjat e personit të autorizuar, shoferi i mjetit është i detyruar ta ndal mjetin e vet para vendkalimit të shënuar për këmbësorë kur me shenjë e dhënë i është ndaluar kalimi.

150.3. Nëse vendkalimi i shënuar i këmbësorëve nga paragrafi 2 i këtij neni gjendet në hyrje të rrugës, shoferi i cili lëvizë në atë rrugë është i detyruar të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe ti lëshoj të kalojnë këmbësorët të cilët gjinden ose hyjnë në vendkalim dhe sipas nevojës ta ndal mjetin e vet për ti lëshuar këmbësorët.

150.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit e të drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri në gjashtë muaj si dhe dy pikë negative.

### Neni 151

151.1. Shoferi i mjetit gjatë kalimit të trotuarit apo shtegut të këmbësorëve duhet të ngas ngadalë dhe t'iu jap përparësi këmbësorëve.

151.2. Rregulla në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet gjithashtu edhe gjatë ngasjes në sheshe, ku për arsye se nuk ka rrugë të ndara dhe trotuare lëvizja e mjeteve dhe e këmbësorëve bëhet në të njëjtën sipërfaqe.

151.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

### Neni 152

152.1. Në rast kur rruga kalohet nga personi (këmbësoni), me aftësi të kufizuar që mban shenjë dalluese ose nga personi me lëvizshmëri të kufizuar që është e dukshme, personat e moshuar, personat e paaftë dhe fëmijët, shoferi obligohet të ndal mjetin, në mënyrë që ti mundëson atij personi që të kaloj rrugën.

152.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 153

153.1. Shoferi që me mjet kthehet në rrugën anësore në hyrje të së cilës nuk ekziston vendkalimi i shënuar i këmbësorëve, detyrohet të kthehet me shpejtësi të zvogëluar dhe nuk i lejohet ti rrezikoj këmbësoret të cilët veç kanë hyrë në rrugë.

153.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, shoferi i i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 22. KOMUNIKACIONI NË KALIMIN E RRUGËS NËPËR VIJËN HEKURUDHORE

#### Neni 154

154.1. Shoferi i mjetit, gjatë afrimit të kalimit hekurudhor dhe gjatë kalimit të saj duhet të ushtroj kujdes të shtuar. Para se të kalojë mbi binarë, shoferi i mjetit duhet të sigurohet që mjet i cili lëvizë nëpër binar nuk është në ardhje dhe të ndërmerr masa të veçanta të nevojshme, veçanërisht nëse pashmëria është e zvogëluar për shkak të kushteve atmosferike ose rrethanave tjera në rrugë.

154.2. Shoferi i mjetit duhet të ngas me kujdes dhe shpejtësi të zvogëluar, e cila do ti lejonte të ndal mjetin në vend të sigurt, në rast të ardhjes së mjetit i cili lëvizë nëpër binarë, ose kur mekanizmi i sigurisë (barrierat ose gjysmë barrierat) si dhe sinjalizimi me dritë të kuqe dhe zëri, nuk e lejon hyrjen në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore.

154.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni si dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një pikë negative.

#### Neni 155

155.1. Në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore pa mekanizma mbrojtës dhe për dhënien e sinjaleve me të cilat paralajmërohet afrimi i trenit, shoferi obligohet më parë të sigurohet se nëpër vijën hekurudhore nuk vjen ndonjë mjet, para se të kalojë nëpër vijën hekurudhore.

155.2. I ndalohet shoferit:

- a) të kaloj anash gjysmë barrierat ose barrierat dhe të hyj në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore nën rrethanat kur ulja e gjysmë barrierave ose barrierave veç ka filluar ose ngritja e gjysmë barrierave apo barrierave nuk ka përfunduar;
- b) hyj, në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore, nëse nuk ka në dispozicion hapësirë të mjaftueshme në anën tjetër të kalimit për vazhdimin e lëvizjes;
- c) kaloj mjetin duke pritur hapjen e gjysmë-barrierave ose barrierave.

155.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni si dhe te njëjtë njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit të mjetit me veprim motorik deri në tre muaj dhe një pikë negative.

## Neni 156

156.1. Nëse ndodh që mjeteve është bllokuar në kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore, shoferi obligohet, që menjëherë ta largojë nga kalimi dhe nëse kjo është e pamundshme, të paralajmërojë personin i cili drejton mjetin mbi binarë për rrezikun.

156.2. Shoferi që drejton mjetin ose bashkësinë e mjeteve me gjatësi që tejkalon 10 m., që nuk mund të zhvilloj shpejtësinë me të madhe se 6 km/orë, obligohet që para se të hyj nëpër kalimin e rrugës nëpër vijën hekurudhore, të siguroj që në vendkalim nuk do të vjen mjeti i cili lëvizë nëpër binar, gjatë kohës së nevojshme për kalimin ose që të kërkoj ndihmë nga personi i cili siguron vendkalimin mbi hekurudhë.

156.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 23. KOMUNIKACIONI NË AUTOSTRADË, RRUGË TË SHPEJTA DHE RRUGË TË REZERVUARA PËR MJETET MOTORIKE

### Neni 157

157.1. Ndalohet lëvizja nëpër autostradë: e këmbësorëve, bagëtisë si dhe e mjeteve të cilat sipas dispozitave të këtij ligji nuk konsiderohen mjete motorike.

157.2. Në autostradë ndalohet edhe lëvizja e mjeteve motorike të cilat për nga vetitë e veta të konstruksionit nuk mund të lëvizin me një shpejtësi prej të paktën 60 km/h, përjashtimisht mjetet nën përcjelle, me përparësi kalimi dhe mjetet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

157.3. Shoferi i mjetit motorik i cili për shkak të avarisë ose për shkaqe tjera është i detyruar ta ndal mjetin motorik në sipërfaqen rrugore të autostradës duhet ta ndal në shiritin e emergjencës dhe duhet ti ndërmerri masat që mjetin ta largoj sa më parë nga shiriti i komunikacionit.

157.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni.

### Neni 158

158.1. Ndalohet hyrja në autostradë e mjetit motorik që e tërheq mjetin tjetër.

158.2. Në autostradë mjetet motorike duhet të lëvizin në shiritin e djathtë të skajshëm të komunikacionit i cili nuk është i zënë me mjete motorik që lëvizin në kolonë.

158.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 159

159.1. Në autostradë me tre ose më tepër shirita të komunikacionit të destinuar për lëvizjen e mjeteve motorike në një kahe, shoferi i mjetit motorik me masën me të madhe të lejuar se 5000 kg, ose të mjeteve motorike me rimorkio me gjatësi mbi 7metra mund të shfrytëzoj vetëm dy shirita të komunikacionit që ndodhën pranë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës.

159.2. Shoferi i cili kyçet me mjet motorik në autostradë duhet:

- a) të shfrytëzoj shiritin për nxitim kur ekziston një shirit i tillë dhe duke dhënë shenjën përkatëse me tregues të drejtimit sipas mënyrës me të cilën nuk e rrezikon komunikacionin e mjeteve motorike që lëvizin nëpër autostradë;
- b) ti jep përparësi kalimi komunikacionit i cili lëviz nëpër autostradë, nëse nuk ekziston shiriti i posaçëm për nxitim.

159.3. Shoferi i cili shkyçet nga autostrada duhet ta merr pozitën me mjetin e vet motorik në shiritin e djathtë të skajshëm të komunikacionit dhe sa më parë të kaloj në shiritin për ngadalësim në qoftë se një shirit i tillë ekziston në autostradë.

159.4. Në rast të bllokimit të komunikacionit në autostradë mjetet motorike duhet t'ia mundësojnë lëvizjen e mjeteve me përparësi kalimi dhe nën përcjellje, duke lënë hapësirë dhe duke u skajuar në të djathtë ose në të majtë të shiritit të komunikacionit.

159.5. Ndalohet të ndalet ose parkohet mjeti motorik në autostradë ose rrugë të rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike, përveç aty ku është e shënuar për këtë qëllim. Nëse ndalja e mjetit motorik bëhet për shkak të një problemi teknik ose arsye tjera, shoferi duhet që të largoj mjetin motorik nga rruga dhe ti paralajmëroj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion.

159.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 24. KOMUNIKACIONI NË TUNEL

### Neni 160

160.1. Shoferi i cili me mjet lëviz nëpër tunel nuk i lejohej ta ndal e as të parkoj mjetin, të bëj kthimin gjysmë rrethor ose lëvizjen prapa.

160.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni dhe të njëjtit i shqiptohet një pikë negative.

### Neni 161

161.1. Shoferi i mjetit me veprim motorik duhet gjatë ngasjes nëpër tunel ti ketë të ndezura dritat e shkurta për ndriçimin e rrugës.

161.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 25. MJETET NËN PËRCJELLJE

### Neni 162

162.1. Sipas këtij ligji, automjetet nën përcjellje kanë kuptimin e atyre automjeteve për të cilët përcjellja nga KFOR-i është caktuar, duke përdorur automjete të veçanta që posedojnë pajisje sinjalizuese, me drita të kuqe të kaltërta si dhe me automjete të zakonshme të policisë gjatë sinjalizimit.

162.2. Mjetet nën përcjellje duke pasur kujdes në sigurinë e pjesëmarrësve tjerë të komunikacionit kanë të drejtën e përparësisë së kalimit kundrejt të gjitha mjeteve tjera përveç në kryqëzim ku komunikacioni rregullohet me shenjat e personit të autorizuar.

162.3. Personi i autorizuar që rregullon komunikacionin rrugor është i detyruar të krijoj kushtet që mjetet me përparësi kalimi të kalojnë pa pengesa.

162.4. Mjetet me përparësi kalimi kanë të drejtë të mos i zbatojnë rregullat e komunikacionit, kur ato mjete japin sinjale me drita të kuqe dhe të kaltër dhe sinjale zëri me intensitet të ndryshueshëm, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

#### Neni 163

163.1. Shoferi i mjetit i cili has në rrugë mjetin ose kolonën e mjeteve nën përcjelle dhe shoferi të cilin e arrin mjeti nën përcjelle ose kolona e mjeteve nën përcjelle është i detyruar ta ndal mjetin e vet, që natën në vend të dritave të gjata ti përdor dritat e shkurta për ndriçimin e rrugës, tu përmbahen në mënyrë të përpiktë urdhrave që ia japin personat që i përcjellin mjetet dhe ta vazhdojë lëvizjen vetëm pasi të kalojnë të gjitha mjetet në përcjelle.

163.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 164

164.1. Për të bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve nën përcjelle, këmbësoret janë të detyruar të largohen nga rruga përderisa të mos kalojnë këto mjete.

164.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

### 26. MJETET ME PËRPARËSI KALIMI

#### Neni 165

165.1. Mjete me përparësi kalimi konsiderohen, si vijon:

- a) mjeti i zjarrfikësve;
- b) mjeti i emergjencës (ambulancës);
- c) mjeti i Shërbimit Policor të Kosovës;
- d) mjeti i Trupave Mbrojtëse të Kosovës;
- e) mjeti i njësisë së emergjencës kimike;
- f) mjeti i autoritetit të burgut;
- g) mjeti tjetër i autorizuar nga Shefi i Shërbimit Policor të Kosovës;
- h) mjeti zyrtar ose privat me të cilin qarkullon personi që gëzon dhe dëshmon imunitetin.

165.2. Shefi i Shërbimit Policor të Kosovës në rastin e përmendur në pikën g), të paragrafit 1 të këtij neni, tërheq autorizimin nëse nuk ka më nevojë që të përdoret mjeti me përparësi kalimi.

165.3. Konsiderohen mjete me përparësi kalimi në komunikacion të gjitha mjetet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni, kur me pajimet e veçanta, përveç pikës (h), japin sinjalet me drita dhe të zërit me intensitet të ndryshueshëm (intervenim).

165.4. Mjetet me përparësi kalimi kanë të drejtën e përparësisë kalimi kundrejt të gjithave mjeteve tjera, përveç ndaj mjeteve nën përcjelle dhe ndaj mjeteve që lëvizin nëpër kryqëzim i cili rregullohet me shenja të personit të autorizuar.

165.5. Personi i autorizuar që rregullon komunikacionin rrugor është i obliguar që të krijoj kushtet që mjetet me përparësi kalimi të kalojnë pa pengim.

165.6. Mjetet me përparësi kalimi kanë të drejtë të mos i zbatojnë rregullat e komunikacionit, kur ato mjete japin sinjale me drita të kuqe dhe të kaltër dhe sinjale zëri me intensitet të ndryshueshëm, përveç në rastet kur me një veprim të tillë do të rrezikoheshin pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

#### Neni 166

166.1. Kur mjete i Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës duke përdorur dy drita të kaltra i siguron kalimin një mjeti ose kolonës së mjeteve që lëvizin pas tij, shoferët e mjeteve të tjera, janë të detyruar t'iu kushtojnë kujdes edhe mjeteve të cilave u sigurohet kalimi, t'iu japin përparësi kalimi dhe në rast nevojë edhe ti ndalin mjetet e veta për derisa të mos kalojnë këto mjete.

166.2. Kur mjetet me përparësi kalimi takohen në mes veti, mes tyre vlejnë rregullat e përgjithshme të përparësisë së kalimit

#### Neni 167

167.1. Shoferi i mjetit kur në rrugë takon ose arrin mjetin me përparësi kalimi duhet ta lëshojë e sipas nevojës të ndalet derisa të kaloj ai mjet dhe të veprojnë sipas urdhrat të personit të autorizuar nga mjeti me përparësi kalimi.

167.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 €, shoferi i mjetit që nuk vepron në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 168

168.1. Për të bërë të mundshëm kalimin e papenguar të mjeteve me përparësi kalimi, këmbësorët janë të detyruar të largohen nga rruga derisa të kalojnë këto mjete.

168.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, këmbësori që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 169

169.1. Pajisjet për dhënien e shenjave të posaçme me drita dhe shenjave zëri mundë të montohen dhe të përdoren vetëm në mjetet me të cilat pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës ose Trupave Mbrojtëse të Kosovës (neni 162 i këtij ligji) kryejnë përcjelljen e mjeteve me përparësi kalimi (neni 165 paragrafi 2 i këtij ligji).

169.2. Në mjetet e Shërbimit Policor të Kosovës, përveç pajisjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të montohen edhe pajisjet në të cilat shkruhen urdhrat dhe lajmërimet për shoferin i cili lëvizë përpara ose prapa mjetit të Shërbimit Policor të Kosovës (ndalja e detyrueshme, ndal policia, zvogëlo shpejtësinë, aksident i komunikacionit, rrezik në rrugë dhe të ngjashme).

169.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 140 € personi nëse monton pajisje në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

169.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 250 deri 650 € zyrtari përgjegjës në institucionin publik nëse pa autorizim monton ose lejon montimin e pajisjeve në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

169.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që qarkullon në komunikacion me pajisje të montuara në kundërshtim me këtë nen.

#### Neni 170

Shërbimi Policor i Kosovës me një akt nënligjor do të përcaktoj mënyrën e vendosjes së pajisjeve të zërit dhe dritave në mjetet nën përcjelle dhe me përparësi kalimi.

### 27. NGARKESA NË MJET

#### Neni 171

171.1. Mjeti që ndodhet në komunikacionin rrugor ndalohet të ngarkohet më tepër se bartja e vet që është e regjistruar në lejen e komunikacionit, më tepër se ngarkesa boshtore, më tepër se masa maksimale e lejuar ose mundësia që lejojnë vetit e rrugës dhe mundësit teknike të konstruksionit të mjetit.

171.2. Ngarkesa në mjet duhet të vendoset në mënyrë të tillë dhe sipas nevojës të përforcohet e të mbulohet në mënyrë që:

- a) të mos e rrezikoj sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion dhe të mos dëmtoj rrugët dhe objektet në rrugë;
- b) të mos e pakësoj stabilitetin e mjetit dhe të mos e vështirësoj drejtimin e mjetit;
- c) të mos ia pakësoj shoferit të mjetit pamjen e rrugës;
- d) të mos krijoj zhurmë të tepërt dhe të mos derdh derivate nëpër rrugë;
- e) të mos i mbuloj pajimet dhe sinjalet ndriçuese në mjet, targat e regjistrimit dhe shenjat e tyre të parapara për mjet.

171.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

171.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

#### Neni 172

172.1. Ndalohet që ngarkesa në mjet të kaloj më tepër se 1metër në pjesën e përparme.

172.2. Ngarkesa që transportohet në mjet dhe mjetin bashkangjitime mund të kaloj pikën më të skajshme në pjesën e pasme të mjetit jo më shumë se për një të gjashtë e gjatësisë së ngarkesës e cila është mbështetur pandërprerë në sipërfaqen e ngarkimit.

172.3. Në qoftë se me mjetin transportohet ngarkesa në kombinim që përbëhet nga mjete tërheqës dhe nga rimorkio me një bosht, me gjatësi të mjetit kuptohet gjatësia e përgjithshme e mjetit tërheqës dhe e rimorkios me një bosht.

172.4. Në qoftë se ngarkesa në mjet kalon për më tepër se një metër pikën më të skajshme në pjesën e pasme të mjetit, pika më e skajshme e ngarkesës duhet të shënohet me pëlhurë të kuqe.

172.5. Pika më e skajshme e ngarkesës që transportohet me mjet të transportit ose me rimorkio në rastin nga paragrafi 4 të këtij neni duhet të shënohet me tabelë. Kjo tabelë është në formë katrore me përmasa 50 x 50 cm, e ngjyrosur në mënyrë alternative me shirita të pjerrët me ngjyrë reflektuese portokalli dhe më ngjyrë të bardhë dhe e vendosur pingul mbi boshtin gjatësor të mjetit.

172.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

172.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni.

#### Neni 173

173.1. Gjatë natës si dhe ditën kur pashmëria është e kufizuar, pikat më të skajshme e ngarkesës që transportohet në mjet duhet të shënohet:

- a) në rastin e paragrafit 4 dhe 5 të nenit 172, me dritë dhe materie të shndritshme dhe pasqyruese (reflektuese) ngjyrë të kuqe;
- b) kur ngarkesa në mjetin me veprim motorik ose rimorkio kalon anash më tepër se 40 cm cepin e jashtëm të dritës së përparme ose të pasme për shënimin e mjetit me dritë dhe me pasqyrues dritë të cilat nga ana e përparme japin dritë të bardhë, kurse nga ana e pasme dritë të kuqe.

173.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

173.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

#### Neni 174

174.1. Peshë e përgjithshme e rimorkios së tërhequr nga:

- a) vetura, mjeti për transport me masë të përgjithshme të lejuar deri 3.5 tona, apo autobusi, nuk duhet që të tejkalojnë peshën e përgjithshme të mjetit që tërhiqet;
- b) mjeti i transportit me masë të përgjithshme të lejuar prej më shumë se 3.5 tona - nuk duhet që të tejkaloj peshën e përgjithshme të mjetit që tërhiqet të rritur për 40 %;
- c) motoçikleta apo çiklomotori - nuk duhet të tejkaloj peshën e përgjithshme për secilin prej këtyre mjeteve mbi 100 kg.



174.2. Rregulla në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohen për rimorkiator (gjysmë rimorkio).

174.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

174.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe ndërmarrja ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilës ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

174.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 100 deri 300 €, edhe personi përgjegjës në ndërmarrjen ose institucionin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

174.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i motoçikletes dhe çiklomotorit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 175

Rregullat nga neni 174 i këtij ligji nuk zbatohen në mjetet në pronësi të Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Shërbimit Policor të Kosovës dhe Njërive të zjarrfikësve, në raste emergjente.

#### Neni 176

176.1. Në mjetin bashkangjites të biçikletës, çiklomotorit nuk lejohet bartja e sendeve me të gjëra se 80 cm.

176.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë 25 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 177

177.1. Në biçikletë, çiklomotor dhe motoçikletë nuk lejohet bartja e sendeve me gjerësi më të madhe se 0,5 metra nga dy anët e mjetit.

177.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 178

Ministra e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit do të përkufizoj me anë të një akti nënligjor, kriteret dhe procedurat në detaje për lëshimin e lejeve të përmendura në nenin 124 të këtij ligji si dhe nxjerr rregulloren për dimensionet (gjatësinë, gjerësinë, lartësinë), ngarkesën boshtore dhe masën më të madhe të lejuar për mjetet rrugore.

### 28. BARTJA E PËRSONAVE ME MJET

#### Neni 179

179.1. Në mjet, lejohen të bartën-transportohen vetëm ai numër i personave sa ka ulëse të montuara në mjet, përkatësisht sa janë të shënuar në lejen e komunikacionit të mjetit.

179.2. Dy fëmijë nën moshën dhjetë vjeçare konsiderohen si një person në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni.

179.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që bart më tepër persona se sa janë të shënuar në lejen e komunikacionit.

179.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

#### Neni 180

180.1. Në mjetet bashkangjitëse nga neni 177 i këtij ligji edhe në sandëkun e ngarkesës së çiklomotorit dhe motoçikletës, nuk lejohet transporti i personave.

180.2. Personat mund të transportohen në rimorkion anësore të motoçikletës.

180.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që në mjet transporton persona në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 181

181.1. Shoferit nuk i lejohet transporti i personave në hapësirën e mbyllur të mjetit i cili nuk mundet të hapet nga brenda, përveç në mjetet e Shërbimit Policor të Kosovës, Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe atë vetëm për nevoja zyrtare.

181.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

181.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 1.500 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

#### Neni 182

182.1. Shoferi i biçikletës mbi moshën 18 vjet mund të bart personat mbi 8 vjet vetëm nëse në biçikletë gjinden ulëset e veçanta për çdo person, duke mbajtur për duar dhe këmbë, përkatësisht pedale.

182.2. Shoferi i biçikletës mbi 18 vjet mund të bartë fëmijët deri 8 vjet vetëm nëse në biçikletë është e montuar ulësja e veçantë e cila i përgjigjet madhësisë së fëmijës dhe është e përforcuar për biçikletë.

182.3. Shoferi i biçikletës, çiklomotorit dhe motoçikletës nuk i lejohet bartja e personave nën ndikim të alkoolit apo drogave.

182.4. Fëmijët më të ri se 12 vjet nuk lejohen të barten në çiklomotor dhe motoçikletë.

182.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

### Neni 183

183.1. Personat të cilët barten në mjet nuk i lejohej në asnjë mënyrë të pengoj shoferin në drejtimin e mjetit, ose të ndikojnë në shoferin gjatë drejtimit të mjetit, në atë mënyrë që do ta rrezikonte sigurinë në komunikacion.

183.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

### Neni 184

184.1. Shoferit të veturës nuk i lejohej që në ulëset e para ta bart personin i cili është nën ndikim të alkoolit ose drogave, fëmijët më të ri se 12 vjet, ndërsa në ulësen e prapme as fëmijën më të ri se 5 vjet, përveç kur në ulësen e prapme e ka të përforcuar ulësen e fëmijës, në të cilën fëmija duhet të jetë i lidhur ose nën mbikëqyrje të personit mbi 18 vjet.

184.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

### Neni 185

185.1. Gjatë kohës së lëvizjes së mjetit nuk lejohej që personat të kërcejnë, ti hapin dyert dhe të dalin me pjesë të trupit jashtë mjetit, të ulen në dritare (nëpër dasma ose ndonjë ceremoni të ngjashme), në pjesët e jashtme të mjetit ose në mjetet bashkangjitime të traktorit.

185.2. Përrjashtimisht, nga paragrafi 1 i këtij neni lejohej transporti i personave në pjesën e jashtme të mjetit të transportit dhe të rimorkios të cilët i kryejnë punët në mjetet speciale (shërbime të zjarrëfiksëve, pastruesit e qyteteve dhe të ngjashme) nëse në ato mjete është montuar platforma për të qëndruar në këmbë dhe për mbajtje dhe nuk i lejohej të lëvizni me shpejtësi më të madhe se 30 km/h.

185.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni. Gjoha prej 130 € i shqiptohet edhe shoferit të mjetit. Pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës duhen të identifikojnë personat në fjalë dhe i ndërmarrin veprimet e duhura edhe pas përfundimit të këtyre ceremonive.

185.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që e tejkalon shpejtësinë e lëvizjes më tepër se 10 km/h nga paragrafi 2 i këtij neni pa marr parasysh shpejtësinë e lëvizjes të lejuar apo të kufizuar.

### Neni 186

186.1. Në mjetet motorike dhe bashkëngjitime për transport të udhëtarëve në transportin publik urban me autobusë, përrjashtimisht nga neni 179 i këtij ligjit, lejohej transporti i personave edhe duke qëndruar në këmbë.

186.2. Në autobusët me të cilët bëhet transporti publik në komunikacionin ndër urban, mund të transportohen vetëm aq persona sa ka edhe ulëse të montuara në autobus.

186.3. Rimorkiot për bartjen e udhëtarëve mund ti bashkëngjiten vetëm mjeteve transportuese-autobusëve në komunikacionin urban.

186.4. Autobusët që përveç ulëseve ka vend për qëndrim në këmbë nuk janë të obliguar ta përdorin tahografin dhe të njëjtit nuk mund të lëvizin në relacion jashtë vijave urbane dhe urbano/periferike.

186.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 187

187.1. Udhëtarët nuk lejohet të dalin nga mjete për bartjen e personave, të kërcejnë nga ai, pa u ndalur mjete.

187.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 € udhëtari që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 188

188.1. Në mjetin transportues dhe rimorkion të cilat i tërheq traktori mund të bartën më së shumti 5 persona të cilët punojnë në ngarkimin dhe shkarkimin e ngarkesës si dhe kur kryhen punët bujqësore ose punët tjera.

188.2. Personi i cili nuk i ka mbushur 14 vjet lejohet të transportohet në mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm nëse përcjellët nga personi i moshës madhore.

188.3. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i lejohet të qëndrojnë në këmbë e as të ulën në anët e karoserisë ose në ngarkesë jo stabile.

188.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi i mjetit si dhe personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e të këtij neni.

#### Neni 189

189.1. Në mjetin transportues në hapësirën për vendosjen e ngarkesës ose në mjetin bashkëngjithës të cilin e tërheq traktori, në bazë të lejes së veçantë mund të barten më shumë se pesë persona të cilët punojnë në ngarkim dhe shkarkim ose punë të tjera, nga vendi i banimit deri te vendi i punës ose anasjelltas ose prej një vendi në vendin tjetër. Shoferi duhet ta ketë me vete lejen e veçantë dhe ta tregoj në rastin kur i kërkohet nga personat e autorizuar.

189.2. Transporti i personave në mjetin nga paragrafi 1 i këtij neni mund të lejohet edhe në raste tjera të arsyeshme.

189.3. Shërbimi Policor i Kosovës në konsultim me Ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me një akt nën ligjor do ti përcaktojnë kushtet dhe kriteret për marrjen e lejes së veçantë për mjetet, të cilat kryejnë transportin e organizuar të personave.

189.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e të këtij neni.

189.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

#### Neni 190

190.1. Në qoftë se në mjetin e transportit dhe rimorkio bartën shtazët, në ato mjete nuk lejohet transporti i personave.

190.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 191

Në rastin e evakuimit ose të dhënies së ndihmës gjatë fatkeqësive elementare në mjetin transportues ose rimorkio që tërheq traktori mund të behët transporti i personave edhe pa leje paraprake.

#### Neni 192

192.1. Në makinat e punës dhe në mjetin bashkangjites të cilat i tërheq mjeti, gjatë kohës së lëvizjes në rrugë lejohet të gjendet shoferi dhe përcjellësi.

192.2. Në motokultivator gjatë kohës së lëvizjes në rrugë lejohet të gjendet vetëm shoferi, ndërsa në mjetin bashkangjites që e tërheq motokulivatori lejohet të barten më së shumti tre persona të cilët punojnë në ngarkim ose shkarkim ose i kryejnë punët tjera.

192.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

192.4. Për kundërvajtje dënohet me gjobë prej 200 deri 550 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

#### Neni 193

193.1. Në komunikacionin rrugor ndalohet transporti i personave:

- a) në mjetin transportues i cili nuk i ka anësoret;
- b) në mjetin me shkarkues automatik, nëse nuk është i çkyçur;
- c) në mjetin bashkangjites për transport të ngarkesës të cilën e tërheq mjeti transportues.

193.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

193.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

## Neni 194

194.1. Mjetet që kryejnë punë për mirëmbajtjen e rrugëve duhet të lëshoj dritë sinjalizuese ngjyrë të verdhë.

194.2. Shoferi i mjetit të përmendur në paragrafin 1 nëse nuk pengon ose rrezikon komunikacionin mund të mos i zbatoi rregullat që kanë të bëjnë me lëvizjen në rrugë nëse:

- a) në rrugë njëkatëshe dhe jashtë zonave të banuar dhe gjatë pastrimit të borës, është e mundshme që mjeti të lëviz afër anës së majtë të rrugës në drejtim të lëvizjes;
- b) ngasja në trotuar lejohet vetëm nëse siguria e këmbësorëve është e siguruar.

194.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e të këtij neni.

194.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

## Neni 195

195.1. Shoferi i mjetit të përmendur në Nenin 194 mund të shfrytëzoj autostradën apo rrugën e rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike edhe nëse mjeti nuk është mjet motorik ose dizajni i tij nuk e bën të mundur që të zhvilloj shpejtësinë mbi 60 km/orë.

195.2. Mjeti, dizajni, ngarkesa e cila kalon kufijtë e lejuar dhe mund të rrezikon sigurinë në komunikacionin rrugor duhet të përdor dritën vezulluese ngjyrë të verdhë.

195.3. Ndalohet, që shoferi i mjetit për mirëmbajtje të rrugëve që të përdor drita vezulluese ngjyrë të verdhë për qëllime tjera përveç atyre të përshkruara në nenin 194 të këtij ligji.

195.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit për mirëmbajtjen e rrugëve i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

195.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

## Neni 196

196.1. Subjektit të cilit iu ka besuar mirëmbajtja e rrugëve detyrohet që ti marrë të gjitha masat e duhura për të mënjanuar pengesat në rrugë (bora, shembje gurësh, sende, etj) dhe i njëjti duhet ti respektoj urdhrat e personit të autorizuar i cili mbikëqyrë dhe rregullon komunikacionin rrugor.

196.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 40 €, shoferi i mjetit për mirëmbajtjen e rrugëve i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

196.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

### 30. RREGULLI DHE SIGURIA NË RRUGË

#### Neni 197

197.1. Shoferi gjatë ngasjes së mjetit duhet të mbaj me veti dokumentet si vijon:

- a) patentë shoferin;
- b) lejen e komunikacionit;
- c) autorizimin nëse nuk është pronar i mjetit, nëse përdoret si mjet komercial (taksi, auto-shkolla ose të ngjashme);
- d) polisën e sigurimit;
- e) certifikata e kualifikimit për raste të veçanta duke përfshirë licencën për shofer instruktor, certifikatën e ADR ose certifikata të tjera të përcaktuara me ligj;
- f) certifikatën e vlefshme shëndetësore, kur me ligj parashikohet posedimi i saj.

197.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 15 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 198

198.1. Shoferi dhe personi që transportohet në mjetin e pajisur me rripat e sigurisë duhet të përdorë rripin e sigurisë gjatë lëvizjes së mjetit, më kufizimin në Nenin 200 të këtij ligji. Nëse personi i cili bartet në mjet nuk i përdorë rripin e sigurisë, përgjegjësia bie mbi shoferin e mjetit, me përjashtim nëse personi i cili bartet në mjet është i moshës madhore.

198.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi respektivisht, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 199

Përjashtimisht nga neni 198 i këtij ligji detyrim për të përdorur rripin e sigurisë nuk zbatohet për:

- a) personin që posedon me certifikatë mjekësore që vërteton kundër-indikacione për përdorimin e rripave të sigurisë;
- b) gruan shtatzënë, kur shtatzënia shihet;
- c) instruktor- shoferin apo ekzaminerin gjatë aftësimin apo ekzaminimit;
- d) policin apo personelin tjetër të autorizuar gjatë transportimit të personave të arrestuar;
- e) personat për sigurimin e personave zyrtar (trup-rojet);
- f) personelin e shërbimit mjekësor gjatë ndihmës së parë dhe aktiviteteve emergjente;
- g) rojën që është duke bartur një shumë të konsiderueshme të parave të gatshme;
- h) personin e sëmurë apo të marrë që bartet në lesë apo ulëseve të invalidëve;
- i) në mjetin e pajisur më rripa të sigurisë, fëmija i moshës deri 12 vjeçare.

### 31. VENDOSJA E SHENJAVE, DEKORACIONEVE SI DHE PËRKUJDESJA NDAJ MJETIT

#### Neni 200

200.1. Ndalohet:

- a) të përdoret mjete në mënyrë që do të rrezikonte sigurinë e personit i cili bartet në mjet;
- b) të mbuloj dritat apo mekanizmat tjerë sinjalizues, tabelat e regjistrimit, dhe tabelat apo shenjat tjera të cilat kërkohen që të jenë të dukshme;
- c) të vendos dekorime shtesë në tabela apo vend të regjistrimit, përpara dhe prapa, shenja, tekste apo objekte që do të mund të kufizonin leximin e këtyre tabelave;
- d) të vendos në mjet shenjen e një vendi të huaj nga ai në të cilin është licencuar;
- e) të vendos xhamat e errët në mjet.

200.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 201

201.1. Ndalohet:

- a) vendosja, brenda dhe jashtë mjetit, të çdo sendi i cili mund të shkakton dëm personave që barten në mjet ose pjesëmarrësve tjerë të komunikacionit;
- b) të shfrytëzohen në mjet çfarëdo pjesë shtesë ose pjesë që nuk është në përputhje me rregullat e akteve ligjore përkatëse.

201.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 202

202.1. I ndalohet shoferit:

- a) të largohet nga mjeti kur motori është i ndezur;
- b) të shfrytëzoj mjetin në mënyrën e cila shkakton probleme si pasojë e lëshimit të tepruar të tymit në mjedis apo zhurmë të tepërt se sa është e paraparë me rregulla;
- c) të lerë motorin ndezur gjatë parkimit brenda zonës së banuar. Kjo rregull nuk zbatohet për mjetet për mirëmbajtjen e rrugëve;
- d) të tërheq prapa mjetit personin në skia, sajë, roleta, dërrasën për skijim apo pajisje të ngjashëm;
- e) të përdor mjetin me gomat me elemente të përhershme kundër rrëshqitjes;
- f) përdorimi i zinxhirëve të borës kur rruga nuk është mbuluar nga bora.

202.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## 32. NGASJA PROVUESE

### Neni 203

203.1. Për ngasje provuese për shkak të testimit të prodhimit ose riparimit të mjeteve motorike duhet të mënjanohej disa nga rregullat e sigurisë së komunikacionit në rrugë dhe duhet leja e veçantë.



203.2. Lejen e veçantë nga paragrafi 1 i këtij neni e lëshon Shërbimi Policor i Kosovës në territorin e të cilit kryhet ngasja provuese.

203.3. Në lejen e veçantë përcaktohen cilat masa të sigurisë duhet ti ndërmerr organizatori në shpenzimet e veta dhe shënohet emri i personit i cili duhet të gjendet në mjet gjatë kohës së ngasjes provuese.

203.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i mjetit që vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

203.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni.

## KAPITULLI I VI

### 1. DETYRAT NË RAST AKSIDENTIT TË KOMUNIKACIONIT

#### Neni 204

Personi i cili haset ose has në vendin e aksidentit të komunikacionit, në të cilën ka persona të lënduar, ka për detyrë t'u jap ndihmë personave të lënduar në aksident të komunikacionit.

#### Neni 205

205.1. Pjesëmarrësi në aksident të komunikacionit, në të cilën dikush ka humbur jetën ose është lënduar apo është krijuar një dëm i madh material, ka për detyrë:

- a) të rrijë në vendin e aksidentit të komunikacionit, por që mund të largohet përkohësisht vetë për tu ofruar ndihmë personave të lënduar në aksident të komunikacionit apo në çoftë se vet atij i nevojitet ndihma mjekësore përkatësisht për ta njoftuar Shërbimin Policor të Kosovës;
- b) të ndërmarrë krejt çka mundet që të mënjanohen rreziqet e reja, që mund të krijohen në vendin e aksidentit të komunikacionit, të mundësohet një rrjedhë normale e komunikacionit, të bëhen përpjekje që të mos ndërrohet gjendja në vendin e aksidentit dhe të ruhen gjurmët ekzistuese, me kusht që ndërmarrja e atyre masave të mos rrezikojë sigurinë e komunikacionit;
- c) të njoftoj për aksidentin e komunikacionit Shërbimin Policor të Kosovës dhe të kthehet në vendin e aksidentit të komunikacionit dhe të pret ardhjen e personave të autorizuar, të cilët bëjnë ekzaminimin e vendit të aksidentit.

205.2. Personi, i cili është njoftuar për aksidentin e komunikacionit, në të cilën është lënduar ndonjë personi, ka për detyrë që të njoftoj menjëherë institucionet shëndetësore dhe Shërbimin Policor të Kosovës ose stacionin policor më të afërt.

205.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 €, shoferi që është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në aksident dhe i cili nuk ndalet në vendin e aksidentit të komunikacionit në rrugë dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit e drejtuarit të mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje së paku deri në gjashtë muaj si dhe pesë pikë negative.

#### Neni 206

206.1. Shoferët, pjesëmarrësit e aksidentit të komunikacionit, në të cilën është shkaktuar një dëm më i vogël material në mjete, kanë për detyrë që menjëherë të mënjanojnë mjetet

nga rruga, të mundësojnë zhvillim të papenguar të komunikacionit, të plotësojnë dhe të nënshkruajnë “Informacionin evropian” të aksidentit apo në ndonjë mënyrë tjetër të shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për mjet.

206.2. Shoferët, nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk duhet të lënë vendin e aksidentit të komunikacionit derisa të mos e kenë plotësuar dhe nënshkruar “Informacionin evropian” apo në ndonjë mënyrë tjetër derisa ti shkëmbejnë të dhënat personale dhe të dhënat për mjetet.

206.3. Në rast të aksidentit të komunikacionit me një dëm më të vogël material, kur në vendin e aksidentit nuk ndodhet pronari i mjetit ose pronari i një sendi tjetër të dëmtuar, shoferi ka për detyrë që pronarit të mjetit ose të një sendi tjetër të dëmtuar ti lë të dhënat për vetën dhe për mjetin me të cilin ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit.

206.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

206.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit e mjetit me veprim motorik në kohëzgjatje së paku tre muaj dhe tri pikë negative.

206.6. Informacionin Evropian të aksidentit e harton Shërbimi Policor i Kosovës në bashkëpunim me Ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe i jepet pronarit të çdo mjeti motorik nga qendra e regjistrimit të mjeteve motorike.

#### Neni 207

207.1. Shoferi, i cili ka marrë pjesë me mjet në aksidentin e komunikacionit, në të cilën ka të vdekur ose persona të lënduar e edhe personi tjetër, i cili ka marrë pjesë drejtpërdrejt në aksidentin e tillë, kanë të drejt të kërkojnë të dhënat personale dhe adresën nga personat, të cilët kanë qenë të pranishëm, kur ka ndodhur aksidenti.

207.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 208

208.1. Shoferi i cili haset ose has në vendin e aksidentit të komunikacionit, ka për detyrë me kërkesën e personit të autorizuar, ta dërgojë personin, i cili është lënduar në aksidentin e komunikacionit, deri në institucionin më të afërt shëndetësorë.

208.2. Shoferi ka për detyrë të veproj sipas rregullës së paragrafit 1 të këtij neni edhe para se të vijë personi i autorizuar, përveç në çoftë se ka ndodhur aksidenti në vendin në të cilin mund të pritët ardhja e shpejtë e mjetit të ndihmës së shpejtë apo në çoftë se shoferi konstaton se me mënyrën joprofesionale dhe jo përkatëse të bartjes gjendja e personit të lënduar mund të përkeqësohet.

208.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Neni 209

209.1. Në çoftë se institucioni shëndetësorë është njoftuar për aksidentin e komunikacionit apo ka pranuar për ta shëruar personin që është lënduar në aksident, ka për detyrë që për këtë ta njoftoj menjëherë Shërbimin Policor të Kosovës.

209.2. Në çoftë se personi i lënduar në aksidentin e komunikacionit, vdes nga lëndimet e marra, institucioni shëndetësor ka për detyrë që për këtë të njoftoj Shërbimin Policor të Kosovës.

209.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 1.500 €, institucioni shëndetësor nëse nuk e lajmëron Shërbimin Policor të Kosovës për të lënduarit ose të vdekurit në aksidentin e komunikacionit rrugor në pajtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni. Në këtë rast, me gjobë prej 100 deri 300 €, dënohet edhe personi përgjegjës në institucionin shëndetësor.

## Neni 210

210.1. Në çoftë se mjeti, për shkak të aksidentit në komunikacion, është paaftësuar për lëvizje të mëtejme në rrugë, shoferi a pronari, përkatësisht përdoruesi i mjetit ka për detyrë që mjetin, ngarkesën, sendet ose ndonjë material tjetër të derdhur në rrugë, ta mënjanojë nga rruga e pasi të urdhëroj apo të lejojë personi i autorizuar, i cili bën ekzaminim në vendin e ngjarjes.

210.2. Në çoftë se shoferi, pronari, përkatësisht përdoruesi i mjetit nuk është në gjendje të vepron sipas paragrafit 1. të këtij neni, personi i autorizuar, i cili hasët në vendin e aksidentit apo në vendin ku ndodhet mjeti defekt, do të urdhëroj autoritetet kompetente të mirëmbajtjes së rrugëve që ta zhvendosë nga rruga mjetin, ngarkesën, sendet apo ndonjë material tjetër të derdhur në një vend të sigurt.

210.3. Personi i mirëmbajtjes së rrugëve, me të cilën autoritetet për sigurinë në komunikacionin rrugor, kanë lidhur kontratë për zhvendosjen e mjeteve, ka për detyrë që të ndërmarr urgjentisht të gjitha masat e nevojshme për zhvendosjen dhe ruajtjen e mjeteve me ngarkesë, sendeve apo materialit tjetër të derdhur nga rruga dhe të siguroj kalueshmërinë e rrugës.

210.4. Në çoftë se personi përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve nuk vepron sipas rregullave të paragrafit 3. të këtij neni, e për shkak të pa aftësisë së veprimit të mjeteve ose pengesave në rrugë, të krijuara nga ngarkesa, sende ose material tjetër bëhet e pamundshme lëvizja për pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, personi i autorizuar do të ndërmarrë masa të reja përkatëse për t'u mundësuar një rrjedhë normale të komunikacionit.

210.5. Shpenzimet e zhvendosjes e të ruajtjes së mjeteve, ngarkesave, sendeve ose të një materiali tjetër, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera përkatëse nga paragrafi 4 i këtij neni, i heq autoriteti kompetent i mirëmbajtjes së rrugëve, ata kanë të drejtë kompensimi prej atij që i ka shkaktuar.

210.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 1.500 €, personi që është përgjegjës për mirëmbajtjen e rrugëve, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

210.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, personi që nuk vepron sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 211

211.1. Polici i cili bën ekzaminimin e vendit të aksidentit të komunikacionit në të cilën është krijuar dëmi material, do të detyroj ti nënshtrohen kontrollimit me mjete dhe me aparate përkatëse matëse, pjesëmarrësit e drejtpërdrejt të aksidentit të komunikacionit, sipas rregullave, për ti kontrolluar se a kanë në organizëm alkool apo droga narkotike. Në çoftë se konstatohet me atë kontrollim se shoferi pjesëmarrësi i drejtpërdrejt i aksidentit ka në organizëm alkool apo droga narkotike, e këtë e mohon, polici do ta shpie në institucionin shëndetësorë për kontrollim mjekësor, përkatësisht për dhënien e gjakut dhe të urinës, me qëllim analize.

211.2. Në çoftë se, në aksidentin e komunikacionit, ka persona të lënduar, polici i cili bën ekzaminimin e vendit të aksidentit të komunikacionit, do t'ia nënshtroj pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të aksidentit hulumtimin (kontrollimin) në mënyrën siç është përcaktuar me paragrafin 1, të këtij neni. Në çoftë se me atë hulumtim konstatohet se shoferët ose pjesëmarrësit e drejtpërdrejt të aksidentit të komunikacionit, kanë në organizëm alkool droga narkotike, polici do të caktojë kontrollimin mjekësor përkatësisht dhënien e gjakut dhe urinës, me qëllim analize.

211.3. Në çoftë se në aksident komunikacioni ka të vdekur, polici i cili bën ekzaminimin në vend, do të caktojë që shoferët, pjesëmarrës të drejtpërdrejt të aksidentit, të japin gjakun dhe urinën, në mënyrë që të konstatohet se a kanë në organizëm alkool apo droga narkotike, kurse për pjesëmarrësit e tjerë të aksidentit pasi të konstatohet prania e alkoolit ose e drogave narkotike në organizëm, me mjete ose aparate përkatëse.

211.4. Në rastet nga paragrafët 1, 2 e 3 të këtij neni, mjeku mund të vendos që të mos jepen gjaku dhe urina, në çoftë se për këtë shkak u janë paraqitur pasoja të dëmshme për shëndetin pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit.

211.5. Personat nga paragrafët 1, 2 e 3 të këtij neni, që nga momenti i krijimit të aksidentit të komunikacionit e deri kur të zbatohet për ta procedura e hulumtimit nga nenet 1, 2 e 3, nuk duhet të marrin pije alkoolike, droga narkotike e as medikamente mbi të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet për t' i përdorur para e as gjatë ngasjes.

211.6. Personi për të cilin, me hulumtimin në njërin nga mënyrat e caktuara me këtë nen, është konstatuar se ka në organizëm alkool ose droga narkotike, i heq shpenzimet e hulumtimit, kurse personi nga paragrafi 1 i këtij neni i heq edhe shpenzimet e dërgimit me mjet zyrtar policie në kontrollim mjekësor dhe për dhënien e gjakut dhe urinës për analizë.

211.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 95 € shoferi, përkatësisht pjesëmarrësi në komunikacion, i cili vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 5 të këtij neni, ndërsa shoferit i shqiptohet masa e ndalimit e drejtuarit e mjetit me veprim motorik deri gjashtë muaj dhe dy pikë negative.

## Neni 212

212.1. Shërbimi Policor i Kosovës, ka për detyrë të dal në vendin e aksidentit të komunikacionit, për të cilën janë njoftuar (lajmëruar).

212.2. Zyrtari i Shërbimit Policor të Kosovës i cili bën ekzaminimin në vend, ka për detyrë të organizojë regjistrimin e pasurisë që mbetet në vendin e ngjarjes nga personi i cili ka vdekur ose është lënduar rënd në aksident komunikacioni, të njoftojë organizatën, e cila mënjanon mjetin dhe sendet nga rruga, dhe të ofrojë ndihmë për të mbrojtur pasurinë, në çoftë se në vendin e ngjarjes nuk është personi, i cili mund ta rimerr atë pasuri.

## KAPITULLI VII MANIFESTIMET SPORTIVE DHE AKTIVITETET E TË TJERA NË RRUGË

### Neni 213

213.1. Manifestimet sportive dhe manifestimet e tjera ose aktivitetet e ngjashme në rrugë nuk duhet të mbahen pa leje. Lejen e jep stacioni policor, në rajonin e së cilës mbahet manifestimi ose bëhet aktiviteti.

213.2. Në qoftë se një manifestim sportiv a manifestim tjetër mbahet ose një aktivitet bëhet në rrugë në rajonin e dy a më shumë stacioneve policore, lejen e jep Shërbimi Policor i Kosovës.

213.3. Në qoftë se, me qëllim mbajtjeje të manifestimit a të bërjes së aktiviteteve në rrugë, ndalohet qarkullimi, lejen, me pëlqim paraprak, e jep organi kompetent, në rajonin e të cilit ndalohet qarkullimi, ndërsa në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni - me pëlqim të Ministrisë së Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit.

213.4. Përgjashtimisht nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni për manifestimet sportive dhe manifestimet e aktivitetet e tjera në rrugë, që mbahen në kushte të një zhvillimi normal të qarkullimit, nuk ka nevojë për leje.

213.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 700 €, organizatori i manifestimeve sportive dhe aktiviteteve të tjera rrugë, nëse manifestimi ose aktiviteti sportiv mbahet në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

### Neni 214

214.1. Në rastin nga neni 213 paragrafi 3, të këtij Ligji, në qoftë se nuk është siguruar rruga tjetër për pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, kërkesa do të refuzohet.

214.2. Përgjashtimisht nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, mbajtja e garës së automobilistëve, e motoçiklistëve apo e biçiklistëve në rrugë mund të lejohet edhe kur në drejtimin e caktuar rrugor nuk ka rrugë tjetër (garat kodrinore etj), por vetëm në kohën kur pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion në atë rrugë lëvizin më së paku. Në atë rast komunikacioni mund të ndalohet më së shumti dy orë.

### Neni 215

215.1. Kërkesa për dhënien e lejes paraqitet më së voni 30 ditë para se të mbahet një manifestim sportiv a manifestim tjetër ose të bëhen aktivitetet.

215.2. Kërkesës për dhënien e lejes medoemos duhet bashkëngjitur programin e manifestimit, përkatësisht të aktiviteteve, rregullat e garave, pasqyrën e masave që organizatori i parasheh për sigurimin e pjesëmarrësve në komunikacion, pjesëmarrësve dhe shikuesve të manifestimit sportiv e të ndonjë manifestimi tjetër ose të aktiviteteve dhe shenjën me të cilën mjetet, të përcjella nga garuesit, do të shënohen.

### Neni 216

216.1. Kërkesa për mbajtjen e manifestimit sportiv a të ndonjë manifestimi tjetër ose për bërjen e aktiviteteve në rrugë, do të refuzohen, në qoftë se organizatori, sipas gjykimit të organit kompetent respektivisht Shërbimit Policor të Kosovës, nuk është në gjendje të zbatojë masat nga neni 60, paragrafi 2, të këtij Ligji.

216.2. Në qoftë se, për shkak të mbajtjes së manifestimit sportiv a të një manifestimi tjetër ose të bërjes së aktiviteteve në rrugë, do të duhej ndaluar qarkullimin në drejtimet më të rëndësishme të komunikacionit apo me manifestimin, përkatësisht me aktivitetin do të rrezikohet në masë të madhe ose do të pengohet komunikacioni rrugor, kërkesa për dhënie të lejes mund të refuzohet.

#### Neni 217

217.1. Në lejen për mbajtjen e manifestimit sportiv a të një manifestimi tjetër ose për bërjen e aktiviteteve në rrugë, caktohen masat e sigurimit që duhet t'i ndërmerret organizatori.

217.2. Kur kufizohet ose ndalohet qarkullimi në rrugë për të mbajtur manifestimin ose për të bërë aktivitetin, leja përmban edhe obligimin e organizatorit që, për masat e kufizimit ose të ndalesës së qarkullimit, të njoftojë opinionin me mjete të komunikimit publik, më së voni 48 orë para se të fillojë manifestimi, përkatësisht aktiviteti.

#### Neni 218

218.1. Organizatori nuk duhet të fillojë të mbajë manifestimin sportiv a ndonjë manifestim tjetër ose aktivitetin në rrugë, në qoftë se nuk janë ndërmarrë të gjitha masat e sigurimit, të caktuara në leje.

218.2. Në qoftë se konstatohet se organizatori nuk ka ndërmarrë të gjitha masat e sigurimit, të caktuara në leje, manifestimi, përkatësisht aktiviteti do të ndalohet.

#### Neni 219

219.1. Organizatori ka për detyrë të ndërpres mbajtjen e manifestimit sportiv dhe të ndonjë manifestimi tjetër, përkatësisht të aktivitetit në rrugë:

- a) në qoftë se janë rrezikuar pjesëmarrësit ose shikuesit;
- b) në qoftë se prishet rendi dhe qetësia publike në masë të madhe;
- c) në qoftë se fillojnë rrethana për shkak të cilave manifestimi, përkatësisht aktiviteti nuk do të lejohej;
- d) në qoftë se organizatori nuk zbaton masa të caktuara sigurimi;
- e) në qoftë se këtë e kërkojnë arsye të tjera sigurie.

219.2. Në qoftë se organizatori nuk e ndërprente manifestimin, përkatësisht aktivitetin në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, Shërbimi Policor i Kosovës, përkatësisht stacioni policor do t'i urdhërojë organizatorit që manifestimin, përkatësisht aktivitetin ta ndërpresë dhe të ndërmerret masat e nevojshme që urdhëresa të kryhet.

219.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 700 €, organizatori i manifestimeve sportive dhe aktiviteteve të tjera rrugë, nëse nuk i ndërprente manifestimet ose aktivitetet sportive dhe nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 220

220.1. Vetëm mjetet, të shënuara me shenjë të veçantë, që e përcakton organizatori, mund të ndjekin garuesit e manifestimit sportiv në rrugë.

220.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që përcjell manifestimet ose aktivitet sportive në rrugë pa e shënuar mjetin në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

220.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 700 €, organizatori i manifestimeve sportive dhe i aktiviteteve të tjera në rrugë nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 221

221.1. Pas përfundimit të manifestimit sportiv apo të një manifestimi tjetër, përkatësisht të aktivitetit në rrugë, organizatori ka për detyrë menjëherë:

- a) të mënjanojë nga rruga të gjitha shenjat e komunikacionit dhe shenjat e tjera, mekanizmat, sendet e objektet që janë vënë për të mbajtur manifestimin, përkatësisht për të bërë aktivitetin;
- b) të vë në rrugë të gjitha shenjat e komunikacionit dhe shenjat e tjera, sendet dhe objektet që kanë qenë të mënjanuara për të mbajtur manifestimin, përkatësisht për të bërë aktivitetin;
- c) të ndreqë dhe të sjell në gjendjen e mëparshme rrugën dhe objektet rrugore, në qoftë se janë dëmtuar gjatë mbajtjes së manifestimit, përkatësisht bërjes së aktivitetit.

221.2. Në qoftë se organizatori nuk vepron sipas pikave a) dhe b) të paragrafit 1 të këtij neni, Shërbimi Policor i Kosovës, përkatësisht stacioni policor, do të ndërmerr masa përkatëse që me shpenzime të organizatorit të mënjanohen, përkatësisht të vihen shenjat e komunikacionit dhe shenjat e tjera, sendet dhe objektet në rrugë.

221.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 700 €, organizatori i manifestimeve sportive dhe aktiviteteve të tjera në rrugë, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

### KAPITULLI VIII KUFIZIMI I KOMUNIKACIONIT

#### Neni 222

222.1. Gjatë kushteve dimërore në rrugë ndalohet komunikacioni i mjeteve motorike dhe mjeteve transportuese bashkëngjitëse të cilat nuk posedojnë pajisjet dimërore.

222.2. Kushtet dimërore në rrugë janë të atilla, ku rruga është e mbuluar me borë ose kur në rrugë ka akull.

222.3. Në kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, autobusi dhe mjeteve transportues, duhet së paku në njërin bosht të reparitit ti kenë zinxhirët për borë. Veturat duhet të jetë e pajisur me pajimet dimërore të parapara.

222.4. Përjashtimisht nga rregullat e paragrafit 2 të këtij neni, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, përkatësisht Kuvendet Komunale mundën për kohë të caktuar dhe për rrugë të caktuara ti urdhëroj në posedimin e obligueshëm të pajisjeve dimërore, për disa kategori ose lloj të mjeteve, pa marr parasysh se në ato rrugë a ekzistojnë (janë) kushtet dimërore.

222.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, personi që urdhëron, lejon ose e lëshon në komunikacionin rrugor mjetin pa pajisjet dimërore të parapara në këtë nen.

222.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që drejton mjetin i cili nuk i ka pajisjet dimërore të parapara në këtë nen.

#### Neni 223

223.1. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, përkatësisht Kuvendet Komunale mundën për rrugë të caktuar dhe për ditët e caktuara, të urdhërojnë ndalimin ose kufizimin e të gjithave mjeteve ose disa llojeve të mjeteve, të kufizojnë shpejtësinë e lëvizjes nëse ndalimi ose kufizimi është i domosdoshëm për të parandaluar ose mënjanuar rrezikun për pjesëmarrësit në komunikacion, për zhvillimin e papenguar të komunikacionit, nëse komunikacioni do të jetë i dendur ose i vështirësuar.

223.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € personi që merr pjesë në rrugë ose një pjesë të saj në ditët e caktuara ose në periudhë të caktuar ku është e urdhëruar ndalimi ose kufizimi i të gjitha mjeteve ose disa lloj të mjeteve në pajtueshmëri me rregullat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 224

Në raste kur siguria dhe rrjedha e komunikacionit kërkohet të jetë në nivel ose në raste të jashtëzakonshme Shërbimin Policor i Kosovës, mund ta ndaloj komunikacionin ose të urdhëroj kufizim të veçantë të komunikacionit në rrugë të caktuar ose pjesë të rrugëve gjatë kohës derisa të ekzistojnë kushtet për shkak të cilave janë ndërmarr këto masa.

### KAPITULLI IX SHOFERËT

#### 1. KUSHTET PËR DREJTIMIN E MJETIT

#### Neni 225

225.1. Mjetin me veprim motorik në komunikacionin rrugor mund t'ia drejtoj në mënyrë të pavarur vetëm personi i cili posedon patentë shoferin e vlefshëm patentë shoferin e një vendi të huaj, ose patentë shoferin ndërkombëtar.

225.2. Shoferi ka të drejtë ti drejtoj vetëm ato kategori të mjeteve të cilat janë të shënuara në patentë shofer.

225.3. Shoferi gjatë kohës së drejtimit të mjetit me veprim motorik duhet t'i shfrytëzoj mjetet ndihmëse të cilat janë të regjistruara (shënuara) në patentë shofer.

225.4. Shoferit të mjetit motorik gjatë kohës së ngasjes nuk i lejohet përdorimi i telefonit të dorës (mobil) e as pajime të tjera të cilat do ta zvogëlonin mundësin e reagimit dhe ngasjes së sigurt të mjetit.

225.5. Telefoni i dorës (mobil) mund të shfrytëzohet gjatë ngasjes nëse përdorimi bëhet pa i përdorur duart.

225.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 400 € shoferi i cili nuk ka patentë shoferin e vlefshëm, i cili e ka të ndaluar drejtimin e mjetit ose që nuk e ka patentë shoferin për kategorinë përkatëse.

225.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i cili shfrytëzon telefonin e dorës në kundërshtim me rregullat e paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni.



## Neni 226

226.1. Shoferi i cili drejton mjetin me veprim motorik në komunikacionin rrugor duhet të jetë i aftë në pikëpamje fizike dhe psikike t'ia drejtojë mjetin me veprim motorik dhe për këtë të ketë njohuri dhe shkathtësi të nevojshme.

226.2. Ndalohet ta drejtojë mjetin në komunikacionin rrugor shoferi që është i lodhur, i sëmur ose që ndodhet në një gjendje të tillë psikike saqë është i pa aftë për ta drejtuar mjetin në mënyrë të sigurt, si dhe shoferi që është nën ndikimin narkotikëve, barnave dhe substancave në të cilat është shënuar se ndalohet përdorimi i tyre para ose gjatë kohës së drejtimit të mjetit në komunikacionin rrugor.

226.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtuarit e mjetit me veprim motorik prej tre muaj dhe dy pikë negative.

## Neni 227

227.1. Shoferit nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në komunikacionin rrugor, nëse është nën ndikim të alkoolit dhe nëse përmbajtja e alkoolit në gjak është më e madhe se 0.5 gr/lit. ose mg/ml.

227.2. Përmbajtja e alkoolit në organizëm përcaktohet me analizat e gjakut dhe urinës, matjen e sasisë së alkoolit në litër me fryrjen e ajrit, me kontroll mjekësorë dhe me metoda dhe aparate të tjera.

227.3. Konsiderohet se shoferi ka në organizëm droga nëse përmbajtja e drogave vërtetohet me mjete ose pajisje gjegjëse, me kontroll mjekësorë ose me analizë të gjakut ose gjakut dhe urinës.

227.4. Konsiderohet që shoferi ka filluar ta drejtoj mjetin nëse ka lëvizur nga vendi.

227.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 deri 130 €, shoferi nëse ka në organizëm alkool mbi 0,5 gr/lit, dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtimit të mjetit me veprim motorik në kohë zgjatje së paku gjashtë muaj dhe pesë pikë negative.

## Neni 228

228.1. Shoferi i cili e ka profesion themelor të drejtuarit e mjetit motorik nuk lejohet të konsumoj alkool në organizëm:

- a) shoferi i mjeteve motorike të kategorive C1, C, D1, D, C1+E, C+E, D1+E, D+E derisa e drejton mjetin motorik të këtyre kategorive;
- b) shoferi i mjetit me të cilin kryhet transportimi publik;
- c) shoferi-instruktor derisa aftëson kandidatin për shofer në pjesën praktike të aftësimit për drejtimin e mjetit me veprim motorik;
- d) kandidati për shofer gjatë kohës së aftësimit;
- e) Shoferi i mjeteve me përparësi kalimi dhe atyre nën përcjellje, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.

228.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 270 €, shoferi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nëse ka alkool në organizëm dhe njëkohësisht i shqiptohet masa e ndalimit të drejtimit të mjetit me veprim motorik në kohë zgjatje së paku një vit dhe pesë pikë negative.

## 2. AFTËSIMI I KANDIDATËVE PËR SHOFER

### Neni 229

229.1. Aftësimin e kandidatëve për shoferë të mjeteve me veprim motorik e kryejnë auto shkollat të cilat i licencen Ministria e Transportit dhe Post-telekomunikacionit, pasi t'i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara për licencim.

229.2. Kushtet dhe kriteret për licencim të auto shkollës i përcakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, me një akt të veçantë juridik nënligjor.

229.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, personi që urdhëron ose lejon që të bëhet aftësimi i kandidatëve për shofer pa licencën e vlefshme të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

229.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € edhe shoferi instruktori që bënë aftësimin e kandidatëve për shofer pa licencë të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

### Neni 230

230.1. Aftësimi i kandidatëve për shofer është program mësimor unik i cili përfshinë lëndet mësimore: rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë, të drejtuarit e mjetit me veprim motorik dhe dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident komunikacioni.

230.2. Aftësimin e kandidatëve nga lëndët mësimore rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë si dhe të drejtuarit të mjetit me veprim motorik e kryejnë auto shkollat.

230.3. Aftësimi i kandidatëve për shoferë nga lënda mësimore dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksidente të komunikacionit rrugor organizohet nga institucioni të cilin e autorizon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

230.4. Plan programin për aftësimin e kandidatëve për shoferë e cakton me një akt të veçantë juridik Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në konsultim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

### Neni 231

231.1. Auto shkollat mund të zhvillojnë aftësimin e kandidatëve për shoferë nëse kanë të siguruar:

- a) ligjëruesin profesional, punëtorin administrativ dhe numrin e nevojshëm të shoferë-instrukturëve me kontratë pune me orar të plotë, i nevojshëm për realizimin e planit mësimor dhe programit të aftësimin të kandidatëve;
- b) mjetet mësimore dhe ndihmësi si dhe pajimet të cilat mundësojnë aftësimin normal të kandidatëve për shofer;
- c) mjetet e asaj kategorie me të cilat bëhet aftësimi;
- d) lokale, poligon ose ndonjë hapësirë jashtë rrugës publike së paku 350 m<sup>2</sup> - të cilat mund të jenë në pronësi apo me qira.

231.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, personi që urdhëron ose lejon që të bëhet aftësimi i kandidatëve për shofer në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

## Neni 232

232.1. Mësimin nga lënda rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë (pjesa teorike) e zhvillon ligjëruesi profesional.

232.2. Ligjëruesi nga paragrafi 1i këtij neni duhet të jetë personi që e ka së paku përgatitjen e lartë shkollore dhe posedon patentë shoferin e kategorisë “B“ së paku tri vite.

232.3. Aftësimin e kandidatëve për shofer nga lëndët mësimore, të drejtuarit e mjetit me veprim motorik (pjesa praktike) e realizon shoferi instruktur.

232.4. Shofer Instruktori është personi i cili posedon patentë shoferin dhe licencën e vlefshme për shofer instruktur për kategorinë përkatëse.

232.5. Aftësimin e kandidatëve nga lënda dhënia ë ndihmës së parë personave të lënduar në aksident e realizon institucioni i autorizuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë.

232.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 500 deri 1.100 €, personi që urdhëron ose lejon që të bëhet aftësimi i kandidatëve në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

232.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, edhe personi fizik që e bënë aftësimin e kandidatëve për shofer në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

## Neni 233

233.1. Licencën për ligjëruesin profesional dhe për shofer instruktur e lëshon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, ndërsa për ligjëruesin nga lënda mësimore “Dhënia e ndihmës së parë” personave të lënduar në aksident komunikacioni e bën institucioni të cilin e autorizon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë.

233.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 500 deri 1.100 €, personi që urdhëron ose lejon që të bëhet aftësimi i kandidatëve pa licencë vlefshme të lëshuar nga Institucioni të cilin e autorizon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

233.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi i cili bënë aftësimin e kandidatëve për shofer pa licencë të vlefshme ose i cili nuk e ka licencën përkatëse për kategorinë e mjetit me të cilën bëhet aftësimi i kandidatit për shofer.

## Neni 234

234.1. Aftësimi i kandidatëve do të fillojë jo më herët se 3 muaj para se të arrijë moshën e duhur për të marr patentë shoferin të një kategorie të caktuar, ndërsa provimit për shofer i nënshtrohet vetëm kur ti mbushë vjetët e parapara me këtë ligj.

234.2. Për kundërvajtje dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, personi që urdhëron ose lejon që të bëhet aftësimi i kandidatëve pa e mbushur moshën e paraparë me ligj.

234.3. Për kundërvajtje dënohet me gjobë prej 130 €, shofer instruktur që bënë aftësimin e kandidatëve për shofer pa i mbushur moshën e paraparë me ligj.

## Neni 235

235.1. Gjatë kohës së aftësimit të kandidatit për shofer në drejtim të mjetit në rrugë, shofer instruktori duhet të ketë me veti licencën për shofer instruktor të kategorisë përkatëse në të cilin zhvillohet aftësimi, patentë shoferin dhe duhet t'i tregoj në kërkesë të personit të autorizuar.

235.2. Gjatë kohës së drejtimit të mjetit, kandidati për shoferë duhet të ketë me veti librezën e kandidatit, certifikatën mjekësore se është i aftë në pikëpamje psikike dhe fizike për ta drejtuar mjetin dhe është i detyruar ato t'i tregojë me kërkesën e personit të autorizuar.

235.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shofer instruktori i cili vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

## Neni 236

Kandidati i cili aftësohet nga pjesa praktike përgatitet për dhënien e provimit për shofer dhe para se ta ketë dhënë provimin për shofer mund ta drejtojë në rrugë mjetin e asaj kategorie për të cilin e përgatitë provimin, në qoftë se mjetin e drejton nën mbikëqyrjen e shofer instruktorit.

## Neni 237

237.1. Mjeti me të cilin në rrugë bëhet aftësimi i kandidatëve për shoferë në drejtimin praktik të mjetit duhet të shënohet me shenje të posaçme, sipas standardeve të Unionit Evropian.

237.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shofer instruktori i cili bënë aftësimin e kandidatëve për shofer me mjetin që nuk e ka shenjën e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

## Neni 238

238.1. Gjatë kohës së aftësimit nga lënda mësimore të drejtuarit e mjetit me veprim motorik në komunikacion rrugor, në mjet mund të gjinden më së shumti 1 kandidat dhe shofer instruktori dhe në raste të caktuara në mjet mund të gjendet edhe personi i autorizuar për mbikëqyrjen e punës së auto-shkollës.

238.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shofer instruktori që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 239

239.1. Kandidati i cili ka përfunduar me sukses aftësimin sipas plan programit, për shoferë i lëshohet vërtetimi.

239.2. Kandidati i cili brenda 2 viteve nga data e regjistrimit nuk e jep provimin për shofer duhet të përsërit aftësimin.

239.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, personi që lëshon vërtetimin pa e përfunduar me sukses aftësimin për shofer.

#### Neni 240

240.1. Shkollën për shofer-instruktur e licencën Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me Ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

240.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me Ministrin e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me një akt të veçantë juridik përcaktojnë kushtet dhe kriteret për licencimin e shoferë - instruktorëve.

#### Neni 241

Provimet për shoferë-instruktur nga lënda rregullat dhe siguria në komunikacion (pjesa teorike) dhe lënda të drejtuarit e mjetit me veprim motorik (pjesa praktike) Testi final bëhet nga pyetësit të cilët i cakton dhe i ka licencuar Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe kandidatet të cilët tregojnë rezultate pozitive, pajisen me licenca për shofer-instruktur.

#### Neni 242

Verifikimi i njohurive të shofer instruktorit e bën Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, çdo 5 vjet nga data e lëshimit të licencës për shofer instruktor, përkatësisht nga data e verifikimit të fundit të njohurive.

#### Neni 243

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me akt të veçantë juridik, përcakton kushtet dhe kriteret për verifikimin e njohurive të shofer instruktorit.

#### Neni 244

244.1. Mbikëqyrjen e punës së auto-shkollës në pikëpamje të plotësimit të kushteve të parapara e bëjnë personat e autorizuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

244.2. Mbikëqyrja përfshin të gjitha punët administrative, dokumentacionin dhe evidencat në lidhjen me aftësimin dhe në raste të bazuara, mund të urdhëroj shofer instruktorin që ti nënshtrohet verifikimit të jashtëzakonshëm të njohurive nga rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë.

244.3. Nuk lejohet ndryshimi dhe përmirësimi në librat respektivisht dokumentet tjera, dhe të njëjtat duhet t'ia prezantoj më kërkesë të personit të autorizuar.

244.4. Mbikëqyrjen e institucionit i cili e zhvillon lenden mësimore dhënia e ndihmës së parë personave të lënduar në aksident të komunikacionit e bën institucioni të cilin e autorizon Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me anë të një akti të veçantë juridik apo personat me përgjegjësi përkatëse të kësaj ministrie.

244.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 500 deri 1.500 €, pronari i auto-shkollës në rast të një veprimi në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

244.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, personi i autorizuar në auto-shkollë i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni.

244.7. Mënyrën e pezullimit dhe revokimit të licencës së Auto-Shkollave e përcakton me anë të një akti të veçantë juridik Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

### 3. PROVIMET PËR SHOFER DHE VLERSIMI I AFTËSIMIT

#### Neni 245

245.1. Provimit për shofer mund ti nënshtrohet vetëm kandidati i cili është aftësuar në auto shkollën e licencuar dhe nëse i plotëson kushtet e tjera për ta fituar të drejtën për të drejtuar mjetin me veprim motorik ose ti nënshtrohet provimit për shofer për kategorinë shtesë.

245.2. Në provimin për shofer përmes testimit teorik dhe praktik përcaktohet se kandidati për shoferë a ka njohuri dhe shkathtësi sipas programit të paraparë.

245.3. Në pjesën e provimit nga lënda të drejtuarit e mjetit motorik (pjesa praktike) kandidati pjesën e parë të provimit e jep në poligon ose ndonjë hapësirë tjetër jashtë rrugës publike ku duhet ti kryej së paku tri veprime dhe kandidati pas vlerësimit pozitiv të pyetësit, pjesën e dytë të provimit e kryen në rrugë publike.

245.4. Kandidati për shofer gjatë kryerjes së veprimeve sipas paragrafi 3 të këtij neni duhet të jetë vetëm në mjet.

245.5. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me një akt nën ligjor i përcakton kriteret dhe kushtet për pjesën e provimit në poligon ose ndonjë hapësirë tjetër jashtë rrugës publike, veprimet të cilat duhen të kryhen si dhe dimensionet e poligonit kur kryhet pjesa e parë e provimit nga lënda të drejtuarit e mjetit me veprim motorik.

#### Neni 246

Provimi nga lënda “Të drejtuarit e mjetit motorik” kandidati mund t’i nënshtrohet edhe me mjetin me ndërrues automatik të transmisionit dhe i njëjti ka të drejtë ta drejtojë vetëm këtë lloj të mjetit.

#### Neni 247

247.1. Provimi për shoferë përbënë tërësinë unike të lëndëve mësimore “Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë” (pjesa teorike) dhe “Të drejtuarit e mjetit me veprim motorik” (pjesa praktike).

247.2. Programin e provimit për shofer nga lënda mësimore “Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë” si dhe “Të drejtuarit e mjetit motorik” e përcakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 248

Provimi për shofer dhe vlerësimin e aftësive për pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës, organizohet në institucionet e veta përkatëse nga pyetësit të cilët i licencën Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit nga burimet njerëzore të tyre.

#### Neni 249

Kandidati i cili e jep provimin për shofer e fiton të drejtën të aplikoj para Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit për patentë shofer që lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

#### Neni 250

250.1. Provimi për shofer jepet para pyetësit të cilin e cakton Njësia e Patentë Shoferëve e Ministrisë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, apo në formë elektronike pasi që të krijohen kushtet për një punë të tillë.

250.2. Provimi nga paragrafi 1 i këtij neni organizohet dhe kryhet në Njësitë Rajonale për patentë shofer të caktuara nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

250.3. Pyetësi duhet të jetë personi i cili ka së paku përgatitje të lartë shkollore, së paku tri vite përvojë pune dhe i njëjti duhet të jetë i licencuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

250.4. Kandidati i cili për herë të parë ju ka nënshtruar provimit në ndonjë prej Njësive Rajonale për patentë shofer, nuk i lejohet të bëjë ndërrimin e Njesisë Rajonale, për të paraqitur provimin për patentë shofer serish.

#### Neni 251

Ministra e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, me një akt të veçantë juridik përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien dhe marrjen e licencës pyetësve për patentë shofer.

#### Neni 252

252.1. Verifikimi i njohurive të pyetësve bëhet çdo 5 vite, prej datës së lëshimit të licencës, përkatësisht 5 vite pas verifikimit të fundit, vetëm nga lënda mësimore “Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë”.

252.2. Nëse pyetësi nuk i nënshtrohet verifikimit të njohurive ose tregon rezultat negativ të cekura në paragrafin 1 të këtij neni, do ti merret licenca derisa nuk i nënshtrohet përsëri verifikimit të njohurive dhe të tregon rezultat pozitiv pas afatit të cilin e cakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 253

253.1. Pyetësi obligohet në kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale të ndershme dhe të paanshme.

253.2. Pyetësi, gjatë kryerjes së detyrave profesionale e gëzon të njëjtën mbrojtje si shërbyes civil .

253.3. Pyetësi i punësuar në Njësinë e patentë shoferëve nuk mundet në të njëjtën kohë të zhvilloj aftësimin e kandidatëve për shofer, të jetë pronar ose bashkë-pronar i një auto-shkolle.

253.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 1.500 €, pyetësi i punësuar në Njësinë e patentë shoferëve i cili në të njëjtin kohë kur bënë testimin e kandidatëve për shofer është pronar ose bashkë-pronar i një auto-shkolle dhe të njëjtit i merret licenca.

#### Neni 254

254.1. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit me një akt të veçantë juridik i përcakton kushtet dhe procedurat për paraqitjen e provimit për shofer, si dhe format dhe mostrat e dokumenteve të nevojshme në lidhje me këtë.

254.2. Lartësinë e shumës të cilin kandidatët e inkasojnë në emër të shpenzimeve për dhënien e provimit për shofer ose pjesës së saj së provimit është e njëjtë për territorin e Kosovës dhe cakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 255

Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, përcakton vendet ku mbahet provimi nga lënda mësimore të drejtuarit e mjetit me veprim motorik të cilat së paku duhet të jenë rrugë bashkëkohore me sinjalizim horizontal dhe vertikal të paraparë, me kryqëzime të rregulluara me shenja ndriçuese të komunikacionit (semafor) dhe me komunikacion intensiv të mjeteve me veprim motorik.

#### Neni 256

Në provimin për shofer të kategorive L dhe M kandidati i nënshtrohet provimit vetëm nga lënda “Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë”(testimit teorik).

#### Neni 257

Përmbajtjen dhe formën e testeve e përcakton Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit, me një akt të veçantë juridik.

#### Neni 258

Do të anulohet provimi për shofer dhe do të merret patentë shoferi, licenca për Shofer instruktor, nëse konstatohet se dhënia e provimit është kryer në bazë të dokumentit të rrejshëm ose të dhënave jo të sakta të theksuara në fletëparaqitje për dhënien e provimit për shofer, në bazë të dhënies së mitos, në qoftë se kandidati me rastin e dhënies së provimit për shofer është shërbyer me mjete jo të lejuara dhe nëse provimi është mbajtur në kundërshtim me rregullat e këtij ligji.

#### Neni 259

Programi për patentë shofer të mjeteve përfshin përmbajtjen nga lëndet mësimore ”Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë” si dhe “Të drejtuarit e mjetit me veprim motorik”.

### 4. FITIMI I TË DREJTËS PËR TA DREJTUAR MJETIN

#### Neni 260

260.1. Biçikletën në rrugë mund të drejton personi i cili ka mbushur 14 vjet.

260.2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, fëmijët të cilët i kanë mbushur 10 vjet, të cilët në shkollë aftësohen të drejtojnë biçikletën në rrugë dhe për këtë i lëshohet vërtetimi,



munden vet ta drejtojnë çikletën në rrugë lokale, ndërsa fëmijët të tjerë mund ta drejtojnë çikletën mbi moshën 9 vjeçare nën përcjelljen e një personi i cili i ka mbushur 16 vjet.

#### Neni 261

Qerren mund ta drejtojë:

- a) në rrugët regjionale personi i cili i ka mbushur 16 vjet;
- b) në rrugët lokale dhe të pa kategorizuara, personi i cili ka mbushur 14 vjet.

#### Neni 262

Të drejtën për të drejtuar mjetin me veprim motorik mund ta ketë personi i cili i plotëson këto kushte:

- a) të jetë psikikisht dhe fizikisht i aftë për të drejtuar mjetin;
- b) të ketë mbushur moshën për kategori të caktuar të mjeteve;
- c) të ketë të dhënë provimin për shoferë të kategorisë përkatëse;
- d) që me vendimin e organit kompetent nuk e ka të ndaluar drejtimin e mjetit.

#### Neni 263

Mosha minimale e personit për drejtimin e mjeteve të kategorive të caktuar është:

- a) t'i ketë mbushur 14 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë M;
- b) t'i ketë mbushur 16 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1 dhe T;
- c) t'i ketë mbushur 18 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë A, B dhe C1;
- d) t'i ketë mbushur 19 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë B+E, C dhe C1+E ;
- e) t'i ketë mbushur 20 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë C+E;
- f) t'i ketë mbushur 21 vjet për drejtimin e mjeteve të kategorisë A, D1, D1+E, D dhe D+E.

#### Neni 264

264.1. Të drejtën për të dhënë provimin për shofer për mjetet e kategorisë "C", mund t'a fitojë personi i cili posedon patentë shoferin e kategorisë "B" ose C1 së paku 1 (një) vit.

264.2. Të drejtën për të dhënë provimin për shofer për mjetet e kategorisë D1 ose D, mund t'a fitojë personi i cili posedon patentë shoferin e kategorisë C së paku 2 (dy) vite.

264.3. Të drejtën për të dhënë provimin për shofer për mjetet e kategorisë B+E, C1+E ose C+E, mund t'a fitojë personi i cili posedon patentë shoferin e mjetit tërheqës përkatës së paku një vit .

#### Neni 265

265.1. Shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve motorike të kategorisë B, C, D dhe nënkategorisë C1 dhe D1 ka të drejtë t'i drejtojë këto mjete edhe nëse është i'u bashkangjitur rimorkio e lehtë.

265.2. Shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve motorike të kategorisë D ka të drejtë t'i drejtojë edhe mjetet motorike të kategorive B, C dhe nënkategorive C1 dhe D1, shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e

mjeteve motorike të nënkategorisë D1 ka të drejtë t'i drejtoi edhe mjetet motorike të kategorive B, C dhe nënkategorisë C1, shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve motorike të kategorisë C ka të drejtë t'i drejtoi edhe mjetet motorike të kategorisë B dhe nënkategorisë C1, ndërsa shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve motorike të nënkategorisë C1 ka të drejtë t'i drejtoi edhe mjetet motorike të kategorisë B.

265.3. Shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve bashkëngjitëse të kategorisë D+E, ka të drejtë t'i drejtoi edhe mjetet bashkëngjitëse të kategorive B+E, C+E dhe nënkategorisë C1+E dhe D1+E, shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve bashkëngjitëse të nënkategorisë D1+E ka të drejtë t'i drejtoj edhe mjetet bashkëngjitëse të kategorive B+E, C+E, dhe nënkategorisë C1+E, shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve bashkëngjitëse të kategorisë C+E, ka të drejtë t'i drejtoi edhe mjetet bashkëngjitëse të kategorisë B+E dhe nënkategorisë C1+E, ndërsa shoferit të cilit i është lëshuar patentë shoferi për drejtimin e mjeteve bashkëngjitëse të nënkategorisë C1+E ka të drejtë ti drejtoi edhe mjetet bashkëngjitëse të kategorisë B+E.

265.4. Personi i cili ka fituar të drejtën për drejtimin e mjetit të kategorisë A1, pasi t'i mbush 18 vjet pa e dhënë provimin për shofer ka të drejtë t'i drejtoi mjetet e kategorisë A.

26.5. Shërbimi Policor i Kosovës dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës me një akt të veçantë juridik përcaktojnë kriteret për transportin grupor i cili kryhet me mjetet e kategorisë C, si dhe kushtet dhe mënyrën e transportit me mjetet e policisë.

#### Neni 266

Patentë shoferi lëshohet për drejtimin e mjeteve me veprim motorikë dhe bashkëngjitëse të cilat bëjnë pjesë: A1, A, B, C1, C, D1, D, B+E, C1+E, C+E, D1+E, D+E si dhe kategorive T, L, M.

-Nënkategoria A1 - Motoçikletat e lehta me vëllim punues që nuk kalon 125 cm<sup>3</sup> dhe me fuqi e cila nuk e kalon 11 kf.

-Kategoria A - motoçikleta deri 25 kë që nuk tejkalon 0,16 kë/kg.

-Kategoria A - e drejta për të drejtuar të gjitha llojet e motoçikletave (pa kufizim të fuqisë) nuk do të ipet derisa shoferi të ketë dy vite përvojë në motoçikletat deri në 25 k f, që nuk tejkalon 0,16 kf/kg "qasja direkt" për Kategorinë A të pakufizuar e mundur për drejtuesit e moshës 21 vjet.

-Kategoria B - Mjetet motorike që nuk tejkalojnë masën 3500 kg, që kanë tetë (8) ulëse, përveç ulëses së shoferit, me rimorkio e cila nuk tejkalon 750 kg, apo me rimorkio e cila tejkalon masën 750 kg me kusht që masa maksimale e lejuar e rimorkios nuk tejkalon masën e pangarkuar të mjetit tërhiqet dhe masa maksimale e lejuar e kombinimit nuk tejkalon 3500 kg.

-Kategoria B - Mjetet motorike me ndërrues automatik të transmisionit

-Nënkategoria B1 - Triçikletat dhe çikletat me katër rrotë me veprim motorik.

-Kategoria B+E - Kombinimet që përbëhen nga mjete tërheqës i kategorisë B, me rimorkio e cila tejkalon masën 750 kg, që e kalon peshën e zbrazët të mjetit tërheqës dhe masa maksimale e grupit nuk kalon peshën 3500 kg.

-Nënkategoria C1 - Mjetet motorike mbi 3500 kg dhe deri në 7500 kg dhe me rimorkio e cila nuk tejkalon 750 kg.

-Nënkategoria C1+E - Mjetet motorike në kategorinë C1 me rimorkio me masë mbi 750 kg me kusht që masa e lejuar e rimorkios nuk tejkalon masën e pangarkuar të mjetit tërheqës dhe masa maksimale e lejuar e kombinimit nuk tejkalon 12000 kg.

-Kategoria C - Mjetet motorike me mbi 3500 kg dhe me rimorkio e cila nuk tejkalon masën 750 kg.

-Kategoria C+E - Mjetet motorike me mbi 3500 kg me rimorkio e cila tejkalon masën e rimorkio 750 kg.

-Nënkategoria D1 - Minibusët me më shumë se 8 deri në 16 ulëse përveç ulëses së shoferit.

-Nënkategoria D1+E - Minibusët me rimorkio me masë më të madhe se 750 kg, me kusht që masa maksimale e lejuar e rimorkios nuk tejkalon masën e pangarkuar të mjetit tërheqës dhe masa maksimale e lejuar e kombinimit nuk tejkalon 12000 kg. Rimorkioja nuk duhet të shfrytëzohet për bartjen e udhëtarëve.

-Kategoria D - Autobusët me më shumë se 8 ulëse, përveç ulëses së shoferit, me rimorkio e cila nuk tejkalon masën 750 kg.

-Kategoria D+E - Autobusët me më shumë se 8 ulëse, përveç ulëses së shoferit, me rimorkio e cila tejkalon masën 750 kg.

-Kategoria T - traktori me rimorkio.

-Kategoria M - motokultivatori, çiklomotori, mopedat.

-Kategoria L - mjetet e punës.

#### Neni 267

267.1. Patentë shoferi mund të lëshohet edhe për mjetin më ndërrues automatik të transmisionit dhe shërben vetëm për drejtimin e mjeteve të tilla.

267.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 €, personi që vepron në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

#### Neni 268

Shoferi i cili posedon patentë shoferin e vlefshëm të kategorive: A1, A, B, C1, C, D1 dhe D ka të drejt ta drejtojë: mjetet e kategorive M, L, T.

#### Neni 269

269.1. Personit i cili e ka dhënë provimin për shofer të kategorive M, A1, A, B dhe C1 nuk i lejohet brenda dy viteve nga data e lëshimit të patentë shoferit që ta drejtoi mjetin në rrugë më shpejtësi më të madhe se 70km/h, në rrugë të rezervuara për komunikacion të mjeteve motorike më shpejtësi më të madhe se 80km/h, në auto udhë 110 km/h, ndërsa për çiklomotor 40 km/h, në këto mjete nuk lejohet tërheqja e mjeteve bashkangjitime si dhe transporti i organizuar i fëmijëve.

269.2. Personat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk i lejohet drejtimi e as ta filloj të drejtuarit e mjetit me veprim motorik nëse në organizëm ka droga, alkool, ose shfaqen shenja të alkoolizimit.

269.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë 130 €, dënohet shoferi nëse vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 2 të këtij neni dhe i shqiptohet masa e ndalimit e të drejtuarit të mjetit motorik për dy deri gjashtë muaj si dhe pesë pikë negative.

#### Neni 270

270.1. Patentë shoferi do t'i lëshohet personit me kërkesën e tij në qoftë se i plotëson kushtet e parapara në ligj.

270.2. Patentë shoferin e lëshon Ministria e Punëve të Brendshme.

270.3. Patentë shoferi i lëshohet dhe vazhdohet në afat vlefshmërie prej 5 viteve, kurse personave të moshuar mbi 65 vjeç në çdo dy vite në bazë të certifikatës mjekësore i vazhdohet patentë shoferi.

270.4. Përrjashtimisht nga rregullat e paragrafit 3, të këtij neni, patentë shoferi mund të lëshohet ose vlefshmëria e tij mund të kufizohet edhe në afat më të shkurtër se të përcaktuar me këtë paragraf, në bazë të konstatimit të dhënë në certifikatën mjekësore.

270.5. Gjithashtu me përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, patentë shoferi për kategorinë "B" jepet për periudhë të përhershme.

270.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 6.500 €, personi zyrtar përgjegjës në autoritetin kompetent nëse lëshon, vazhdon patentë shoferin në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

#### Neni 271

Në dokumentin e patentë shoferit shënohen të gjitha kategoritë e mjeteve me veprim motorik dhe mjeteve bashkangjitime.

#### Neni 272

272.1. Patentë shoferi vendor mundë të përdoret në komunikacionin ndërkombëtar kur përdoret në vendet të cilat e njohin një dokument të tillë, përveç nëse autoritetet e vendit të caktuar kërkojnë patentë shoferin ndërkombëtar atëherë i nënshtrohet marrëveshjes bilaterale nëse ekziston.

272.2. Patentë shoferi ndërkombëtar lëshohet duke u bazuar në patentë shoferin vendor për një periudhë 4 vjeçare dhe vlefshmëria e tij nuk duhet të jetë më e gjatë se vlefshmëria e patentë shoferit vendor, nëse është e zbatueshme.

272.3. Patentë shoferin ndërkombëtar e lëshon institucioni të cilin e autorizon Ministria e Punëve të Brendshme.

272.4. Patentë shoferi ndërkombëtar i cili është lëshuar në Kosovë nuk lejohet të shfrytëzohet për drejtimin e mjeteve motorike në Kosovë.

272.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që me patentë shoferin ndërkombëtar drejton mjetin motorik brenda Kosovës.

#### Neni 273

273.1. Personi i cili posedon Patentë shoferin e lëshuar nga ndonjë vend i Unionit Evropian mund të ndërrohet në patentë shoferin e Kosovës.

273.2. Personi i cili posedon patentë shoferin i lëshuar jashtë Kosovës me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, mund ti lëshohet patentë shoferi i Kosovës, pasi që të kalon testin teorik në qoftë se me marrëveshje bilaterale nuk është përcaktuar ndryshe.

273.3. Patentë shoferi i lëshuar sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nëse përmban kufizimin e vlefshmërisë ose kufizime tjera, kufizimet e tilla duhet të pasqyrohen në patentë shoferin e Kosovës.

273.4. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit, me anë të një akti juridik i përcakton, rregullat dhe procedurat për lëshimin e patentë shoferit sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

#### Neni 274

274.1. Dokumenti që vërteton të drejtën për të drejtuar mjetin me veprim motorik lëshohet pas pagesës të cilën e përcakton Ministria e Punëve të Brendshme.

274.2. Personi mund të posedon vetëm një patentë shofer të vlefshme.

#### Neni 275

275.1. Nëse patentë shoferi humbet, pronari obligohet që brenda 30 ditëve të informojë organin kompetent në këtë rast Ministrin e Punëve të Brendshme, që patentë shoferi apo ndonjë dokument tjetër që tregon mbi të drejtën për ngasje të një mjeti me veprim motorik, se është humbur, dëmtuar apo informatat që i përmban duhet të ripërtërihen.

275.2. Ministria e Punëve të Brendshme e lëshon kopjen sipas paragrafit 1 të këtij neni me kusht që:

- a) personi e bën një deklaratë me shkrim për humbjen e dokumentit ose
- b) personi e kthen dokumentin e dëmtuar, ose
- c) personi e kthen dokumentin i cili duhet të ripërtërihet.

#### Neni 276

Shoferi duhet t'i nënshtrohet në tërësi provimit teorik dhe praktik nëse brenda një viti që nga dita e skadimit të vlefshmërisë së patentë shoferit nuk aplikon ose nuk iu ka vazhduar vlefshmëria e patentë shoferit.

#### Neni 277

Ministria e Punëve të Brendshme e bën shtypjen e patentë shoferit dhe dokumenteve tjera të nevojshme, duke iu përmbajtur procedurave të caktuara.

#### Neni 278

Ministria e Punëve të Brendshme në këshillim me Ministrinë e Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit dhe Shërbimin Policor të Kosovës, duke marr parasysh nevojën mbi një siguri të mirë të patentë shoferëve ndaj mashtrimeve të mundshme dhe vjedhjes së tyre, do të përkufizojë me anë të një akti të veçantë:

- a) formën e patentë shoferëve dhe certifikatave tjera të ngasjes me një përshkrim të detajizuarl;
- b) procedurat e detajizuara administrative për lëshim, revokim dhe kthim të patentë shoferëve dhe dokumenteve tjera të ngasjes si dhe mostrave të te gjitha dokumenteve.

#### Neni 279

Kur drejton mjetin shoferi duhet të ketë me vete patentë shoferin e vlefshëm përkatës dhe ta tregoj me kërkesën e personit të autorizuar.

#### Neni 280

280.1. Nuk lejohet që pronari, përkatësisht titullari i së drejtës së shfrytëzimit të mjetit, si dhe shoferi të cilit i është besuar drejtimi i mjetit me kërkesën personit të autorizuar të drejtoj mjetin në kundërshtim me rregullat e nenit 226, 227 dhe neni 228 të këtij ligji dhe as personit i cili nuk ka drejtë të drejtojë mjetin, përkatësisht personi i cili nuk ka drejtë të drejtojë kategorinë e mjeteve të cilin bënë pjesë ky mjet.

280.2. Pronari, përkatësisht titullari i të drejtës së shfrytëzimit të mjetit, si dhe shoferi të cilit i është besuar drejtimi i mjetit me kërkesën e personit të autorizuar është i detyruar ti japë të dhënat për identitetin e personit të cilit ia ka dhënë mjetin për ta drejtuar.

280.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, pronari, përkatësisht titullari i së drejtës së shfrytëzimit të mjetit, si dhe shoferi të cilit i është besuar drejtimi i mjetit që ja ka dhënë mjetin personit i cili është i sëmur i lodhur, nën ndikim të alkoolit ose si edhe personit i cili nuk ka drejtë të drejtojë mjetin, përkatësisht personi i cili nuk ka drejtë të drejtojë kategorinë e mjeteve të cilin bënë pjesë ky mjet.

#### Neni 281

281.1. Shtetasi i huaj, të cilit i është lejuar qëndrimi i përkohshëm apo i përhershëm në Kosovë dhe banori kosovar, i cili kthehet nga bota e jashtme në Kosovë, por edhe personeli i përfaqësive diplomatike, përfaqësive konsullore dhe i misioneve të shteteve të huaja, përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Kosovë, përfaqësive të huaja tregtare, të komunikacionit, kulturore e të tjera dhe i zyrave të huaja të korrespondentëve, mund të drejtojnë mjetet motorike në bazë të patentës së huaj të vlefshme të shoferit për kohën deri në një vjet që nga dita e hyrjes në Kosovë.

282.2. Patentë shofer i vlefshëm është edhe patentë shoferi i lëshuar nga Kombet e Bashkuara për personelin e vet që lejon ngasjen e automjeteve të Kombeve të Bashkuara, patentë shoferi i lëshuar nga organizatat përbërëse të UNMIK-ut,( p sh) Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë), për personelin e tyre që lejon ngasjen e automjeteve të organizatave të tilla si dhe patentë shoferin e vlefshëm të lëshuar nga KFORI për personelin e KFOR-it që lejon ngasjen e automjeteve të KFOR-it.

#### Neni 282

Ministria e Punëve të Brendshme me anë të një akti juridik themelon sistemin Bazë të dhënave të patentë shoferëve në nivel qendror.

### 5. KONTROLLIMI SHËNDETËSOR I SHOFRERËVE

#### Neni 283

283.1. Shoferi i mjetit motorik, të dizajnuar për transportimin e udhëtarëve, shoferi i mjetit motorik transportues, i bashkësive të mjeteve me masë të përgjithshme më shumë se 7.5 tona, duhet të posedoj certifikatën shëndetësore, në rast se mjetet e tilla përdoren për transport komercial të njerëzve dhe mallrave. E njëjta vlen edhe për shoferin e mjetit motorik i cili të drejtuarit e mjetit e ka profesion themelor.

283.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

283.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € edhe shoferi që nuk ka certifikatën shëndetësore të vlefshme gjatë drejtimit të mjeteve motorike për transportin e udhëtarëve ose mallit me masën më të madhe të lejuar mbi 7,5 tona apo bashkësinë e mjeteve.

#### Neni 284

284.1. Shoferi nga neni 283, duhet të kaloj ekzaminimin mjekësor në mënyrë që të konstatohet se a ka apo nuk ka ndonjë tregues lidhur me shëndetin që kundërshtojnë ngasjen e mjetit me veprim motorik. Kontrollimi i tillë bëhet para se të lëshohet certifikata e parë e shëndetësore dhe më pas, çdo 5 vjet gjatë periudhës deri në moshën 55 vjet dhe për çdo dy vite pas moshës 55 vjeçare.

284.2. Për ekzaminimet dhe testet nga paragrafi 1 i këtij neni duhet që të paguhet, nga pronari i kompanisë transportuese nëse punëson një shofer apo është vet shofer (rasti shofer-operator).

284.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € , shoferi i mjetit nëse nuk posedon me veti certifikatën shëndetësore ose e cila nuk është e vlefshme.

284.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

#### Neni 285

285.1. Certifikata shëndetësore mund t'i lëshohet personit që plotëson kushtet e parapara me ligj, përkatësisht me akt nënligjor.

285.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 € personi zyrtar përgjegjës në autoritetin kompetent, nëse lëshon certifikatën shëndetësore në kundërshtim me dispozitat e këtij neni.

#### Neni 286

Personat të cilët në vijim, duhet të kalojnë ekzaminimin mjekësor në mënyrë që të konstatohet se a ka apo jo ndonjë tregues lidhur me shëndetin që kundërshton ngasjen e mjetit motorik janë:

- a) personat të cilët dëshirojnë të marrin patentë shoferin;
- b) personat të cilët aplikojnë për kthim të patentë shoferit të tyre, e cila i është revokuar për arsye të shëndetit të dobët të tyre;
- c) shoferët të cilët janë raportuar nga Shërbimi Policor i Kosovës, që kanë marr pjesë në aksidente komunikacioni me fatalitet ose kanë drejtuar mjetin motorik nën ndikimin e alkoolit, drogës ose barnave narkotike;
- d) personi me aftësi të kufizuara nëse ekziston ndonjë bazë që tregon se aftësitë e tij të ngasjes janë keqësuar;
- e) kandidatët për shofer instruktor apo ekzaminerët e patentë shoferit.

#### Neni 287

287.1. Kontrollimet mjekësore të personave nga neni 286 i këtij ligji kryhen nga institucionet e autorizuara nga Ministria e Shëndetësisë.

287.2. Për kontrollimet mjekësore të lartë-përmendura lëshohet certifikata nga organi kompetent.

#### Neni 288

288.1. Nëse në kontrollimin mjekësor konstatohet se shoferi nuk është i aftë për ta drejtuar mjetin me veprim motorik për të cilin i është lëshuar patentë shoferi, institucionet shëndetësore janë të obliguara të lëshojnë vërtetimin dhe brenda 8 dite ta lajmëron Shërbimin Policor të Kosovës ku shoferi e ka vendbanimin.

288.2. Nëse në kontrollimin mjekësor konstatohet se kandidati për shofer nuk është i aftë për ta drejtuar mjetin me veprim motorik, institucionet janë të obliguar të lëshojnë vërtetimin dhe brenda 8 dite ta lajmëron Shërbimin Policor të Kosovës, ku kandidati për shofer e ka vendbanimin.

288.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 400 €, personi nëse nuk e lajmëron Shërbimin Policor të Kosovës brenda 8 dite.

#### Neni 289

Ministra e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Shërbimin Policor të Kosovës, përkufizojnë me anë të një akti nënligjor si vijon:



- a) kërkimin nga personat që të shkojnë për ekzaminimet mjekësor dhe kryerja e tyre, në mënyrë që të konstatohet se a ekziston ndonjë tregues lidhur me shëndetin që kundërshton ngasjen e mjetit motorik;
- b) lëshimin e certifikatave mjekësore me konstatimin se ka apo nuk ka ndonjë tregues lidhur me shëndetin, që kundërshton ngasjen e mjetit motorik;
- c) marrjen e autorizimeve nga ana e institucioneve shëndetësore për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të lartë-përmendura;
- d) fushën e ekzaminimeve mjekësore;
- e) rrjedhën e dokumenteve përkatëse dhe mostrave të këtyre dokumenteve.

#### Neni 290

290.1. Testet për konstatim të alkoolit në trup të shoferit, bëhen duke përdorur pajisjet dhe metodat që nuk kanë nevojë për ndonjë test laboratorik.

290.2. Testi i lartë-përmendur bëhet me ndihmën e mekanizmave (testuesve) elektronik, të cilët bëjnë matjen e densitetit të alkoolit nga fryma që e nxjerr jashtë personi i testuar.

290.3. Testi i lartë-përmendur nuk zbatohet, nëse gjendja e personit për tu testuar nuk lejon ushtrimin e testit duke përdorur alko-testin. Në rast të tillë, mbajtja e përmbajtjes së alkoolit në trup bëhet në bazë të analizave të gjakut apo urinës, në institucionet përkatëse.

290.4. Testi mbi përmbajtjen e alkoolit në trup mund të bëhet edhe kundër dëshirës së personit, i cili duhet të njoftohet lidhur me këtë paraprakisht.

290.5. Procedurat dhe kriteret e përgjithshme lidhur me testet e lartë-përmendura, do të rregullohen me akt të veçantë juridikë të lëshuar nga Shërbimi Policor i Kosovës në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë.

#### Neni 291

291.1. Testet për konstatim të drogave ose barnave narkotike në trup të shoferit, zhvillohen duke shfrytëzuar teknika që nuk kanë nevojë për teste laboratorike.

291.2. Testi i lartë-përmendur nuk zbatohet nëse gjendja e personit për tu testuar nuk lejon ushtrimin e testit me teknikat e lartë-përmendura. Në rast të tillë, matja e përmbajtjes së drogës në trup bëhet në bazë të analizave të gjakut dhe urinës, në institucionet përkatëse.

291.3. Testi mbi përmbajtjen e drogës së tillë në trup mund të bëhet, gjithashtu, kundër dëshirës së personit, i cili duhet të njoftohet lidhur me këtë paraprakisht.

291.4. Ministri i Shëndetësisë përkufizon me anë të një akti nënligjor, listën e substancave narkotike dhe medikamenteve me veprim të ngjashëm që nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes nga shoferi.

#### Neni 292

292.1. Nëse shoferi përfshihet në një aksident rrugor me fatalitet, me kërkesë të personit të autorizuar shoferi i mjetit motorik pa tjetër duhet të testohet mbi përmbajtjen e alkoolit, drogës apo barnave narkotike.

292.2. Personi i cili kundërshton testin e përmbajtjes së alkoolit, drogës apo barnave narkotike në gjak konsiderohet se është pozitiv.

292.3. Në rast të konstatimit të përmbajtjes së alkoolit, drogës apo barnave narkotike në gjak dhe në rastin e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, personi i autorizuar ndërmerr masat për largimin nga komunikacioni.

#### Neni 293

293.1. Shoferi duhet ti nënshtrohet kontrollimit shëndetësor të jashtëzakonshëm.

293.2. Në kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshëm dërgohet shoferi tek i cili dyshohet se për shkak të gjendjes shëndetësore nuk është më në gjendje ta drejtoj mjetin në komunikacionin rrugor.

293.3. Në kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshëm dërgohet shoferi dhe shofer instruktori tek i cili është konstatuar përmbajtja e alkoolit në organizëm më tepër se sa është e lejuar ose është konstatuar përmbajtja e drogës ose barnave narkotik në organizëm më tepër se sa është e lejuar si dhe shoferi dhe shofer instruktori i cili refuzon ti nënshtrohet kontrollit shëndetësor.

293.4. Kërkesën për dërgim në kontrollim shëndetësor të jashtëzakonshme mund ta bëjë çdo organ i cili është kompetent për mbikëqyrjen e komunikacionit rrugor (Shërbimi Policor i Kosovës, inspektorati e të ngjashëm), gjykata, gjykata për kundërvajtje, personi ku është i punësuar shoferi.

293.5. Në kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshme shoferin e dërgojnë pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës.

293.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

293.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi i mjetit i cili nuk i është nënshtuar ose refuzon t'i nënshtrohet kontrollimit shëndetësor të jashtëzakonshëm.

#### Neni 294

294.1. Kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshëm e paguan shoferi i cili dërgohet në kontroll nëse konstatohet se nuk është i aftë ose ju kanë kufizuar aftësia ngasje për ta drejtuar mjetin motorik.

294.2. Nëse në kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshëm konstatohet se shoferi është i aftë për ta drejtuar mjetin motorik, shpenzimet i paguan, Shërbimi Policor i Kosovës, gjegjësisht organi i cili e dërgon në kontrollimin shëndetësor të jashtëzakonshëm shoferin.

### 6. KOHËZGJATJA E DREJTIMIT TË MJETIT MOTORIK

#### Neni 295

295.1. Shoferi i cili drejton autobusin, mjetin e transportit ose bashkësinë e mjeteve masa më e madhe e të cilave është mbi 3,5 tona nuk i lejohej ta drejtoj mjetin me kohëzgjatje më shumë se 9 orë brenda 24 orë. Periudha javore e ngasjes është maksimum 6 ditë. Shoferi pas katër orë e gjysmë të drejtimit të pandërprerë të mjetit, duhet të pushojë së paku 45 minuta, përveç nëse ai fillon periudhën e pushimit. Ky pushim mund të zëvendësohet nga pushimet prej së paku 15 minuta secila e pjesëtuar sipër periudhës së ngasjes.

295.2. Mesatarja e kohës punuese javore për shoferët nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të kaloj 48 orë. Përrjashtimisht mund të kaloj në 60 orë nëse mesatarja e 48 orëve për javë nuk tejkalohet brenda periudhës prej katër javësh.

295.3. Rregullat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen gjithashtu edhe në shofer instruktorin gjatë aftësimit të kandidatit për shofer nga lënda mësimore të drejtuarit e mjetit motorik.

295.4. Rregullat e paragrafit një dhe dy nuk zbatohen për shoferin e autobusit i cili kryen transportin publik urban të udhëtarëve, por mund të drejtojë më së shumti shtatë orë pa ndërprerë me kusht që stacionet e nisjes të ketë ndërprerje të pushimit prej së paku 5 minuta.

295.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 75 €, shoferi i cili pa ndërprerë drejton autobusin, mjetin e transportit ose bashkësinë e mjeteve masa e lejuar e të cilave është më e madhe se 3500 kg më gjatë se sa koha e përcaktuar ose nuk shfrytëzon pushimet e parapara.

295.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 deri 270 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

## Neni 296

296.1. Pushimi i pandërprerë ditor i shoferit i cili drejton mjetin nga neni 295 paragrafi 1. dhe 2. të këtij Ligji zgjat së paku 11 orë para fillimit të drejtimit.

296.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, shoferi mundet tri here në javë të shfrytëzoi pushimin ditor në kohëzgjatje prej nëntë orëve pa ndërprerë me kusht që deri në fundin e javës së ardhshme t'i shfrytëzoi orët e mbetura të pushimit ditor.

296.3. Pushimin ditor në kohëzgjatje të plotë prej 11 orëve shoferi mund ta shfrytëzoi më së shumti në tri pjesë gjatë ditës, me kusht që një here t'i shfrytëzoi 8 orë pa ndërprerje të pushimit ditor.

296.4. Në qoftë se në drejtimin e mjetit nga neni 295 të këtij Ligji ndërrohen dy shoferë dhe nëse në mjet ndodhet shtrati i rregulluar i cili i mundëson njërit prej tyre pushimin në pozitë të shtrirë, çdonjëri prej shoferëve mund të ketë pushim të pandërprerë prej të paktën tetë orë gjatë çdo 30 orëve të udhëtimit.

296.5. Pushimin ditor sipas rregullave shoferi duhet ta shfrytëzoi jashtë automjetit.

296.6. Përrjashtimisht nga rregullat e paragrafit 5 të këtij neni shoferi mund ta shfrytëzoi pushimin në mjet në të cilin ndodhet shtrati i rregulluar dhe në qoftë se mjeti nuk lëviz.

296.7. Ndërprerja e drejtimit nga neni 295 paragrafi 1 i këtij Ligji nuk konsiderohet pushim ditor.

296.8. Pas kalimit të kohës gjashtë ditësh të drejtimit të lejuar të mjetit, shoferi duhet të shfrytëzoi pushimin javor.

296.9. Shfrytëzimi i pushimit javor mund të vazhdoj deri në përfundimin e ditës së gjashtë, në qoftë se drejtimi i mjetit gjatë gjashtë ditëve të njëpasnjëshme nuk ka zgjatur më shumë se drejtimi i lejuar gjashtë ditor.

296.10. Në secilën javë nga pushimet nga paragrafi 2. dhe 3. të këtij neni duhet të vazhdohen në gjithsejtë 45 orë të pa ndërprera.

296.11. Pushimi javor mund të shkurtohet në vendin e krijimit (vendin e përkatësisë së mjetit) ose vendbanimin e shoferit në 36 orë të pandërprera kurse jashtë këtyre vendeve në 24 orë të pandërprera. Secila ndërprerje e pushimit javor duhet të filloi para skadimit të javës vijuese.

296.12. Përjashtimisht nga rregullat e paragrafit 8. dhe 9. të këtij neni, në transportin ndërkombëtar të pasagjerëve (udhëtimet turistike, ekskursionet etj) duke përjashtuar transportin linjor, pushimi javor duhet të shfrytëzohet pas më së shumti drejtimit të lejuar dymbëdhjetë ditësh.

296.13. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 deri 270 €, personi në qoftë se nuk i siguron shoferit pushimin ditor dhe javor në përputhje me rregullat e këtij neni.

296.14. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi që nuk e shfrytëzon pushimin ditor dhe javor.

#### Neni 297

297.1. Mjetet, të cilat janë të obliguara të jenë të pajisura me tahograf ose me sistemin e monitorimit (mbikëqyrjes) duhet të kenë këto pajisje dhe sisteme në gjendje të rregullt në përputhje me normat teknike dhe të kenë fletëzën e atestit në të cilën janë të shënuara të dhënat e përcaktuara.

297.2. Shoferi nga paragrafi 1. i këtij neni duhet që me vete të ketë çelësin e tahografit ose sistemit të monitorimit (mbikëqyrjes) si dhe listat e regjistrimit paraprak nga të cilat mund konstatohet ngasja apo ndalja e mjetit i cili është drejtuar gjatë gjashtë ditëve të fundit, respektivisht ditës së fundit të pushimit javor.

297.3. Rregullat e paragrafit 2. të këtij neni aplikohen edhe ndaj ekuipazhit të ndarë në mjet, ku të dy shoferët duhet të kenë listat paraprake të shfrytëzuara nga pushimi i fundit javor.

297.4. Listat e shpenzuara, respektivisht të dhënat e regjistruara nga tahografi ose sistemi mbikëqyrës, pronari ose shfrytëzuesi i mjetit është i obliguar t'i ruaj dy vite.

297.5. Shoferi nga paragrafi 1. i këtij neni është i obliguar që në kërkesë të personit zyrtar të policisë ose inspektorit të komunikacionit rrugor ta çelë tahografin ose sistemin e mbikëqyrjes dhe t'i jap në shikim fletëzën regjistruese si dhe të dhënat tjera nga sistemi i mbikëqyrjes më së paku deri në pushimin e fundit javor të shfrytëzuar deri në momentin kur lista ose të dhënat kërkohen.

297.6. Personi zyrtar i policisë ose inspektori i komunikacionit rrugor në rast të kontrollimit fletëza e nxjerr nga tahografi ose sistemi i mbikëqyrjes, duhet që shoferit t'i lëshojë vërtetimin më konstatimin që fletëza është nxjerrë nga sistemi për shkak të

kontrollit, kurse në vërtetim duhet të jenë të shënuar emri dhe mbiemri i shoferit, numri i regjistrimit të mjetit dhe data e koha kur është kryer kontrolli.

297.7. Personi zyrtar i Shërbimit Policor të Kosovës si dhe inspektori i komunikacionit rrugor mund ta konfiskoi përkohësisht fletëzën e regjistrimit respektivisht të dhënat nga sistemi i mbikëqyrjes si prova në procedurë.

297.8. Në qoftë se personi zyrtar i policisë ose inspektori i komunikacionit rrugor dyshon në mënyrë të justifikuar se tahografi ose sistemi i mbikëqyrjes nuk është në gjendje të rregullt, mund të urdhëroi ekzaminimin e tahografit ose sistemit mbikëqyrës nga organizata e autorizuar nga neni 320 të këtij Ligji dhe lidhur me këtë lëshohet vërtetimi. Në qoftë se me rastin e ekzaminimit konstatohet se tahografi ose sistemi i mbikëqyrjes nuk është në gjendje të rregullt, i dëmtuar me qellim ose i rindrequr që të jep vlera të shtrembëruara ose pajisja nuk funksionon, shpenzimet e ekzaminimit i paguan pronari i mjetit.

297.9. Të mjetet nga paragrafi 1. i nenit 296 të këtij Ligji, të cilat nuk janë të obliguara të posedojnë tahografin ose sistemin e mbikëqyrjes, shoferi duhet të ketë tek me vete librezën individuale të mbikëqyrjes dhe në të, të shënoi aktivitetet e veta dhe është i obliguar që t'ia paraqet personit zyrtar të policisë ose inspektorit të komunikacionit rrugor.

297.10. Pronari ose shfrytëzuesi i mjetit është i obliguar që të mbajë evidencën mbi kohën e punës dhe pushimeve të shoferit të mjetit nga paragrafi 1. i këtij neni, leximin e regjistrimeve të tahografit ose sistemit të mbikëqyrjes, respektivisht nga librezat individuale e mbikëqyrjes.

297.11. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 10 të këtij neni.

297.12. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 €, personi që urdhëron ose lejon që me mjetin e tij merr pjesë në komunikacion shoferi pa librezë individuale të mbikëqyrjes (paragrafi 9).

297.13. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, shoferi i mjetit që është i obliguar të jetë i pajisur më tahograf ose sistem të mbikëqyrjes në qoftë se drejton mjetin në të cilin nuk është i instaluar tahografi ose sistemi i mbikëqyrjes ose nuk janë të atestuara ose nuk i përdorë në mënyrë të përcaktuar me këtë Ligj, si dhe shoferi i mjetit i cili nuk është i obliguar të ketë këto pajisje në qoftë se nuk posedon librezën individuale të mbikëqyrjes ose në të cilën nuk shënon veprimtarinë ose nuk e paraqet në kërkesë të personit zyrtar.

## Neni 298

298.1. Rregullat e këtij Ligji mbi kohëzgjatjen e drejtimit të mjetit dhe pushimit të shoferit aplikohen edhe ndaj shoferëve të mjeteve të regjistruara jashtë Kosovës kur ato mjete drejtohen në territorin e Kosovës në qoftë se më Marrëveshje ndërkombëtare nuk është e përcaktuar ndryshe.

298.2. Autorizohet ministri Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit që ti nxjerrë rregullat ligjore mbi kohëzgjatjen e përgjithshme të drejtimit të mjeteve; mbi mënyrën e punës së ekuipazheve të ndara në mjet; mbi pushimin e shoferëve lidhur me drejtimin e mjetit; mbi formën dhe përmbajtjen e librezës individuale të mbikëqyrjes dhe udhëzimet mbi plotësimin e të njëjtës.

## KAPITULLI X MJETET

### 1. Rregullat e përgjithshme

#### Neni 299

299.1. Mjetet në komunikacionin rrugor duhet ti plotësojnë kushtet e parapara lidhur me përmasat, me masën e përgjithshme dhe me ngarkimin boshtor, si dhe të kenë instalimet dhe pajisjet e parapara, në gjendje të rregullt.

299.2. Mjetet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara lidhur me përmasat, me masën e përgjithshme dhe me ngarkimin boshtor, mund të marrin pjesë në komunikacion në rrugë publike në qoftë se i plotësojnë kushtet e posaçme të cilat bëjnë të mundshme lëvizje të sigurt dhe të papengueshëm të përcaktuar në lejen që e kanë lëshuar Kuvendet Komunale apo Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit varësisht në territorin e së cilit marrin pjesë në komunikacion.

299.3. Punët operative të matjes, gjegjësisht kontrollin e ngarkesës boshtore, masës së përgjithshme dhe dimensionet e mjetit në komunikacion në rrugë publike e bëjnë personat e autorizuar kompetent për mbikëqyrjen e komunikacionit në rrugë publike.

299.4. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, me akt nën ligjor përcakton rregullat për instalimet dhe pajisjet të cilat duhet ti kenë mjetet si dhe kushtet të cilat duhet ti plotësojnë instalimet dhe pajisjet në mjetin i cili merr pjesë në komunikacion në rrugë publike.

299.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i cili drejtojnë mjetin i cili nuk i plotëson kushtet e parapara për masën e përgjithshme, dimensionet dhe ngarkimin boshtor të mjetit, si dhe pajimet për kyçje dhe shkyçje.

299.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri 550 € edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

#### Neni 300

Mjetet e regjistruara në vend të huaj mund të marrin pjesë në komunikacionin rrugor në territorin e Kosovës nëse i kanë në rregull pajisjet dhe pajimet të parapara me Konventa ndërkombëtare, dimensionet, masa më e madhe e lejuar dhe ngarkesa boshtore dhe nëse i plotësojnë kushtet e parapara për mjetet e regjistruara në Kosovë.

### 2. REGJISTRIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE BASHKANGJITËSE

#### Neni 301

Ministria e Punëve të Brendshme e rregullon çështjen e regjistrimit të mjeteve motorike.

#### Neni 302

302.1. Çdo mjet motorik, traktor, çiklomotor ose mjet bashkangjites, i lejohet që merr pjesë në komunikacion rrugor nëse posedon lejen e komunikacionit të vlefshme, ndërsa mjetet të cilat janë të regjistruara në Kosovë edhe librezën e mjetit.

302.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni nuk duhen të jen të regjistruara mjetet motorike dhe bashkangjitesë të cilat janë të prodhuara ose të riparuar në të cilat bëhet ekzaminimi dhe pasqyrimi i cilësive të tyre, ose që lëvizin nga fabrika ose vendi i prodhimit deri të depot, si dhe mjetet që lëvizin nga vendi në të cilin janë marrë si të pa regjistruara deri te vendi ku to të regjistrohen me kusht që të jenë të shënuar me targat të posaçme për shënimin e përkohshëm të mjeteve në komunikacion në rrugë (targat provuese).

302.3. Për mjetet nga paragrafi 2 i këtij neni lëshohet vërtetimi për përdorimin e targave provuese.

302.4. Kur drejtohet mjeti i cili është i shënuar me tabela provuese, shoferi i tij duhet të ketë me veti vërtetimin e vlefshëm dhe është i detyruar ta tregoj me kërkesën e personit të autorizuar.

302.5. Rimorkio e lehtë nuk regjistrohet sipas rregullave të regjistrimit të mjeteve, mirëpo mund të marrin pjesë komunikacion në rrugë me kusht që të jenë të shënuar me targa të regjistrimit dhe nëse në kontrollin teknik të detyrueshëm konstatohet se janë në gjendje të rregullt teknike.

302.6. Për mjetet e regjistruara dhe dhënien e targave provuese mbahet evidenca.

302.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, personi që urdhëron ose lejon që mjeti i tij i pa regjistruar ose i mjetit të cilit i ka skaduar afati i lejes së komunikacionit të merr pjesë komunikacion në rrugë ose mjeti i tij merr pjesë komunikacion në rrugë pa targa provuese ose i ka skaduar afati i vlefshmërisë së tabelave provuese.

302.8. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 € shoferi që drejton mjetin përveç traktorit dhe mjetet e punës, të cilat nuk janë të regjistruar ose i ka skaduar afati i regjistrimit.

302.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi që drejton traktorin dhe mjetet e punës, të cilat nuk janë të regjistruara ose i ka skaduar afati i lejes së komunikacionit.

302.10. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 25 €, shoferi që në komunikacionin rrugor e drejton mjetin i cili nuk është i shënuar me targa provuese, nëse me veti nuk e ka vërtetimin për shfrytëzimin e targave të përkohshme ose nuk i tregon me kërkesën e personit të autorizuar edhe nëse me mjet e tërheq rimorkion e lehtë e cila nuk e ka targën e regjistrimit dhe për të cilin nuk është i kryer kontrollimi teknik ku konstatohet rregullsia teknike e tij.

### Neni 303

303.1. Mund te regjistrohen vetëm ato mjete motorike dhe bashkangjitesë për të cilat në kontrollin teknik të detyrueshëm konstatohet se janë në gjendje të rregullt teknike.

303.2. Për mjetet e regjistruara lëshohet leja e komunikacionit, targat dhe librezat e mjetit.

303.3. Shoferi i cili në komunikacionin rrugor drejton mjetin duhet të ketë me veti lejen e komunikacionit. Leja e komunikacionit dhe librezat e mjetit nuk lejohet të jetë në mjet pa mbikëqyrjen e shoferit.

303.4. Ministria e Punëve të Brendshme me akt nën ligjor përcakton rregullat e regjistrimit të mjetit, përmbajtjen, formën, madhësinë dhe ngjyrën e formularit të lejes së komunikacionit dhe librezës së mjetit.

#### Neni 304

304.1. Për mjetet që regjistrohen lëshohet njëra prej këtyre llojeve të targave :

- a) targat për mjetet motorike përveç motoçikletës, çiklomotor, traktor dhe mjetet punuese;
- b) targat për motoçikleta;
- c) targat për çiklomotor;
- d) targat për traktor dhe mjetet punuese;
- e) targat për mjetet motorike dhe për rimorkiot e përfaqësive diplomatike dhe të misioneve të shteteve të huaja dhe të përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe personalitetit të tyre, të përfaqësive kulturore dhe të përfaqësive të tjera, zyra të huaja të korrespondentëve dhe të korrespondentëve të huaj të përhershme, përkatësisht të huajve ose nëpunësve të përhershëm të zyrave të huaja të korrespondentëve;
- f) targat e regjistrimit për mjetet e të huajve të cilëve iu është lejuar qëndrimi i përkohshëm ose përhershëm;
- g) targat e regjistrimit për mjetet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës;
- h) targat e regjistrimit për mjetet e Shërbimit Policor të Kosovës;
- i) targat për mjetet motorike dhe rimorkiot që nuk i plotësojnë kushtet e parapara lidhur me përmasat (gjatësia, gjerësia, lartësia) përkatësisht masa maksimale e lejuar e të cilave është më e madhe se sa e lejuar gjegjësisht vet masa e të cilave është më e madhe se ngarkimet e lejuara boshtore.

304.2. Mjeti i regjistruar në Kosovë mund ta lëshoj territorin e Kosovës në qoftë se e ka vendosur shenja KS në pjesën e prapme të mjetit.

#### Neni 305

305.1. Mjetet motorike në komunikacion duhet ti kenë nga dy targa të regjistrimit gjegjësisht dy targa provuese.

305.2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, motoçikleta, traktori, makinat e punës, çiklomotori dhe mjeti bashkangjites mund ti kenë nga një targë.

305.3. Targat e regjistrimit të vendosura në mjet duhet të jenë të lëshuara (dhëna) për atë mjet.

305.4. Targat dhe shenja KS nga neni 304 paragrafi 1 të këtij Ligji, duhen të vendosen në mënyrë që të shihen mirë dhe të jenë të lexueshme.

305.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 600 deri 1.500 €, organizata afariste ose institucioni publik nëse në mjet i shfrytëzon targat e regjistrimit të cilat nuk janë dhënë për atë mjet.

306.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 100 deri 300 € edhe personi përgjegjës në organizatën afariste ose institucionin publik të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

305.7. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € shoferi i cili drejton mjetin i cili nuk i ka targat e regjistrimit dhe me gjobë prej 15 € nëse targa ose shenja ndërkombëtare nuk shihen mirë ose janë të papastra.



306.1. Mjetet e përfaqësive diplomatike ose konsullore, të misioneve të shteteve të huaja, të përfaqësive të organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe të personelit të tyre, përfaqësive të huaja tregtare, përfaqësive të komunikacionit, përfaqësive kulturore dhe të zyrave të huaja të korrespondentëve të përhershëm, përkatësisht të huajve kur ju është lejuar qëndrimi i përhershëm ose i përkohshëm në Kosovë si dhe mjetet e banorëve të Kosovës të cilët janë kthyer nga vendi i huaj në Kosovë me qëllim që të bëhen banor të përhershëm të Kosovës, mund të marrin pjesë në komunikacionin rrugor vetëm nëse janë të regjistruar në Kosovë.

306.2. Mjeti i regjistruar në vendin e huaj, në pronësi të shtetasit të huaj me qëndrim të përkohshëm në Kosovë, mund të marr pjesë në komunikacionin rrugor në Kosovë jo më gjatë se tre muaj, nga data e hyrjes në Kosovë.

306.3. Rregullat e paragrafit 2 të këtij neni nuk kanë të bëjë me përfaqësuesit e UNMIK-ut, KFOR-it, Shoqatave ose të ngjashme të cilat janë në mision në Kosovë.

306.4. Mjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të qytetarit të Kosovës me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë Kosovës, mund të marrë pjesë në komunikacionin rrugor në Kosovë deri tre muaj, nga data e hyrjes në Kosovë dhe i njëjti duhet ta ketë të rregulluar lejen e qëndrimit të përhershme ose të përkohshëm dhe ta tregoj me kërkesën e personit të autorizuar.

306.5. Mjetin e regjistruar jashtë Kosovës nga paragrafi 4 i këtij neni nuk mund të drejtohet nga personi tjetër ose të autorizohet, i njëjti lejohet të drejtohet nga personi tjetër vetëm nëse pronari është prezent gjatë kohës së drejtimit të mjetit.

306.6. Përrjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni nuk ka të bëjë me mjetet të cilat shërbejnë si mjete komerciale (autobusët, mjetet e transportit me masën më të madhe se 3500 kg, mjetet për transportin e materieve të rrezikshme) derisa nuk kanë mundësi me targat e regjistrimit të lëvizin jashtë Kosovës, të njëjtit nuk mund të operojnë brenda territorit të Kosovës.

306.7. Personi i cili e importon ndonjë mjet nga ndonjë vend jashtë Kosovës e i cili nuk e ka të rregulluar qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm nga vendi ku është importuar mjeti, të njëjtit i lejohet të marr pjesë në komunikacionin rrugor deri 8 ditë nga data e hyrjes së mjetit në Kosovë .

306.8. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 €, shoferi ose personi i cili drejton mjetin në komunikacionin rrugor në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni.

306.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 €, shoferi ose personi, nëse mjeti i regjistruar në vendin e huaj në pronësi të banorit të Kosovës me qëndrim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë në Kosovë, i cili merr pjesë në komunikacionin rrugor në Kosovë më tepër se tre muaj, nga data e hyrjes në Kosovë, ose i njëjti nuk e ka të rregulluar lejen e qëndrimit të përhershëm ose të përkohshëm nga vendi ku është i regjistruar mjeti ose nuk e ka treguar me kërkesën e personi të autorizuar, si dhe mjetin e regjistruar jashtë Kosovës nga paragrafi 5 i këtij neni është drejtuar nga personi pa prezencën e pronarit në mjetit.

306.10. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 270 €, shoferi i mjeteve komerciale (autobusët, mjetet e transportit me masën më të madhe se 3500 kg, mjetet për transportin e materieve të rrezikshme) pas krijimit të kushteve që me targat e regjistrimit mund të lëvizin jashtë Kosovës si dhe personi i cili e importon ndonjë mjet nga ndo një vend jashtë Kosovës e i cili nuk e ka të rregulluar qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm nga

vendi ku është importuar mjete, i njëjti merr pjesë në komunikacionin rrugor më tepër se deri 8 ditë nga data e hyrjes së mjetit në Kosovë.

#### Neni 307

307.1. Mjetet motorike dhe bashkangjitëse të regjistruara në ndonjë vend jashtë Kosovës mund të marrin pjesë në komunikacionin rrugor në territorin e Kosovës vetëm nëse e kanë lejen e komunikacionit valide të cilin e ka lëshuar organi kompetent i vendit në të cilin është i regjistruar mjete rrugor si dhe shenjen ndërkombëtare të vendit të regjistrimit ose targat e regjistrimit të lëshuar nga organi i vendeve në të cilin shenja dhe numri i targave është sipas rregullave të Unionit Evropian.

307.2. Mjete bashkangjites i huaj i cili nuk regjistrohet duhet në pjesën e prapme ta ketë targën e regjistrimit të përsëritur të mjetit tërheqës .

307.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 € shoferi që drejton mjetin i cili nuk është i regjistruar sipas rregullave të këtij neni.

307.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 € shoferi që për mjetin e regjistruar në vend të huaj nuk e ka lejen e komunikacionit të vlefshme, targat e regjistrimit, shenjen ndërkombëtare të vendit të regjistrimit ose e tërheqës mjetin bashkangjites të huaj i cili nuk është i regjistruar ose nuk e ka të përsëritur numrin e targave të mjetit tërheqës.

#### Neni 308

Për mjetet e shtetasve të huajve të cilëve i është lejuar qëndrimi i përkohshëm në Kosovë leja e komunikacionit i lëshohet me afat deri me datën e lejes së qëndrimit, gjegjësisht në kohën sa është i lejuar përkohësisht importi i mjetit në qoftë se ai afat është më i shkurt se leja e qëndrimit.

#### Neni 309

309.1. Personat munden përkohësisht të regjistrojnë mjetet motorike dhe bashkangjitëse.

309.2. Mjetet të cilat në Kosovë hyjnë me targat e huaja, të cilat shenjat dhe numrat nuk janë në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar edhe Kosova munden përkohësisht të regjistrohen.

309.3. Targat e përkohshme nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jenë më të shkurta se 60 ditë dhe as më të gjata se 12 muaj.

309.4. Mjetet nga paragrafi 2 i këtij neni mund përkohësisht të regjistrohen në kohë më të shkurt se 60 ditë. Për regjistrim të përkohshëm të mjetit lëshohet leja e komunikacionit me afat të vlefshëm të regjistrimit të përkohshëm.

#### Neni 310

310.1. Pronari i mjetit, i cili nuk e bën vazhdimin e lejes së komunikacionit në afat prej 30 ditë nga dita e skadimit të afatit të lejes së komunikacionit duhet ta çlajmëroj mjetin, ta kthej lejen e komunikacionit dhe tabelat e regjistrimit organit të cilat i ka lëshuar, gjegjësisht organit i cili e bën evidencën e mjetit (dosjen e mjetit).

310.2. Në afat nga paragrafi 1 pronari mjetit është i obliguar të lajmëroi ndërrimin e vendbanimit, gjegjësisht selinë, ose çfarë do të dhëne tjetër të cilat janë të shënuar në lejen e komunikacionit ose librezën e mjetit.

310.3. Pronari i mjetit duhet në afat prej 30 ditë të çlajmroj mjetin e regjistruar që ti kthen lejen e komunikacionit të mjetit dhe targat e regjistrimit nëse mjeti është i shkatërruar ose është i çregjistruar.

310.4. Pronari i mjetit i cili më së voni në afat prej 12 muaj nuk e bënë vazhdimin e regjistrimit të përkohshëm duhet të veproj sipas paragrafit 1 të këtij neni.

310.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 €, pronari që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni, ndërsa gjoba është 200 € nëse pronari në fjalë është organizatë afariste ose institucion publik.

#### Neni 311

311.1. Ministria e Punëve të Brendshme i lëshon targat provuese. Përrjashtimisht, targat provuese mund ti lëshoj edhe kompania e cila merret me shitjen e mjeteve me pakicë, vetëm për mjetet e pa regjistruara të cilat shiten nga vendi ku blihen deri te vendi ku regjistrohen, nëse i plotësojnë kushtet e parapara ligjore dhe nëse janë të autorizuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

311.2. Procedurat për dhënien e targave provuese përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 312

312.1. Targat e regjistrimit mund të prodhohen, pas marrjes së licencës, nga ndërmarrësi i cili përmbush kushtet e parapara me ligj.

312.2. Kushtet për marrjen e licencës për prodhimin e targave të regjistrimit, do ti përcaktoj me një akt nënligjor Ministria e Punëve të Brendshme.

312.3. Licenca për prodhimin e targave të regjistrimit mund të revokohet, nëse ndërmarrësi nuk ju përmbahet kriterëve të përcaktuara me akt nënligjor.

#### Neni 313

Targat e regjistrimit konsiderohen ligjore nëse mbajnë shenjën adekuate të përcaktuara nga autoriteti kompetent përkatës.

#### Neni 314

Ministria e Punëve të Brendshme do të shqyrtoj dhe zgjedh prodhuesin e dokumenteve të regjistrimit të zbrazëta, lejeve të përkohshme, shenjat e autenticitetit, etiketat e evidencës dhe evidencën e mjeteve, bazuar në parimet dhe rregullat për kryerjen e shërbimeve për projektet dhe aktivitetet publike.

#### Neni 315

315.1. Ministria e Punëve të Brendshme përcakton:

- a) parimet dhe procedurat për regjistrimin e mjeteve, mostrat e dokumenteve të regjistrimit, lejen e përkohshme, etiketën e evidencës, targat e regjistrimit dhe targat e tjera, tiparet dhe shenjat identifikuese që mund ti caktohen mjetit si dhe përshkrimi në detaje i tyre;
- b) parimet e shpërndarjes të dokumenteve të zbrazëta të mjeteve, dokumentet e lejeve të përkohshme dhe etiketat e evidencës.

315.2. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës, përcakton me anë të një akti nënligjor, kriteret dhe procedurat për regjistrimin të mjeteve në pronësi të Shërbimit Policor të Kosovës.

315.3. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Trupat e Mbrojtëse të Kosovës, përcakton me anë të një akti nënligjor, kriteret dhe procedurat për regjistrimin e mjeteve në pronësi të Trupave Mbrojtëse të Kosovës si dhe njësit përkatëse që të merren me regjistrimin e tyre.

315.4. Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës dhe Trupat e Mbrojtëse të Kosovës, do të zhvillojnë dhe caktojnë me anë të një marrëveshje mirëkuptimi, procedurat dhe kriteret në detaje lidhur me dokumentet e zbrazëta të regjistrimit dhe etiketat e evidencës të përmendura në Nenin 314.

### 3. KONTROLLIMI TEKNIK I MJETEVE

#### Neni 316

316.1. Për arsye të verifikimit të rregullsisë teknike të mjeteve me veprim motorik dhe mjeteve bashkëngjitëse (në tekstin e mëtejshëm: mjetet) kryhen kontrollimet teknike të këtyre mjeteve, përveç makinave të rënda punuese.

316.2. Kontrollimet teknike të mjeteve janë të rregullta, periodike dhe të jashtëzakonshme.

316.3. Në kontrollimin teknik vërtetohet se a posedon mjete me pajisjet dhe pajimet të parapara, a janë këto pajisje dhe pajime në rregull dhe a i plotësojnë kushtet e parapara teknike për pjesëmarrje në komunikacion në rrugë.

316.4. Për kontrollimin e kryer teknik të mjeteve, mbahet evidenca.

#### Neni 317

317.1. Mjetet e reja të cilat marrin pjesë në komunikacionin rrugorë, do ti nënshtrohen kontrollimit të rregullt teknik gjatë muajit në të cilin i kalon afati prej 24 muajsh nga kontrollimi i parë teknik.

317.2. Mjetet më të vjetra se dy ose më tepër vite, i nënshtrohen kontrollimit të rregullt teknik në çdo 12 muaj.

317.3. Afati i vlefshmërisë së kontrollimit teknik të rregullt (leja e komunikacionit) shënohet me shenjë të veçantë ose tiketë ngjitëse në anën e përparme të mjetit.

317.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € edhe shoferi nëse nuk e ka të vendosur tiketën ngjitëse sipas rregullave të paragrafit 3 të këtij neni.

317.5. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit nëpërmjet një akti të veçantë juridik do të përcaktoj rregullat dhe procedurat për kontrollimin teknik të mjeteve.

#### Neni 318

318.1. Në mjetet që huazohen, mjetet me të cilat bëhet aftësimi i kandidatëve për patentë shoferë, mjetet taksì, autobusët, mjetet transportuese për bartjen e mallrave të rrezikshme, mjetet transportuese masa më e madhe e lejuar e të cilave kalon mbi 7.500 kg dhe mjetet bashkangjitëse (në tekstin e mëtuftjeshëm: rimorkio), kryhet kontrollimi teknik preventiv në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni.

318.2. Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, kontrollimit teknik periodik nuk i nënshtrohen rimorkiot e lehta, rimorkiot për banim, rimorkiot e traktorit, mjetet e destinuara për bartjen e të vjelave, për argëtim dhe mjeteve për punëtori.

318.3. Kontrollimet teknike preventive të mjeteve kryhen çdo ditë (kontrollë teknike preventive ditore) dhe në afatet e parapara (kontrollimet teknike periodike preventive – çdo 6 muaj).

#### Neni 319

319.1. Personat të cilët prodhojnë, mirëmbajnë, riparojnë mjete ose vejnë në komunikacion mjete, pajime, pjesë rezervë dhe pajisje për mjete janë të obliguar që mjetet, pajimet, pajisjet ti prodhojnë, ti vejnë në komunikacion, mirëmbajnë, gjejësisht ti riparojnë sipas kushteve të parapara për pjesëmarrje të sigurt të mjeteve në komunikacion.

319.2. Personat e autorizuar janë të obliguar ti dërgojnë në kontrollim teknik të jashtë zakonshëm mjetet të cilat kanë marrë pjesë në aksident të komunikacionit.

319.3. Në kontrollim të jashtëzakonshëm teknik do të dërgohet edhe mjete për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se i është vërtetuar rregullsia teknike e nuk ka qenë në kontrollim teknik ose kontrollimi teknik nuk është kryer sipas rregullave të parapara.

319.4. Mjetet paragrafi 2. dhe 3. të këtij neni i urdhëron për në kontroll të jashtëzakonshme teknike, personi zyrtar i autorizuar (Policia).

319.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 400 deri 3.400 € personi nëse prodhon, mirëmban, riparon ose i ven në komunikacionin rrugor mjetet, pajisjet, pajimet ose pjesët rezervë ose nëse mjete nuk ju ka nënshtruar kontrollimit të jashtëzakonshëm para se të marr pjesë në komunikacionin rrugor.

319.6. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € edhe pronari, nëse mjete nuk iu ka nënshtruar kontrollit teknik të jashtëzakonshëm.

#### Neni 320

Kontrollimet teknike të mjeteve i kryejnë subjektet për kontroll teknike të licencuara nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit pasi që ti kenë plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara, të përcaktuara me një akt nënligjor nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

### Neni 321

321.1. Kontrollimin teknik të mjeteve e kryejnë personat që kanë të kryer shkollën e mesme drejtimi i komunikacionit, makinerisë, automekanik dhe auto-elektricitë, i cili ka dëshmi se është trajnuar dhe aftësuar në institucionin përkatës për aftësimin e personave për profesionin e kontrolluesit të mjeteve.

321.2. Programin e trajnimit nga paragrafi 1. të këtij neni e përpilon institucioni përkatës.

321.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 530 deri 2.300 € personi që kryen kontrollimin teknik për të cilin nuk ka autorizim (licencën e vlefshme).

### Neni 322

322.1. Tarifa për kontrollimin teknik dhe për punët tjera të cila i kryen subjekti i licencuar i kontrollimit teknik, sipas kategorive të mjeteve, është i njëjtë në tërë territorin e Kosovës.

322.2. Lartësia e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave me një akt të veçantë juridik.

### Neni 323

323.1. Kompensimin për kontrollimin teknik të rregullt, periodik dhe të jashtëzakonshëm e paguan pronari i mjetit.

323.2. Pronari i mjetit paguan kompensimin për kontrollim të jashtëzakonshëm teknik të mjetit, nëse vërtetohet se mjete nuk është në gjendje të rregullt teknike.

323.3. Në qoftë se mjete është në gjendje teknike të rregullt, në kontrollim të jashtëzakonshëm të mjeteve, shpenzimet i kompenson personi zyrtar i autorizuar (Shërbimi Policor i Kosovës) ose organi tjetër i cili e ka urdhëruar për në kontrollim të jashtëzakonshëm.

### Neni 324

324.1. Subjekti për kontrollim teknik të mjeteve është i obliguar të kryej kontrollimin teknik të mjeteve me pajisje të parapara të cilat janë të atestuara dhe teknikisht në rregull, sipas normave për kryerjen e kontrollimit teknik të mjeteve dhe rregullsisë teknike të mjeteve.

324.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 3.500 deri 5.500 € subjekti për kontrollim teknik nëse urdhëron ose lejon që kontrollimi teknik të kryhet në pajisjet dhe pajimet të cilat nuk janë sipas rregullave ose të prishura ose në kundërshtim me rregullat e kontrollimit teknik.

### Neni 325

325.1. Subjekti i kontrollimit teknik është i obliguar të mbajë evidencë, ti përpunojë të dhënat mbi kontrollimet e bëra teknike dhe parregullsitë e konstatuara të mjeteve dhe për çdo kontroll teknike të lëshojë vërtetim për gjendjen faktike.

325.2. Për kundërvajtje nga ky nen, dënohet me gjobë prej 3.500 deri 8.500 € subjekti për kontrollim teknik nëse urdhëron ose lejon që të mos mbajë evidencë, ti përpunojë të dhënat mbi kontrollimet e bëra teknike dhe parregullsitë e konstatuara të mjeteve ose nëse e lëshon vërtetimin në mospërputhje me gjendjen faktike.

#### Neni 326

326.1. Subjekti për kontrollim teknik të mjeteve është i obliguar ti mbajë në gjendje të rregullt objektet, pajisjet dhe pajimet.

326.2. Pajisjet dhe pajimet për kontrollimet teknike të mjeteve i nënshtrohen kontrollit të nivelizimit (bazhdarimit) sipas rregullave dhe kushteve teknike së paku njëherë në vit, kurse mbikëqyrjes në çdo tre muaj.

326.3. Kontrollimin e pajisjeve dhe pajimeve sipas paragrafit. 2. të këtij neni e kryen institucioni i cili për këtë është i autorizuar.

326.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 1.500 deri 3.500 € subjekti për kontrollim teknik nëse nuk i ka në gjendje të rregullt objektet, pajisjet dhe pajimet ose nëse këto pajisje dhe pajime për kontroll teknike të mjeteve nuk ju kanë nënshtruar kontrollimit të nivelizimit.

#### Neni 327

Mbikëqyrjen e punës të Subjekteve për kontrollimin teknik të mjeteve e kryejnë personat e autorizuar të Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

#### Neni 328

328.1. Nëse punëtori i autorizuar nga neni 327 i këtij ligji, konstaton që subjekti i kontrollimit teknik të mjeteve, shfrytëzon pajisjet dhe pajimet që nuk janë në rregull, që objekti dhe hapësira nuk i plotësojnë kushtet e parapara, që kontrollimet teknike të mjeteve i kryen personi i cili nuk posedon dëshmi trajnimi ose punët që i janë besuar institucionit për kontrollimin teknik të mjeteve nuk kryhen sipas rregullave dhe akteve të përgjithshme, me vendim do ti caktojë afatin për eliminimin e mangësive.

328.2. Nëse subjekti për kontrollim teknik të mjeteve nuk i eliminon mangësitë e konstatuara, në afatin e paraparë punëtori i autorizuar i propozon Ministrisë së Transportit dhe Post-Telekomunikacionit që të bëjë pezullimin ose revokimin e licencës për kryerjen e kontrollimit teknik të mjeteve.

328.3. Kundër këtij vendimi nga paragrafi 2 i këtij neni, në afatin prej 8 ditësh, mund të paraqitet ankesa në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit. Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

328.4. Subjekti i pa kënaqur me vendimin e marrë lidhur me ankesën nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, ka të drejtë të paraqet ankesë në Gjykatën kompetente.

328.5. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 3.500 deri 8.500 €, subjekti i kontrollimit teknik nëse vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 329

329.1. Mbikëqyrësit dhe punëtorët të cilët e kryejnë kontrollimin teknik të mjeteve janë të obliguar ti nënshtrohen trajnimit profesional në çdo dy vjet.

329.2. Trajnimin profesional e organizon Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit në bashkëpunim me subjektet e kontrollimit teknik.

329.3. Shpenzimet financiare për trajnimin profesional i bartë subjekti i kontrollimit teknik.

329.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 700 deri 1.500 € subjekti i kontrollimit teknik nëse vepron në kundërshtim me rregullat e paragrafit 1 të këtij neni.

## Neni 330

330.1. Nëse subjekti i kontrollimit teknik të mjeteve, në kontrollimin teknik konstaton se mjete nuk është në gjendje teknike të rregullt ashtu që mjete i tillë do të rrezikonte sigurinë e komunikacionit në rrugë, mjetit të tillë nuk i lëshohet vërtetimi mbi gjendjen teknike të rregullt.

330.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 5.000 deri 8.500 €, subjekti i kontrollimit teknik nëse urdhëron, lëshon, vërtetimin për mjetin i cili nuk është në gjendje teknike të rregullt ose nuk iu ka nënshtuar fare kontrollit teknik dhe të njëjtit i merret licenca në periudhën prej tre gjerë në gjashtë muaj.

## Neni 331

331.1. Kontrollimi teknik i mjeteve të cilat janë pronë e Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës, mund të kryhet nga subjektet e veta përkatëse për kontrollim teknik, të licencuar nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

331.2. Qendra e Kontrollimit teknik të mjeteve të Shërbimit Policor të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës, mund të bëjë kontrollimin teknik të mjeteve, vetëm të këtyre Institucioneve.

331.3. Në çoftë se Subjektet e kontrollimit teknik të cekura në këtë nen nuk i përmbahen paragrafit 2 të këtij neni, atëherë Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit mund t'ia pezulloj apo revokoj licencën.

## 4. EGZAMINIMI DHE HOMOLOGIMI I MJETEVE

### Neni 332

332.1. Prodhuesi ose importuesi i një tipi të ri të një mjetit motorik ose rimorkio si dhe elementeve të pajisjeve apo pjesëve të tyre, i cili udhëheq biznesin në këtë lëmi, obligohet të marr certifikatën e homologimit (përshtatshmërisë) të mjetit, të lëshuar nga institucioni kompetent.

332.2. Prodhuesi i mjetit të lartë përmendur në paragrafin 1, konsiderohet të jetë subjekti i cili monton ose furnizon mjetin.

332.3. Rregullat në paragrafin 1 i referohen gjithashtu rastit, kur mjete pajiset me instalimin për shfrytëzimin e gazit si derivate.



332.4 Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 €, personi që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

#### Neni 333

333.1. Certifikata e homologimit (përshtatshmërisë) jepet në bazë të rezultateve të testit të homologimit, i drejtuar në mënyrë që të kontrollohet nëse tipi i dhënë i mjetit, pajisjeve ose pjesëve të tij, janë në pajtim me kriteret teknike të parapara, si dhe rregulloreve që janë në përputhje me marrëveshjet, konventave ndërkombëtare, në të cilat Kosova, mund të jetë anëtare.

333.2. Shpenzimet për të bërë testin e homologimit (përshtatshmërisë) i bart prodhuesi, importuesi ose subjekti që i monton mjetet.

333.3. Nëse mjete të tipit të caktuar, prodhohet nga më shumë se një prodhues, testet e homologimit bëhen ndaras për secilin variant të këtyre mjeteve.

#### Neni 334

334.1. Në rast të paraqitjes së ndryshimeve në dizajnin e mjetit, pjesëve, pajisjeve ose pajisjeve shtesë të tij, që nuk janë në përputhje me certifikatën e homologimit, prodhuesi ose importuesi i mjetit obligohet, që të marr një certifikatë të re të homologimit (përshtatshmërisë) nga institucioni kompetent.

334.2. Institucioni kompetent e revokon certifikatën e homologimit, apo te autorizimit të dhënë për subjektet nëse mendohet se mjete të caktuar, pjesët ose pajisjet e tij, nuk janë në përputhje me certifikatën e homologimit.

334.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 2.500 € personi që vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

#### Neni 335

Rregullat nga neni 334 të këtij ligji nuk zbatohen mbi:

- a) mjetin e të vjelave;
- b) mjetin e prodhimit vendor;
- c) mjetin special, që përdoret për qëllime speciale nga Policia, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Autoritetet e Burgut dhe njësive zjarrfikëse.

#### Neni 336

Mjetet e përmendura në nenin 335 të këtij ligji mund të nënshtrohen testeve për përshtatjen me kriteret teknike dhe këto teste bëhen në shpenzime të pronarëve të mjeteve.

#### Neni 337

Autoriteti me kompetencë përkatëse duke marr parasysh marrëveshjet, konventat ose urdhëresat ndërkombëtare lidhur me testet e homologimit, do të përkufizoj me anë të një

akti nënligjor, procedurat e dhënies ose revokimit të certifikatave të homologimit, mbikëqyrja e procesit të prodhimit dhe montimit të mjeteve, formateve të dokumenteve të nevojshme në lidhje me homologimin dhe do të mbikëqyrë prodhimin ose montimin e mjeteve, në pajtim me kriteret teknike të përcaktuara, duke marr parasysh, domosdoshmërinë e sigurimit të përdorimit të sigurt të mjeteve dhe gamën e kushteve teknike të mjeteve të cilat duhet të testohen, do të përkufizoj me anë të një akti nënligjor gamën dhe mjetet për testimin e këtyre mjeteve të përmendura në nenin 334 të këtij ligjit, për përshtatjen e tyre me kushtet teknike, si dhe formatin e dokumenteve të nevojshme që nevojiten për testimin e tillë nga institucionet përkatëse.

#### Neni 338

338.1. Prodhuesi ose importuesi i mjeteve të reja, obligohet që të lëshojë, nëse kërkohet, një ekstrakt nga certifikata e homologimit (përshtatshmërisë), të cilit do mjet, për të cilën certifikata e tillë është dhënë dhe të lëshoj një kopje të vendimit administrativ që e liron nga detyrimi për nënshtrimin e mjetit të caktuar në testin e homologimit.

338.2. Ekstrakti i lartë-përmendur nga certifikata e homologimit, ose një kopje e vendimit të përmendur më lartë në paragrafin 1, i dorëzohen pronarit të mjetit.

338.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 3.500 € personi nëse vepron në kundërshtim me rregullat e këtij neni.

### KAPITULLI XI MASAT E VEÇANTA PËR SIGURINË E KOMUNIKACIONIT NË RRUGË

#### Rregullat e përgjithshme

#### Neni 339

339.1. Polici i Shërbimit Policor të Kosovës, i cili bën mbikëqyrjen e shoferëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në komunikacionin rrugor, është i autorizuar mbi çdo pjesëmarrës në komunikacion - i cili me sjelljen e vet e pengon ose e rrezikon komunikacionin, të zbatojë procedurën e hulumtimit me anë të mjeteve dhe të aparateve përkatëse (alkometrit etj.), të matura sipas dispozitave për kriteret dhe për kushtet e kriterëve, për të konstatuar praninë e alkoolit, e drogave narkotike apo medikamenteve në organizëm, në të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes, përkatësisht është i autorizuar pas kësaj, kështu që ata persona me të njëjtin qëllim të dërgohen për të dhënë gjak dhe urinën apo për kontrollim mjekësor.

339.2. Para se të ndërmer veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, polici i Shërbimit Policor të Kosovës, mund t'ia nënshtrojë shoferin procedurës së rinjohjes së shenjave që janë pasojë e pranisë së alkoolit, drogave narkotike apo medikamenteve në organizëm, në të cilat shënohen se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes.

339.3. Polici i Shërbimit Policor të Kosovës, do t'i dërgojë, për të dhënë gjak dhe urinën për analizë edhe personat, kur pohojnë rezultatet e hulumtimit se, në organizëm, kanë droga narkotike apo medikamente në të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes, të konstatuara me mjete dhe aparate përkatëse dhe kur kërkojnë për të dhënë gjak dhe urinën për analizë, përkatësisht për kontrollim mjekësor.

339.4. Personat nga paragrafët 1 e 2 të këtij neni kanë për detyrë të veprojnë sipas kërkesave të personit të autorizuar - Policit.

339.5. Polici i Shërbimit Policor të Kosovës, për veprimet e ndërmarra nga paragrafët 1 e 3 të këtij neni dhe nenit 211 të këtij Ligji, patjetër përpilon procesverbalin, përkatësisht kërkesën për kontrollim mjekësor, dhënie të gjakut e urinës - për analizë.

339.6. Personi, për të cilin me hulumtim në njërin nga mënyrat nga paragrafi 1 i këtij neni është konstatuar se ka në organizëm alkool, droga narkotike apo medikamente në të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes, heq shpenzimet e hulumtimit, kurse personi nga paragrafi 3 i këtij neni i heq edhe shpenzimet e dërgimit me mjet zyrtar policie - për kontrollim mjekësor, dhënie gjaku dhe urine - për analizë.

339.7. Procedurën dhe mënyrën e të vepruarit të policit të Shërbimit Policor të Kosovës, për rinjohjen e shenjave e të simptomave të pranisë së alkoolit, drogave narkotike apo medikamenteve në organizëm, në të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes paragrafi 2 i këtij neni, do t'i përcaktojë Shërbimi Policor i Kosovës në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë, me anë të një akti nënligjor.

339.8. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 35 € pjesëmarrësi në komunikacionin rrugor, përveç shoferit dhe shofer instruktorit, i cili refuzon ti nënshtrohet kontrollimit ose ekzaminimit shëndetësor gjegjësisht dhënien e gjakut dhe urinës.

339.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 deri 130 € shoferi i biçikletës, qerres ose kandidati për shofer i cili refuzon ti nënshtrohet kontrollimit ose ekzaminimit (testimit) shëndetësor gjegjësisht dhënien e gjakut dhe urinës.

339.10. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi i mjeteve motorike i cili refuzon ti nënshtrohet kontrollimit ose ekzaminimit (testimit) shëndetësor gjegjësisht dhënien e gjakut dhe urinës dhe i shqiptohet masa e ndalimit e drejtuarit e mjetit motorik së paku gjashtë muaj dhe pesë pikë negative.

#### Neni 340

340.1. Shpejtësia e lëvizjes së mjetit konstatohet me pajisje të matjes së shpejtësisë së lëvizjes së mjetit, me të dhëna në tahograf apo duke ndjekur (përcjellë) drejtpërdrejt mjetin.

340.2. Fotografia dhe video-përshkrimi me të dhëna për shpejtësinë e konstatuar, të dhënat në tahograf dhe procesverbali për leximin në radar pa përshkrim dhe pa shpejtësimatës, shërbejnë si provë e shpejtësisë së konstatuar të lëvizjes së mjetit.

340.3. Nuk mundën të shfrytëzohen ose të instalohen pajisjet apo pajimet në mjet të cilat kanë qëllim të pengojnë pajisjet të cilat i shfrytëzojnë personat e autorizuar të cilët mbikëqyren komunikacionin në rrugë. Nëse personi i autorizuar takon shoferin i cili i shfrytëzon ose i ka të instaluar në mjet këto pajisje ose pajime e urdhëron shoferin që ta mënjanojë, e nëse shoferi refuzon ta bëjë këtë, pajisja ose pajisja do të hiqen me shpenzime të shoferit.

340.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 140 €, shoferi që shfrytëzon ose i ka të instaluar në mjet pajisjet dhe pajimet të cilat i shfrytëzojnë personat e autorizuar të cilët kryejnë mbikëqyrjen e komunikacionit në rrugë.

## Neni 341

341.1. Shërbimi Policor i Kosovës, do t'i marrë patentën, shoferit dhe shofer instruktorit-Licencën për të cilin gjatë kontrollimit konstatohet se është bërë i paaftë fizikisht apo psikikisht për të drejtuar mjetin, për kohën derisa zgjatë ajo paaftësi.

341.2. Shoferit apo shofer instruktorit, i cili ka të drejtë të drejtojë mjete motorike kategorish më të larta, e kjo e drejtë për kategori të caktuara i kufizohet për shkaqe të parapara në paragrafin 1 të këtij neni, do t'i anulohen në patentë ato kategori ose, me kërkesën e tij, do t'i jepet patentë e re e shoferit, në të cilën do t'i shënohen ato kategori mjete motorike që ka të drejtë t'i drejtojë.

341.3. Shoferit apo shofer instruktorit, i cili nuk i nënshtrohet kontrollimit shëndetësor mbikëqyrës në të cilin është dërguar, do t'i merret patentë gjithnjë derisa të mos i nënshtrohet atij kontrolli.

341.4. Kundër vendimit për marrjen e patentë shoferit ose licencën e shofer-Instruktorit në afat prej tri ditësh, mund t'i paraqes ankesë në tek organet kompetente, e cili do të vendosë për të në afat prej 8 ditësh që nga dita e paraqitjes së ankesës.

## Neni 342

342.1. Personi i autorizuar i Shërbimit Policor të Kosovës do t'i marrë përkohësisht patentë shoferin ose shofer instruktorit licencën dhe do ta largojë nga komunikacioni në rastet vijuese:

- a) i cili drejton ose tenton të drejtojë mjetin, e që ka alkool a droga narkotike në organizëm apo tregon shenja alkoolizmi (neni 227 dhe 228 të këtij ligji);
- b) i cili drejton ose tenton të drejtojë mjetin, nëse është e qartë se shoferi është në një gjendje të tillë psikofizike (lodhje, stres, sëmundje, prani të medikamenteve në organizëm në të cilat është dhënë shënimi se nuk duhet të përdoren para e as gjatë ngasjes ) që nuk është i aftë të drejtojë në mënyrë të sigurt mjetin (neni 226 i këtij ligji);
- c) i cili nuk ka mjete ndihmëse për të cilat është dhënë shënimi në patentën e shoferit se duhet t'i shfrytëzojë gjatë drejtimit të mjetit (neni 225, paragrafi 3 i këtij ligji);
- d) i cili drejton mjetin në kundërshtim me rregullat e nenit 269 të këtij ligjit;
- e) i cili nuk vepron sipas kërkesës së policit që ti nënshtrohet hulumtimit a kontrollit profesional neni 339, paragrafi 4, i këtij ligji.

342.2. Polici do të përjashtojë nga komunikacioni:

- a) shoferin e motoçikletës apo të biçikletës me motor dhe personat, të cilët mbarten me ato mjete rrugore, po që se nuk kanë me vete helmetën mbrojtëse apo refuzojnë ta mbajnë mbi kokë (neni 132 i këtij ligji);
- b) shoferin, të cilin e has duke drejtuar mjetin para se të fitojë të drejtën për të drejtuar një mjet, i cili drejton mjetin, e nuk ka patentë të vlefshme shoferi të kategorisë përkatëse ose i cili drejton mjetin në kohën kur patentë i është marrë përkohësisht ose kur - me vendim të plotfuqishëm të organit kompetent - i është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalesës së drejtimit të mjetit të llojit a kategorisë së caktuar;

- c) shoferin, i cili nuk vepron në pajtim me nenin 295 të këtij ligji;
- d) shoferin i cili në distancë prej së paku 20 metra nuk mund ti lexoj tabelat e regjistrimit ose mos dallimi i ngjyrës nga e njëjta distancë.

342.3. Në bazë të rregullave të paragrafit 1të këtij neni, patenta e shoferit merret përkohësisht deri në shfuqizimin e shkaqeve për shkak të të cilave është marrë, e më së shumti deri 30 ditë.

342.4. Në qoftë se në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni shoferi nuk e rimerr patentën që i është marrë përkohësisht, kur shfuqizohen shkaqet për shkak të të cilave i është marrë ose në afat 30 ditësh që nga dita e marrjes së përkohshme, patenta e shoferit do t'i dërgohet organit në evidencën e të cilit mbahet. Organit, në evidencën e të cilit shoferi e evidenton patentën, do t'ia dërgojë atë edhe në rast se ndërkohë organi kompetent ka nxjerr vendim të plotfuqishëm për dënimin dhe për masën e shqiptuar mbrojtëse.

342.5. Më rastin e veprimit ndaj shoferit a shofer instruktorit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, polici do t'i bëjë të mundshme shoferit që në afat të përshtatshëm të ftohet një shofer tjetër, i cili i përmbush kushtet për të drejtuar mjetin në komunikacion, të rimerr mjetin, të larguar nga komunikacioni, që e ka drejtuar shoferi.

342.6. Po që se shoferi tenton ose vazhdon të drejtojë mjetin, pas largimit nga komunikacioni rrugor dhe vazhdon të bëjë kundërvajtjen për shkak të cilës është larguar nga komunikacioni, polici do ta largojë shoferin përsëri nga komunikacioni dhe në pajtim me nenin 100 të këtij ligji do të japë urdhëresë për të zhvendosur mjetin. Mjeti i zhvendosur mund të merret posa të pushojnë shkaqet e zhvendosjes e më së voni në afat prej tetë ditësh. Pas kësaj, mjeti do t'i jepet për ruajtje personit juridik përkatës, me shpenzime të pronarit.

#### Neni 343

343.1. Për kundërvajtje të caktuara nga ky ligj, kryesit e kundërvajtjes, përveç shqiptimit të dënimin dhe masës mbrojtëse të ndalesës së drejtimit të mjetit, do t'i shqiptohen edhe pikët negative prej një deri pesë, varësisht nga pesha e kundërvajtjes.

343.2. Pikët negative evidencohen në bazë të vendimit të plotfuqishëm për dënimin.

343.3. Pikët negative të shqiptuara evidencohen në evidencën e shoferit.

#### Neni 344

344.1. Shoferin, të cilit, në një periudhë prej tri vjetësh (36 muaj), për shkak kundërvajtjesh të bëra nga ky ligj, i janë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm së paku gjashtë pikë negative, Shërbimi Policor i Kosovës, do ta ftoj për vijimin e ligjëratave në shkollën "Ngasja e sigurt", nëse i njëjti i vijon rregullisht ligjëratat, i lëshohet vërtetimi, në të kundërtën do ti shqiptohet masa e ndalimit për drejtimin e mjetit së paku tre muaj dhe e njëjta vazhdon derisa nuk i vijon ligjëratat me rregull.

344.2. Në qoftë se shoferi, për shkaqe të arsyeshme, nuk i përgjigjet ftesës dhe nuk merr pjesë në ligjëratë, Shërbimi Policor i Kosovës do ta ftojë përsëri brenda një afati prej tre muajve.

344.3. Shoferit, i cili pa arsye nuk i përgjigjet ftesës për pjesëmarrje në ligjërata, do t'i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalesës së drejtimit të mjetit në kohëzgjatje së paku tre muajsh.

344.4. Shoferit, të cilit, në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, për shkak kundërvajtjesh të bëra nga ky ligj, i janë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm së paku nëntë pikë negative, do t'i shqiptohet masa mbrojtëse e shfuqizimit të patentës së shoferit.

344.5. Në qoftë se shoferi nga paragrafi 4 i këtij neni, e ka profesion kryesor drejtimin e mjetit apo mjeti i shërben ekskluzivisht për të realizuar të hyra për jetë, e këtë e argumenton në mënyrë të besueshme, në vend të masës së shfuqizimit të patentës së shoferit, mund t'i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalesës së drejtimit të mjetit në kohëzgjatje deri 12 muaj.

344.6. Shoferi, nga paragrafi 4 i këtij neni, mund t'i qaset ridhënies së provimit për shofer, pasi të kalojnë 12 muaj që nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit përmes të cilit shfuqizohet patenta e shoferit, kurse shoferi nga paragrafi 5, para se t'i kthehet patenta e shoferit, ka për detyrë të japë provimin nga lënda "Njohja e rregullave të komunikacionit dhe të sigurisë" (pjesa teorike) në shkollën "Ngasja e Sigurt". Në rast të mosdhënies së provimit, i njëjti mund t'i nënshtrohet provimit pas kalimit të një periudhe tremujore.

344.7. Kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, personi, të cilit i është shqiptuar masa mbrojtëse, ka të drejtë kundërshtimi në afat tetë ditësh që nga dita e dërgimit të vendimit. Ankesa e shtynë ekzekutimin e vendimit.

344.8. Shoferi, i cili është thirrë dhe është i pranishëm në ligjërata në shkollën "Ngasja e sigurt", heq shpenzimet e ligjëratave në shumën që e cakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në bashkëpunim me Shërbimin Policor të Kosovës.

344.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 deri 170 € shoferi që nuk vepron sipas rregullave nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, gjegjësisht shoferi sipas paragrafit 6 të këtij neni nëse nuk i nënshtrohet provimit nga lënda "Rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë" në shkollën "Ngasja e sigurt".

344.10. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 65 € shoferi që në afat prej 8 dite nga dita e vendimit të nxjerr nga Gjykata kompetente, nuk ia dërgon patentë shoferin Shërbimit Policor të Kosovës ku e ka evidencën (dosja e shoferit) për të shënuar shqiptimin e masës së ndalimit të drejtuarit e mjetit motorik ose ndërprerja e vlefshmërisë së patentë shoferit.

#### Neni 345

Pikët negative për të cilat ka filluar rehabilitimi, përkatësisht që me kalimin e 36 muajve janë fshirë nga evidenca ndëshkimore, nuk mund të jenë bazë shqiptimi të masës mbrojtëse të ndalesës së drejtimit të mjetit e as nuk duhet të jepen për shikim.

#### Neni 346

346.1. Personit, nga neni 242 të këtij ligji, i cili refuzon t'i nënshtrohet verifikimit të njohurive apo i cili gjatë verifikimit të njohurive nuk tregon rezultate pozitive, do t'i merret licenca, përkatësisht do t'i ndalohet puna derisa të tregon rezultate pozitive.

346.2. Personat, nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët gjatë verifikimit të njohurive nuk tregojnë rezultat pozitiv, me kërkesën e tyre mund t'i nënshtrohen verifikimit të serishëm pas afatit të cilit e cakton Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit e jo me pak se 15 ditë që nga dita e verifikimit të fundit.

346.3. Në qoftë se personat, nga paragrafi 1 i këtij neni, edhe pas tri verifikimeve nuk tregojnë njohuri të mjaftueshme, nuk mund t'i qasen verifikimit të serishëm derisa të kalojnë gjashtë muaj që nga dita e verifikimit të fundit.

#### Neni 347

347.1. Shoferi, të cilit i është marrë patenta e shoferit (neni 211) apo është larguar nga komunikacioni (neni 212) ose i është shqiptuar masa e ndalesës së drejtimit të mjetit motorik ose masa e ndalesës së vlefshmërisë së patentës së shoferit, nuk duhet të drejtojë gjatë asaj kohe mjetin motorik në komunikacionin rrugor.

347.2. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 400 deri 800 €, personi nëse urdhëron ose lejon shoferin të cilit i është marr patentë shoferi ose iu është shqiptuar masa e ndalimit të drejtuarit e mjetit motorik i cili drejton mjetin në komunikacionin rrugor për atë kohë.

347.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 200 deri në 400 €, shoferi të cilit i është marr patentë shoferi ose ju është shqiptuar masa e ndalimit të drejtuarit të mjetit motorik i cili drejton mjetin në komunikacionin rrugor për atë kohë ose nuk posedon fare patentë shofer.

#### Neni 348

348.1. Në qoftë se polici has mjetin në rrugë që, për shkak të parregullsisë teknike (mekanizmi jo në rregull i drejtimit, mekanizmat e ndalimit, mekanizmi i lidhjes së mjetit tërheqës dhe i mjetit të bashkëngjitur në kohën kur tërheq mjetin e bashkëngjitur, dritat jo në rregull për ndriçimin e rrugës dhe për shënimin e mjetit dhe sinjalizimi i parregullt ndriçues natën dhe ditën në kohën e dukshmërisë së zvogëluar, fshesat e parregullta të xhamit të përparmë në kohën e ngasjes nëpër shi dhe të reshura bore, gomat e vjetruara ose qenësisht të dëmtuara dhe nëse në mjet ka mekanizma të instaluar për dhënien e shenjave ndriçuese dhe tonike nga neni 169 i këtij ligjit rrezikon ose pengon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion ose në të cilin ngarkesa është vendosur në mënyrë të parregullt, përkatësisht është siguruar në mënyrë të pamjaftueshme, ose me të cilin transporton pa leje ngarkesën dimensionet, përkatësisht masa e së cilës i tejkalon dimensionet më të mëdha të lejuara, përkatësisht masën ose ngarkesën aksiale, do ta urdhërojë shoferin që menjëherë të ndërpres lëvizjen e mjetit dhe të mënjanojë parregullsinë ose ta shpie mjetin deri në vendin e caktuar ku mund të mënjanojë parregullsinë, përkatësisht të sigurojë lejen për transportim të jashtëzakonshëm.

348.2. Në qoftë se polici has mjetin, që lëviz në rrugë në të cilën lëvizja e atij lloji mjetesh është e ndaluar ose lëviz pa pajisje dimërore në pjesën e rrugës dhe në kohën kur pajisja dimërore është e obligueshme, do t'i urdhërojë shoferit që menjëherë të ndërpres lëvizjen e mjetit ose të vazhdojë lëvizjen e mjetit në rrugë në të cilën lëvizja e atij lloji mjetesh lejohet, përkatësisht ta përdor pajisjen dimërore.

348.3. Polici mund ta urdhërojë shoferin që ta çojë mjetin në kontrollim teknik për të konstatuar parregullsitë ose ta urdhërojë në bashkëpunim me mbikëqyrësin e aftësuar profesional të personit juridik, i cili qeveris dhe zotëron rrugët publike, të bëhet kontrolli i masës së përgjithshme, i ngarkesës boshtore dhe i dimensioneve të mjetit. Në qoftë se në këto kontrollime konstatohet se mjete nuk është në rregull teknikisht ose e tejkalon masën e lejuar apo ngarkesën boshtore ose fuqinë mbartëse të tërësishme a dimensionet e mjetit, shpenzimet e kontrollimit i heq shoferi.

348.4. Polici do të largojë nga komunikacioni edhe mjetin që nuk është regjistruar apo që nuk ka targat e caktuara të regjistrimit ose që nuk i është nënshtruar në afat të caktuar kontrollimit teknik të rregullt a të jashtëzakonshëm ose për të cilin mjet nuk është vazhduar vleftëshmëria e lejes së komunikacionit.

348.5. Në qoftë se shoferi nuk vepron sipas urdhrit nga paragrafi 1, 2 e 3 të këtij neni, polici do ta largojë mjetin nga komunikacioni. Largimi i mjetit nga komunikacioni zgjat gjithnjë derisa të mos mënjanohej shkaqet për shkak të cilave është larguar mjete.

348.6. Shoferi është i detyruar që mjetin e larguar ta mënjanojë menjëherë nga rruga në vendin në të cilin nuk do të rrezikojë sigurinë e komunikacionit ose nuk do të pengojë rrjedhën normale të komunikacionit (në vendet e caktuara për parkim të mjeteve), e më së voni në afat prej 12 orësh, shoferi ka për detyrë të mënjanojë mjetin e larguar nga vend parkimet apo nga vende të ngjashme.

348.7. Në qoftë se shoferi vazhdon të drejtojë mjetin pasi që mjete i tij është larguar nga komunikacioni rrugor apo nuk e mënjanon mjetin në përputhje me rregullat e paragrafit 6 të këtij neni, do ta largojë përsëri mjetin nga komunikacioni, ose në pajtim me nenin 100 të këtij Ligji do të japë urdhër për zhvendosjen e tij në vend tjetër.

348.8. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 € shoferi që në komunikacionin rrugor drejton mjetin i cili është i larguar nga komunikacioni.

348.9. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 300 deri 700 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

#### Neni 349

349.1. Polici, i cili ia ka larguar shoferit mjetin nga komunikacioni, do t'ia marrë përkohësisht targat e regjistrimit.

349.2. Polici, i cili ka larguar nga komunikacioni mjetin, të destinuar për transportimin e materieve të rrezikshme, për shkak të kundërvajtjes nga neni 348 i këtij Ligji, do të marrë përkohësisht edhe certifikatën ADR të mjetit.

349.3. Shërbimi Policor i Kosovës i cili ka marrë përkohësisht targat e regjistrimit, kanë për detyrë t'ia kthejnë këto shoferit kur eliminohen shkaqet për shkak të të cilave janë marrë.

349.4. Në qoftë se shoferi, në afat prej 30 ditësh, nuk i mënjanon shkaqet për shkak të cilave mjete është larguar nga komunikacioni dhe nuk i rimerr targat e marra të regjistrimit, ato do t'ia dërgojë organit, i cili mban mjetin në evidencë.

349.5. Polici, i cili ka marrë përkohësisht targat e regjistrimit, fletëzën e tahografit ose certifikatën ADR të mjetit sipas dispozitave të këtij neni, nenit 342 e nenit 348 të këtij



Ligji, ka për detyrë që për këtë shoferit t'i lëshojë vërtetim, që përmban emrin dhe selinë e organit, nëpunësi i të cilit i ka marrë targat e regjistrimit, përshkrimin tahografik ose certifikatën ADR të mjetit, llojin dhe numrin e regjistrimit të mjetit, emrin e organit që ka lëshuar lejen e komunikacionit, emrin dhe mbiemrin e pronarit të mjetit dhe adresën e tij, emrin dhe mbiemrin e shoferit dhe adresën e tij, arsyen e marrjes, datën, kohën, rrugën dhe vendin e marrjes, mënyrën dhe kohën e kthimit, si dhe vulën e organit e nënshkrimin e personit të autorizuar të policisë.

#### Neni 350

350.1. Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit bashku me Shërbimin Policor të Kosovës e formojnë shkollën “Ngasja e sigurt” dhe me një akt nënligjor përcaktojnë programin, kriteret dhe kohëzgjatjen e shkollës “Ngasja e sigurt”.

350.2. Programi i shkollës “Ngasja e sigurt” së paku duhet të përmbaj ushtrimet e ngasjes së sigurt, rregullat e komunikacionit dhe të sigurisë si dhe marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor.

#### Neni 351

351.1. Shoferi i mjeteve të cilat kryejnë transportin publik (autobusëve), shoferet e mjeteve me masën më të madhe se 7.5 tonë, të cilët drejtimin e mjetit e kanë profesion themelor nuk kanë të drejtë ta kryejnë këtë veprimtari pa e dhënë provimin në shkollën “Ngasja e sigurt” dhe pastaj duhet çdo pesë vite të japin provimin në shkollën “Ngasja e sigurt” gjegjësisht pesë vjet prej datës së fundit të dhënies së provimit në shkollën “Ngasja e sigurt”.

351.2. Personit i cili me sukses e përfundon programin e shkollës “Ngasja e sigurt” i lëshohet certifikata-vërtetimi, të njëjtën duhet ta ketë me vete shoferi nga paragrafi 1 këtij neni, gjatë kohës së drejtimit të mjetit dhe ta tregoj me kërkesë të personit të autorizuar.

351.3. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 130 €, shoferi që gjatë lëvizjes me mjet nuk posedon certifikatë të lëshuar nga shkolla “Ngasja e Sigurt”.

351.4. Për kundërvajtje, dënohet me gjobë prej 650 deri 1.500 €, edhe organizata afariste ose institucioni publik në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit ka vepruar personi i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

## 2. RREGULLAT E VEÇANTA PËR KUNDËRVAJTJE

#### Neni 352

352.1. Për kundërvajtje nga ky ligj me të cilin është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor, kryesit do ti shqiptohet dënimi me të holla me se paku, në vlerën e dyfishit të dënimit më të vogël për atë kundërvajtje.

352.2. Për lloje të caktuara të kundërvajtjeve nga ky ligj, përveç masave të tjera të parapara behet edhe shqiptimi i pikëve negative.

352.3. Maksimumi i pikëve që ka për pasojë marrjen e patentë shoferit është nëntë (9) pikë brenda një periudhe prej 36 muajve. Periudha në fjalë fillon të llogaritet që nga dita e parë e shqiptimit të pikës së parë.

352.4. Personi nga paragrafi 3 i këtij neni mund te pajiset serish me patentë shofer vetëm pas kalimit të afatit për të cilën është dënuar dhe pas dhënies se provimit (teorik dhe praktik) për ngasje të mjetit.

352.5. Fshirja e të gjitha pikëve negative të shqiptuara bëhet vetëm nëse brenda 3 viteve prej ditës së shqiptimit të pikës së parë nuk është arritur maksimumi prej 9 pikëve.

352.6. Në qoftë se për kundërvajtje me të cilën është shkaktuar aksidenti i komunikacionit rrugor është paraparë rregulla e ndalimit të drejtimit të mjetit motorik, atëherë do të shqiptohet dënimi në kohëzgjatje së paku tre muaj dhe i shqiptohen edhe dy pikë negative plotësuese.

#### Neni 353

353.1. Dënimin me të holla në vend të bërjes së kundërvajtjes e shqipton personi i autorizuar i cili bën mbikëqyrjen e komunikacionit rrugor.

353.2. Pjesëmarrësi në komunikacionin rrugor i cili nuk e paguan dënimin me të holla në vendin e kryerjes së kundërvajtjes të shqiptuar nga ana e personit të autorizuar, i lëshohet urdhëresa për dënim e cila duhet të paguhet brenda 8 dite nga data e kryerjes së kundërvajtjes.

353.3. Për shkak të sigurisë për kryerjen e dënimit ose masën mbrojtëse gjegjësisht për shkak sigurie në procesin e kundërvajtjes, personi i autorizuar mundet shtetasit të huaj ti marr për kohësisht pasaportën, gjegjësisht ndonjë dokument tjetër i cili shërben si zëvendësim për dokumentet udhëtimit deri tri ditë dhe të njëjtit i lëshohet vërtetimi për marrjen e dokumentit të udhëtimit.

353.4. Masat e sigurisë të marrjes për kohësisht të patentë shoferit i shqiptohet në kohëzgjatje deri 30 ditë me rregulla në mënyrë dhe në raste si është paraparë me këtë ligj.

353.5. Personi i autorizuar në rastet kur has në rrugë shoferin i cili nuk ka shkaktuar ndonjë rrezik të madh pjesëmarrësve tjerë në komunikacioni, mundet në vend të dënimit me të holla ti tërheq vërejtjen me shkrim. Vërejtja me shkrim nuk vlen për kundërvajtje ku janë të parapara pikët negative dhe as personit që brenda një viti i është shqiptuar kjo masë. Shqiptimi masës vërejtje me shkrim evidencohet në evidencën zyrtare.

#### Neni 354

Nëse shofer instruktori e humb të drejtën për ta drejtuar mjetin motorik, ose ju është shqiptuar masa e ndalimit e drejtimit të mjetet, atij gjatë asaj kohe nuk i lejohet të aftësoi kandidat nga lënda “ Të drejtuarit e mjetit me veprim motorik” (pjesa praktike).

#### Neni 355

355.1. Organi i cili shqipton dënimin respektivisht masën mbrojtëse nga ky ligj, duhet për shqiptimin e dënimit, gjegjësisht për masën të informon Autoritetin kompetent-Departamentin e drejtësisë dhe Shërbimin Policor të Kosovës brenda 8 ditë nga data e nxjerrjes së vendimit të plotfuqishëm.

355.2. Për shqiptimin e masës mbrojtëse, pikët negative, masën e vërejtjes me shkrim, aksidentet e komunikacionit dhe pasojat e tyre, pastaj për shoferet dhe mjetet Shërbimit Policor të Kosovës duhet ta mbaj evidencën.

355.3. Të dhënat e evidencës nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni mund ti shfrytëzojnë organet e drejtësisë, organet të cilat udhëheqin procedurat për kundërvajtje, si dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

355.4. Për evidencat e aksidenteve të komunikacionit pastaj të shoferëve dhe mjeteve përveç organet nga paragrafi 3 i këtij neni mund ti shfrytëzojnë edhe institucionet shëndetësore, organizatat dhe organet të cilat merren me sigurinë në komunikacion, pastaj personat të cilët kryejnë transportin publik ose për nevoja personale.

#### Neni 356

356.1. Kohëzgjatja e masës mbrojtëse të ndalimit e drejtuarit të mjetit me veprim motorik llogaritet nga data e shqiptimit të masës mbrojtëse në patentë shofer, gjegjësisht në evidencën e lëshuarjes së patentë shoferit në bazë të vendimit të plotfuqishëm të shqiptimit të asaj mase.

356.2. Koha e cila kalohet në mbajtjen e burgut nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni.

356.3. Shërbimi Policor Kosovës me akt nënligjor i përcakton rregullat për mënyrën e evidencës, përcjellën dhe evidencimin e të dhënave për kundërvajtje, masat e sigurisë, masat mbrojtëse, pikat negative, masat e vërejtjes me shkrim, aksidenteve dhe pasojat e tyre.

#### Neni 357

357.1. Ekzekutimi i masës mbrojtëse të ndalesës për drejtimin e mjetit me veprim motorik mund të shtyhet në kohë të caktuar, përveç kundërvajtjes nga neni 228 i këtij ligji, nëse organi i cili e shqipton dënimin e masës mbrojtëse vërtetohet sipas rrethanave në të cilën është shkaktuar kundërvajtja, a varësisht me sjelljet e tij të mëparshme në komunikacion dhe mund të pritët që edhe pa kryerjen e këtyre masave në të ardhmen nuk do të bëjë kundërvajtje në komunikacionin rrugor.

357.2. Për vendimin e kundërvajtjeve me të cilat janë shqiptuar masat nga paragrafi 1 i këtij neni do të caktohet kohëzgjatja e atyre masave si dhe koha e shtyrjes së ekzekutimit të tyre.

357.3. Në qoftë se kundërvajtësi në afat të cilin ju ka shtyrë ekzekutimi i masës mbrojtëse të ndaluarit e mjetit motorik nuk bën ndonjë kundërvajtje të re për të cilin janë parapara masat mbrojtëse për ndalimin e drejtuarit e mjetit me veprim motorik, masa mbrojtëse nuk do të ekzekutohet.

#### Neni 358

358.1. Shtyrja e ekzekutimit të masës mbrojtëse të ndalimit për drejtimin e mjetit motorik të kategorisë të caktuar do të ftohet nëse kryesi i kundërvajtjes, në afatin ku është shtyrë ekzekutimi shkaktonte kundërvajtje të re për të cilën janë parapara masat mbrojtëse e ndalimit për drejtimin e mjetit motorik për kategori të caktuar.

358.2. Nëse organi i cili udhëheq procedurën e kundërvajtjes i shqipton kryesit të kundërvajtjes masën e re mbrojtëse të ndalimit për drejtimin e mjetit motorik dhe ftohet për shtyrjen e masës së mëparshme, i shqiptohet njëra masë mbrojtëse kohëzgjatja e së cilës nuk mund të jetë më e gjatë se dy vjet.

358.3. Ekzekutimin e masës mbrojtëse nga paragrafit 2 i këtij neni nuk mund të shtyhet.

358.4. Nëse shoferi kryen dy kundërvajtje përnjëherë me mjet, i shqiptohet vetëm një dënim i cili është i paraparë si dënim më i lartë në atë rast.

358.5. Masa mbrojtëse e ndalimit të drejtimit të mjeteve motorike nuk mund të përcaktohet dhe të zbatohet në kohë zgjatje, më pak se një muaj dhe më gjatë se dy vite.

358.6. Me zbatimin e pikëve negative, ndaj kryerësit të kundërvajtjes së sigurisë në komunikacion do të vijë deri të marrja e patentë shoferit me të cilën masë bëhet ndërprerja e vlefshmërisë së patentë shoferit.

#### Neni 359

Shoferi i cili posedon patentë shoferin e vendit të huaj dhe i cili bën kundërvajtje në Kosovë, në vend të shqiptimit të masës mbrojtëse të ndalimit për drejtimin e mjetit motorik i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të shfrytëzimit të patentë shoferit të vendit të huaj brenda territorit të Kosovës.

#### Neni 360

Shofer instruktori nën mbikëqyrjen e të cilit kandidati për shofer aftësohet nga pjesa praktike, dënohet për çdo kundërvajtje që e bën kandidati për shofer, përveç nëse nuk ka pasur mundësi ta parandalon kundërvajtjen e tillë.

### KAPITULLI XII

#### DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 361

Dispozitat për kundërvajtje dhe masa mbrojtëse sipas këtij ligji janë të pa paragjykuara për zbatimin e kodit penal.

#### Neni 362

Të hyrat që realizohen nga shqiptimi i gjobave për kundërvajtje sipas këtij ligji brenda territorit të komunës, u takojnë dhe derdhen në buxhetin e komunës.

Pagesat e mjeteve për kundërvajtje, që bëhen përmes SHPK-ës apo vendimeve të gjykatave, alokohen në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

#### Neni 363

Dënimet mandatore mund të shqiptohen nga zyrtari i autorizuar i Shërbimit Policor të Kosovës në vendin e ngjarjes. Dënime mandatore konsiderohen të gjitha dënimet, me gjobë prej 15 € deri në 40 €.

#### Neni 364

Autoritetet kompetente për implementimin e dispozitave të këtij ligji nxjerrin akte nënligjore.

#### Neni 365

Dispozitat e parapara në paragrafin 3 të nenit 10 të këtij Ligji, zbatohen më së largu deri në fund të vitit 2007 pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 366

Dispozitat e parapara në paragrafin 7 të nenit 40 të këtij Ligji, zbatohen 6 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 367

Dispozitat e parapara në paragrafin 3 të nenit 39 të këtij Ligji, zbatohen 4 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 368

Dispozitat e parapara në paragrafin 3 të nenit 100 të këtij Ligji, zbatohen 1 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 369

Dispozitat e parapara në paragrafin 6 të nenit 206 të këtij Ligji mbi hartimin e “Informacionit Evropian” në rast të aksidentit në komunikacion, zbatohen 6 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 370

Dispozitat e parapara në nenin 231, 232 dhe 233 mbi aftësimin e kandidatëve në Auto-Shkolla, zbatohen 6 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

#### Neni 371

Dispozitat e parapara në nenin 237 të këtij Ligji, mbi shënimin e mjeteve me të cilat bëhet aftësimi i kandidatëve nga pjesa praktike në Auto-Shkollë, zbatohen 3 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

Neni 372

Dispozitat e parapara në paragrafin 3 të nenit 250 të këtij Ligji, zbatohen 3 vite, pasi ligji të hyn fuqi.

Neni 373

Dispozitat e parapara në paragrafin 1 të nenit 350 të këtij Ligji, zbatohen më së largu 12 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

Neni 374

Dispozitat e parapara në këtë Ligj mbi aplikimin e “pikëve negative” si masë ndëshkuese, zbatohen 3 muaj pasi ligji të hyn fuqi.

Neni 375

375.1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për bazat e sigurisë së qarkullimit në rrugë (Gazeta zyrtare e RSFJ Nr. 50/88) dhe Ligji mbi sigurinë e komunikacion në rrugë (Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 5/84)

375.2. Çdo dispozitë e Rregullores 1999/15 dhe të Rregullores 2001/29 që është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji është e pa vlefshme.

Neni 376

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-70**  
**11 janar 2007**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**

---

**Kolë Berisha**